



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 553 Akti**

**Nr. 673 Vendimi**

**Tiranë, më 15.6.2023**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 13.6.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla ovale, Tiranë, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Mirela Zavalani**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Mirela Zavalani, me detyrë prokurore në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 13.6.2023 kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Mirela Zavalani gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Subjekti i rivlerësimit Mirela Zavalani u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.6.2020 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, me trup gjykues të përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Olsi Komici dhe Firdes Shuli relatores.
3. Në datën 19.6.2020, komisionerja Firdes Shuli paraqiti një kërkesë për dorëheqje, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke parashtruar arsyet e dorëheqjes nga rivlerësimi i subjektit, për shkak të marrëdhënies familjare/gjinore mes babait të subjektit të rivlerësimit dhe vjehrrës së saj, duke vlerësuar se ndodhej në kushtet e “konfliktit në dukje të interesit”.
4. Me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 19.6.2020, u ngrit trupi gjykues që do të merrte në shqyrtim kërkesën për dorëheqje të komisioneres Firdes Shuli nga procesi për subjektin e rivlerësimit Mirela Zavalani, i cili, pasi vlerësoi pretendimet dhe argumentimet e paraqitura nga komisionerja Firdes Shuli, nuk i konsideroi marrëdhëniet mes kërkueses dhe subjektit të rivlerësimit të tilla që të krijojnë gjendje të konfliktit mes detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari.
5. Në vijim, trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 1.7.2020, vlerësoi se kërkesa për dorëheqje e komisioneres Firdes Shuli nuk gjen mbështetje ligjore në kuptim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, të Kodit të Procedurave Administrative apo ligjit “Për konfliktin e interesit” e, për këto arsye, vendosi mospranimin e kërkesës për dorëheqje të komisioneres Firdes Shuli nga procesi i rivlerësimit të çështjes së subjektit Mirela Zavalani.
6. Më tej, në datën 3.6.2022, duke marrë shkas nga evoluimi i situatave dhe nga një denoncim i mbërritur në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, ku ngriheshin pretendime mbi lidhjen familjare të subjektit të rivlerësimit dhe komisioneres Firdes Shuli, kjo e fundit në datën 3.6.2022 paraqiti përsëri dorëheqjen e saj nga procesi i rivlerësimit, duke u shprehur se në kushtet e një denoncimi në lidhje me këtë fakt vendimmarrja e saj mund të paragjykohet nga publiku si një vendim i njëanshëm.
7. Komisioni, me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 3.6.2022, ngriti trupin gjykues për marrjen në shqyrtim të kërkesës për dorëheqje të përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Suela Zhegu dhe Valbona Sanxhaktari. Ky trup gjykues, pasi vlerësoi kërkesën e paraqitur, dokumentacionin shoqërues, si dhe dëgjoi pretendimet dhe argumentet e bëra prezent nga

komisionerja Firdes Shuli, vlerësoi pranimin e kërkesës së saj për dorëheqje. Në vijim, bazuar në praktikën “Për shpërndarjen me short të çështjeve të subjekteve të rivlerësimit sipas nenit 3, pika 6, shkronja “b” e rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, nga ku ka rezultuar se për trupin gjykues nr. 4 ishte shortuar si anëtar zëvendësues komisioneri Lulzim Hamitaj, ky i fundit ka zëvendësuar komisioneren Firdes Shuli në çështjen në fjalë.

8. Më tej, nga relatori i çështjes u ndoqën procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
9. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
  - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
  - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (aktualisht, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
  - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
10. Gjatë hetimit administrativ, konkretisht, në datën 21.6.2022, është njoftuar subjekti i rivlerësimit për zëvendësimin e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit për të gjithë anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike është shprehur mbi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues, përfshirë edhe anëtarin e ri zëvendësues.
11. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Mirela Zavalani, me vendimin nr. 2, datë 18.5.2023, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
12. Në datën 19.5.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 e 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 5.6.2023.
13. Subjekti i rivlerësimit u paraqit në datën 22.5.2023 pranë Komisionit për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ, të cilat iu vunë në dispozicion së bashku me rezultatet e hetimit kryesisht, duke marrë një kopje të tyre në formë elektronike.
14. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike, nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 8.6.2023, vendosi caktimin e seancës

dëgjimore në datën 13.6.2023, duke e njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

15. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 13.6.2023, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.
16. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Mirela Zavalani parashitroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 13.6.2023 u mbyll për të rifilluar më 15.6.2023 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

17. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

18. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

19. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:
  - *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
  - *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar vlerën e pasurisë në bashkëpronësi dhe burimin e krijimit të pasurive;*
  - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
  - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
  - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
20. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

21. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

### 1. Apartament me sipërfaqe 78.6 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë

1. Ky apartament është deklaruar fillimisht nga subjekti i rivlerësimit Mirela Zavalani në DIPP-në përpara fillimit të detyrës si prokurore<sup>1</sup> në vitin 2007, si pasuri e përfituar me anë të kontratës së shitblerjes<sup>2</sup> në vitin 2007 nga pala shitëse, shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., kundrejt çmimit 3.144.000 lekë. ASHK Tiranë<sup>3</sup> ka informuar se në emër të bashkëshortit të subjektit, z. E.Z., rezultoi i regjistruar apartamenti me nr. pasurie “\*\*\*\*”, i ndodhur në z.k. “\*\*\*\*”, me sipërfaqe 78.6 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.
2. Nga shqyrtimi i deklaratës periodike vjetore të vitit 2007 ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë: (i) kursime 1.000.000 lekë; (ii) të ardhura nga supermarketi pjesë këmbimi në shumën 1.500.000 lekë; (iii) dhuratë nga prindërit e bashkëshortit në shumën 700.000 lekë. Ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim krijimi: (i) kursimet ndër vite nga paga si OPGJ; (ii) bursa nga Shkolla e Magjistraturës; (iii) të ardhurat nga paga e bashkëshortit; (iv) të ardhurat nga dyqani tregtim – pjesë këmbimi.
3. Lidhur me mospërputhjen që rezultoi midis burimeve financiare të krijimit të përshkruar në deklaratën *Vetting*, krahasuar me ato të deklaruara në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2007, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, në të cilin ajo shpjegoi se nuk ka ndryshim mes tyre, pasi ato kanalizohen në dy burime: (i) kursime nga të ardhurat nga pagat; dhe (ii) të ardhurat nga aktiviteti ekonomik.
4. Gjithashtu, shpjegoi se nuk është shprehur saktësisht në deklaratën *Vetting* lidhur me burimin pasi nga të ardhurat nga pagat janë përdorur realisht 1.700.000 lekë, ndërsa nga të ardhurat nga dyqani/supermarketi në masën 1.500.000 lekë, e cila përfshin dhuratën nga prindërit e bashkëshortit në shumën 700.000 lekë dhe 800.000 lekë nga aktiviteti, prej të cilave 400.000 lekë, depozituar në llogarinë e subjektit në “Credins Bank” në datën 26.4.2005 dhe 400.000 lekë nga qiraja e vitit 2007<sup>4</sup>.
5. Në vijim të hetimit administrativ, FSHU-ja, me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.6.2021, bëri me dije se me gjeneralitetet E.Z., është identifikuar një abonent në Tiranë dhe, pas kërkesës së Komisionit<sup>5</sup>, FSHU-ja<sup>6</sup> bëri me dije se kontrata është çelur në datën 29.11.2006, me adresë

<sup>1</sup> Referuar deklaratës para fillimit të detyrës në datën 14.11.2007.

<sup>2</sup> Kontrata nr. “\*\*\*\*”, datë 11.6.2007.

<sup>3</sup> Shkresat nr. “\*\*\*\*” prot., datë 1.3.2018 dhe nr. “\*\*\*\*” prot., datë 12.7.2021.

<sup>4</sup> Marrë më 11.6.2007, diferenca prej 280.000 lekësh, marrë në momentin e emërimit në detyrë; 70.000 lekë, marrë në fund të vitit 2007.

<sup>5</sup> Kërkesë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.11.2022.

<sup>6</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.11.2022.

të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., ndërsa UKT-ja<sup>7</sup> bëri me dije se nuk figurojnë kontrata të lidhura në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të.

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për këtë pasuri nga Komisioni, rezultoi se në vërtetimin hipotekor të datës 16.4.2012, në seksionin “Komente nga regjistruesi” është shënimi “Rivlerësim në shumën 5.580.600 lekë, datë 23.3.2006”. Me qëllim qartësimin e kësaj vlere, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2 të jepte shpjegimet lidhur me diferencën që rezulton mes çmimit të aplikuar në kontratën e shitblerjes dhe vlerës së rivlerësuar të apartamentit të shënuar në vitin 2006. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti është shprehur se data e shënuar në vërtetimin hipotekor është e gabuar, pasi fillimisht në vitin 2006 apartamenti nuk ishte ende i regjistruar në ZVRPP Tiranë as në emër të shoqërisë ndërtuese dhe se rivlerësimi i pasurive të paluajtshme ka nisur me hyrjen në fuqi të ligjit nr. “\*\*\*\*”, datë 18.5.2011, duke saktësuar se rivlerësimi i pasurisë nga ana e bashkëshortit është kryer në fakt në datën 23.3.2012.
7. Për të saktësuar lidhur me rivlerësimin e kësaj pasurie, sipas shënimit në dokumentin hipotekor, Komisioni iu drejtua ASHK Tirana Jug<sup>8</sup>, që vuri në dispozicion praktikën e rivlerësimit të pasurisë, nga ku ka rezultuar se aplikimi nga ana e bashkëshortit të subjektit është bërë në datën 21.3.2012 dhe është kryer përlllogaritja nga ASHK-ja me çmimin 71.000 lekë/m<sup>2</sup>, duke rezultuar një vlerë totale e pasurisë prej 5.580.600 lekësh. Po ashtu, me qëllim verifikimin e çmimit të blerjes së këtij apartamenti, Komisioni, referuar udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “k”, për vitin 2007”, vlera mesatare e shitjes së banesave në tregun e lirë për qytetin e Tiranës ka qenë 97.000 lekë/m<sup>2</sup>, ku për pasurinë do të rezultonte në rast aplikimi i një çmimi shitjeje prej 7.624.200 lekësh.
8. Nisur nga çmimi i blerjes së këtij apartamenti, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit që të jepte shpjegime lidhur me çmimin e blerjes së aplikuar/blerjes krahasuar me atë të publikuar të tregut të zonës dhe, ndër të tjera, informoi se çmimi i aplikuar/blerjes për sipërfaqen totale prej 91 m<sup>2</sup> të apartamentit (përfshirë këtu edhe sipërfaqet e përbashkëta) ka qenë rreth 34.550 lekë/m<sup>2</sup>. Për të provuar se apartamenti është blerë kundrejt çmimit të tregut paraqiti katër kontrata shitblerjeje<sup>9</sup> për apartamente të shitura nga shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., në të njëjtën ndërtesë, ku nga verifikimi rezultoi një çmim shitjeje mesatar për sipërfaqe totale 34.553 lekë/m<sup>2</sup>.
9. Gjithashtu, Komisioni hetoi edhe mbi ekzistencën e konfliktit të interesit, duke iu drejtuar prokurorive, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën, nga ku nuk rezultoi të ishte regjistruar ndonjë kallëzim penal në emër të shtetasve të listuar nga Komisioni. Konkretisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë<sup>10</sup> ka informuar se nuk rezulton të këtë pasur procedim të regjistruar në ngarkim të shtetasve dhe shoqërive<sup>11</sup> të përmendura në shkresë; Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>12</sup> ka informuar se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal për shtetasit dhe/ose shoqëritë tregtare dhe

<sup>7</sup> Shkresa nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.11.2022.

<sup>8</sup> Shkresa nr. “\*\*\*\*” prot., datë 6.1.2023.

<sup>9</sup> Përkatësisht kontratat e shitblerjes nr. “\*\*\*\*”, datë 11.6.2007; nr. “\*\*\*\*”, datë 11.6.2007; nr. “\*\*\*\*”, datë 11.6.2007; nr. “\*\*\*\*”, datë 11.6.2007.

<sup>10</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 16.11.2022.

<sup>11</sup> Shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe shtetasit A.B., Y./Y. Gj., A.M., F. P., R.L., B.G., dhe A.Ç.

<sup>12</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.11.2022.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka informuar me shkresë<sup>13</sup> se nuk ka procedime penale të regjistruara ndaj shtetasve për periudhën 2002 – 2022.

10. Nga sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me diferencën e çmimit të blerjes së pasurisë, i cili është ndjeshëm më i ulët se çmimi i referencës së përcaktuar nga EKB-ja për vitin 2007.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

11. Në prapësimet e depozituara subjekti i rivlerësimit është shprehur se kostoja 97.000 lekë/m<sup>2</sup> referon çmimin mesatar të tregut të lirë të shitjes së apartamenteve për të gjithë territorin e Tiranës, jo specifikisht për zonën në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Nisur nga rivlerësimi i kryer për apartamentin me sipërfaqe 78.6 m<sup>2</sup>, në datën 23.3.2012, në vlerën 5.590.600 lekë, rezulton që çmimi mesatar i tregut të lirë të shitjes, aplikuar nga ZVRPP-ja, ka qenë rreth 71.000 lekë/m<sup>2</sup>. Pra, edhe 5 vjet më pas, çmimi mesatar i shitjes së apartamenteve në zonën 1/2 rezulton të mos ketë arritur vlerën 97.000 lekë/m<sup>2</sup>. Këtë nivel çmimi, zona 1/2 nuk e ka arritur as në vitin 2016, pasi, nëse analizohet ky tregues i përcaktuar në tabelën<sup>14</sup> nr. 3, konstatohet të ketë qenë në vlerën 78.000 lekë/m<sup>2</sup>, duke mos pasur asnjë argumentim ekuivalentimi të çmimit mesatar të shitjes së apartamenteve në tregun e lirë në vitin 2016, zona 1/1, me atë të vitit 2007, zona 1/2.
12. Në mbështetje të argumenteve të lartpërmendura, subjekti ka depozituar disa kontrata të ngjashme shitjeje apartamentesh nga shoqëria në fjalë, të ndodhura në të njëjtën ndërtesë, të ndryshme nga kontratat e mëparshme të depozituara me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, me qëllim konstatimin e çmimit real të tregut të lirë të shitjes në zonën 1/2 për vitet 2006 – 2007<sup>15</sup>. Nga analizimi i kontratave më sipër, evidentohet segmenti brenda të cilit luhatet çmimi i shitjes së apartamenteve nga 33.690 lekë/m<sup>2</sup> deri në 40.000 lekë çmimi optimal, që është i përafërt me çmimin e blerjes së apartamentit në analizë.
13. Ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur ndonjë konflikt interesi, aq më tepër që në kohën e blerjes së kësaj pasurie ajo ende nuk ishte emëruar në detyrën e prokurores e, për rrjedhojë, nuk mund të konkludohet për aplikimin e ndonjë çmimi preferencial të blerjes së apartamentit.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

14. Trupi gjykues, pasi mori në analizë prapësimet, shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me diferencën e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, vëren se: (i) referuar kontratave të ngjashme të paraqitura përgjatë hetimit administrativ, por edhe atyre të paraqitura pas njohjes së rezultateve të hetimit administrativ, konstatohet se çmimi është i përafërt me çmimin e blerjes së apartamentit në analizë; (ii) nisur nga fakti se çmimi për metër katror i shitjeve në tregun e lirë, përpos luhatjeve të mundshme në kohë, nuk ka arritur çmimin mesatar sipas parametrave të EKB-së për vitin 2007, pasi edhe pas rivlerësimit në vitin 2012 çmimi real i shitjeve ende ka qenë më i ulët; (iii) për aq kohë sa nuk u provua as ekzistenca e ndonjë konflikti interesi me palën shitëse, në mënyrë të tillë që të ngrinte dyshime mbi ndonjë trajtim preferencial/favorizues nëpërmjet

<sup>13</sup>Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 1.12.2022.

<sup>14</sup> Tabela nr. 3 “Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2016”, paraqitur në udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “k” për vitin 2016”.

<sup>15</sup> Nga përlllogaritjet, kostoja e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 78.6 m<sup>2</sup> rezulton 40.000 lekë/m<sup>2</sup> nëse sipërfaqja konsiderohet neto dhe 34.549 lekë/m<sup>2</sup> nëse sipërfaqja konsiderohet bruto 91 m<sup>2</sup>.

aplikimit të ndonjë çmimi më të ulët se ai i tregut, në favor të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit.

### **1.1 Analiza e burimeve të krijimit për blerjen e apartamentit**

15. Në vijim të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni, nisur nga fakti që për blerjen e apartamentit nuk disponohej ndonjë kontratë porosie, ndonjë mandatarëkim ose transfertë bankare, nëpërmjet pyetësorit nr. 2 i kërkoi subjektit të paraqiste dokumentacionin ligjor mbi mënyrën dhe kohën e likuidimit të çmimit të apartamentit në analizë. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti i saj kishte prenotuar apartamentin në fund të vitit 2006 dhe kishte paguar një pjesë të vlerës së tij, porse nuk disponon ndonjë dokument justifikues për evidentimin e pagesave të kryera.
16. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratën noteriale<sup>16</sup> të lëshuar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë ndërtuese, z. A.M.<sup>17</sup>, ku është deklaruar se likuidimi i çmimit të apartamentit është bërë *cash* në arkën e shoqërisë përgjatë viteve 2006 – 2007 dhe, nga sa ai kujton, në atë kohë parapaguhej rreth 60% e vlerës dhe se pjesa e mbetur likuidohej në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes.
17. Përpos pasaktësive në deklarin e burimeve të krijimit të përdorur për blerjen e apartamentit prej subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka analizuar veçmas të gjitha burimet e cituara prej saj në deklaratat përkatëse, që analizohen në vijim.

#### **a) Kursimet ndër vite nga pagat**

18. Nga shqyrtimi i DIPP-ve të dorëzuara ndër vite ka rezultuar se apartamenti është deklaruar fillimisht në DIPP-në përpara fillimit të detyrës si prokurore, dorëzuar në nëntor 2007, më herët ajo ka deklaruar pas largimit të saj nga funksioni si oficere e policisë gjyqësore, për periudhën 2003 – 30.9.2005. Për rrjedhojë, përgjatë periudhës tetor 2005 – nëntor 2007, gjatë së cilës janë kryer edhe pagesat e blerjes së apartamentit, ka rezultuar se znj. Mirela Zavalani nuk ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së.
19. Komisioni konstaton se nga analizimi i deklaratave të sipërcituara ka rezultuar se në DIPP-në pas largimit nga funksioni të vitit 2005 dhe në deklaratat e mëparshme nuk janë deklaruar kursime të disponuara *cash* në banesë, për rrjedhojë ka kryer analizën financiare duke përllogaritur të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit të saj të periudhës 1.10.2005 – 11.6.2007, të cilat kanë rezultuar në masën totale 1.377.500 lekë.
20. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit kanë rezultuar tërheqjet nga depozitat e tyre përgjatë periudhës së analizuar, përkatësisht të shumës 417.835 lekë, të tërhequr nga subjekti në “Credins Bank” dhe shumës 1.980.000 lekë<sup>18</sup>, të tërhequr nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank”. Nisur nga fakti që këto shuma ishin depozituar prej tyre përpara periudhës së analizuar, Komisioni ka analizuar mundësinë për depozitimin e tyre me burime të ligjshme financiare.
21. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se shuma prej 400.000 lekësh është depozituar nga subjekti i rivlerësimit në datën 26.4.2005 dhe është shtuar me të ardhurat

<sup>16</sup> Deklarata noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.11.2022.

<sup>17</sup> Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 1.12.2022, ka informuar se për këtë shtetas rezulton të jetë regjistruar procedimi penal nr. “\*\*\*\*”, i vitit 2019, për veprën penale “falsifikim i vulave, i stampave dhe formularëve”, pa emër personi të regjistruar në ngarkim dhe se çështja vijon të jetë në hetim, me prokuror S.H.

<sup>18</sup> 860.000 lekë tërhequr më 23.1.2006; 620.000 lekë, tërhequr më 7.4.2006; 500.000 lekë, tërhequr më 1.9.2006.



nga interesat prej 17.835 lekësh deri në momentin e tërheqjes së shumës totale, në datën 8.9.2006. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti e ka deklaruar këtë depozitë bankare, me burim nga të ardhurat nga dyqani pjesë këmbimi, deklarim ky i bërë edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe që do të analizohet në vijim.

22. Ndërsa shuma prej 1.950.000 lekësh, e depozituar nga bashkëshorti i subjektit në “Tirana Bank” në datën 18.6.2004, ku kjo depozitë është deklaruar prej tij në DIPP-në e vitit 2004, por pa përshkruar burimin e krijimit të saj. Nisur nga fakti që në DIPP-në e vitit 2003, prej saj apo bashkëshortit nuk janë deklaruar kursime *cash*, Komisioni ka analizuar mundësitë e krijimit të kësaj depozite, me të ardhurat e periudhës 1.1.2004 – 18.6.2004.
23. E pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se shuma prej 1.950.000 lekësh, e depozituar nga bashkëshorti i saj në llogarinë e tij në “Tirana Bank” dhe se vetëm shuma prej 450.000 lekësh është me burim nga kursimet e familjes së saj, ndërsa shuma prej 1.500.000 lekësh rrjedh nga një hua e marrë nga babai i bashkëshortit shtetasit I.Ç. Kjo shumë ishte marrë nga babai i bashkëshortit me qëllim për t’u përdorur nga ky i fundit për ndërtimin e banesës së tij dhe është depozituar nga ana e bashkëshortit të saj, në pamundësi për ta mbajtur atë në shtëpi dhe për t’ia ridhënë babait të bashkëshortit më tej, për të vijuar me punimet.
24. Këtë shumë bashkëshorti ia ka kthyer babait të tij në vitin 2005 nëpërmjet dy tërheqjeve të kryera prej tij nga një depozitë e mëparshme, si dhe disa kursime të disponuara *cash*, duke bërë që depozita e çelur në vitin 2004 të vijonte të qëndronte e investuar në “Tirana Bank”, deri në vitin 2006.
25. Në mbështetje të sa më sipër deklaruar, ajo ka paraqitur një deklaratë noteriale<sup>19</sup> në të cilën vjehri i subjektit të rivlerësimit, z. E.Z., ka deklaruar se ka marrë hua nga z. I. Ç., (xhaxhai i subjektit) vlerën 3.000.000 lekë, përkatësisht shumën 1.500.000 lekë në datën 26.10.2002 dhe shumën 1.500.000 lekë në datën 3.6.2004, sipas deklaratave të dorës të datave të mësipërme, bashkëngjitur deklaratës noteriale.
26. Komisioni, nisur nga faktet se: (i) në emër të babait të bashkëshortit të subjektit nga hetimi administrativ nuk ka rezultuar të ketë pasur ndonjë llogari bankare përgjatë periudhës në fjalë, ato janë hapur më vonë; (ii) ekzistencës së deklaratës noteriale të vitit 2005 për dhënien e shumës 3.000.000 lekë në dy këste; (iii) përputhen datat e përmendura në deklaratën noteriale të vitit 2005 për dhënien e shumave nga 1.500.000 lekë me datat e depozitimeve të kryera në llogarinë e bashkëshortit të subjektit; (iv) nuk është provuar se depozitat janë krijuar (edhe) me shumat që vjehri i subjektit të rivlerësimit i kishte marrë hua nga z. I. Ç., pra mbetet i paqartë disponimi dhe depozitimi i shumave në fjalë nga ana e bashkëshortit të subjektit, për sa kohë nuk ka rezultuar e provuar me ndonjë dokumentacion të kohës apo të jetë deklaruar prej subjektit të rivlerësimit asokohe si burim krijimi.
27. Nga sa më sipër, Komisioni e ftoi subjektin e rivlerësimit të jepte shpjegime bindëse lidhur me sa është konstatuar më sipër – të cilat do të analizohen në vijim.
28. Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të huas së marrë nga shtetasi I. Ç., nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. I. Ç., të shumës 3.000.000 lekë,

<sup>19</sup> Deklarata noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 26.11.2005.

babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit subjekti ka paraqitur një kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme të llojit truall<sup>20</sup> të vitit 2002, ku nga shitja ai ka përfituar të ardhura në masën 3.900.000 lekë, të cilat duken të mjaftueshme për dhënien hua të shumës 3.000.000 lekë, në favor të babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

29. Përgjatë hetimit administrativ subjekti ka shpjeguar dhe ka pretenduar se deri në vitin 2007, ndonëse<sup>21</sup> ajo ka qenë në përbërje familjare së bashku me prindërit e bashkëshortit të saj, si dhe kanë jetuar në të njëjtën banesë/godinë, familja e saj kanë qenë në ekonomi të ndarë, duke qenë se kanë jetuar veçmas në një pjesë të godinës së banimit, sikurse është deklaruar prej saj edhe në DIPP-në e vitit 2003.
30. Nisur nga sa më lart, Komisioni ka kryer analizën financiare duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit dhe shpenzimet e tyre, për periudhën 1.1.2004 – 18.6.2004, duke e konsideruar me rezervë edhe përdorimin e shumës së marrë hua nga babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit prej shtetasit I. Ç., si dhe ka rezultuar se ata kishin mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e shumës 1.950.000 lekë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

31. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në dokumentacionin përgjatë hetimit administrativ, në mënyrë të përmbledhur ka shpjeguar se nisur nga këto fakte: (i) të ardhurat nga pagat e bashkëshortit për periudhën 1999 – 2002 kanë qenë në shumën 613.922<sup>22</sup> lekë; (ii) të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1999 – 2002 kanë qenë në shumën 1.272.758 lekë; (iii) shpenzimet jetike, konsideruar sipas Komisionit (66% të të ardhurave nga pagat për vitin 1999 dhe sipas ILDKPKI/INSTAT-it për vitet në vijim; (iv) dy anëtarë deri më 6.10.2001 dhe tre anëtarë në familje, në vijim) – rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi për të kursyer shumën 1.122.627 lekë përgjatë periudhës 1999 – 2002.
32. Po ashtu, nga shuma 2.000.000 lekë, e depozituar në llogarinë e bashkëshortit në “Tirana Bank” sh.a., në datën 13.11.2002, shuma 500.000 lekë ishte e krijuar nga kursimet e lartpërmendura dhe diferenca konsistonte në shumën e marrë hua nga babai i tij. Pjesa e mbetur nga mundësia për kursim është përdorur për krijimin e depozitës me vlerë 162.000 lekë në shkurt 2003 dhe me vlerë 260.000 lekë në maj 2003 dhe diferenca u përdor së bashku me shumën e tërhequr 1.344.000 lekë për të plotësuar shumën 1.500.000 lekë, kthyer babait në shtator 2003. Nga analiza, mundësia e familjes për të kursyer nuk arrin nivelin e shumës 2.000.000 lekë të depozituar nga bashkëshorti në datën 13.11.2002, në llogarinë e tij nr. “\*\*\*”, në “Tirana Bank” sh.a.
33. Pjesë e shumës 2.000.000 lekë është huaja e marrë prej babait të bashkëshortit, z. E.Z., nga shtetasi I. Ç., në dy pjesë – pjesa e parë 1.500.000 lekë në datën 26.10.2002 do të përdorej për të vijuar ndërtimin e objektit “njësi”, i cili u shty në kohë përtej pritshmërive, për shkak të plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për aplikim dhe procedurave deri në zbardhjen e lejes<sup>23</sup> së ndërtimit. Ndodhur në kushtet e pamundësisë për të vijuar ndërtimin dhe në

<sup>20</sup> Kontrata nr. “\*\*\*”, datë 5.3.2002.

<sup>21</sup> Referuar certifikatës familjare të depozituar.

<sup>22</sup> Përfshirë të ardhurat nga paga në shumën 20,357 lekë, vërtetuar me shkresën nr. “\*\*\*” prot., datë 13.12.2022, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për periudhën mars - maj 2000, të punësimit të bashkëshortit.

<sup>23</sup> Faqe 97 e dokumentacionit të depozituar pranë Komisionit në përgjigje të pyetjes 1 të pyetësorit nr. 2, datë 15.11.2022.

mungesë të disponimit të një llogarie bankare nga ana e babait të bashkëshortit, si dhe verifikuar edhe nga ana e Komisionit, z. E.Z., i kërkoi të birit të depozitonte në bankë shumën e marrë hua deri në momentin e përdorimit për qëllimin për të cilin ishte marrë.

34. Në mes të vitit 2003, babai i bashkëshortit, i bindur se do të dilte leja e ndërtimit, kërkoi tërheqjen e shumës së ruajtur në llogarinë bankare të të birit. Tërheqjet nga banka u realizuan në gusht 2003, shuma 800.000 lekë, dhe në shtator të po këtij viti, u tërhoq shuma 544.000 lekë. Të dyja këto shuma, së bashku me diferencën e plotësuar nga kursimet *cash* deri në atë periudhë, në total 1.500.000 lekë, iu kthyen babait për të vijuar ndërtimin. Kursimet e familjes, krijuar për periudhën 1999 – 2003, janë ruajtur në llogaritë bankare dhe, siç rezulton nga deklaratat e personit që mbart detyrim për deklarim, nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit 2003.
35. Punimet filluan në gjysmën e parë të vitit 2004, me zbardhjen e lejes së ndërtimit dhe burimi i investimit të kryer ishte përdorimi i huas, marrë nga shtetasi I. Ç. Për ta pasur të disponueshme të gjithë shumën, babai i bashkëshortit mori edhe këstin e dytë të huas me deklaratë të thjeshtë, nënshkruar mes palëve më 3.6.2004. Sikundër veproi edhe me këstin e parë, i kërkoi të birit ta depozitonte këtë hua në bankë për arsye sigurie.
36. Më 18.6.2004, rezultoi të jetë depozituar në llogari bankare shuma 1.950.000 lekë, e përbërë nga huaja në shumën 1.500.000 lekë dhe diferenca me kursimet e krijuara gjatë vitit, deri në datën e depozitimit. Në maj të vitit 2005 është tërhequr shuma 1.315.000 lekë nga “Tirana Bank” sh.a., plotësuar me kursimet e familjes në *cash* gjatë vitit, në total 1.500.000 lekë, kthyer pas babait për të vijuar pjesën tjetër të ndërtimit. Në deklaratën e interesave privatë 2004, bashkëshorti ka deklaruar specifikisht *depozita bankare 1.950.000 lekë, [...], krijuar më 18.6.2004.*
37. Në përmbledhje, sipas subjektit, duke qenë se: (i) provohet me dokument të kohës marrja e kthimi i huas në dy këste me dy deklaratat të thjeshta, nënshkruar mes huamarrësit dhe huadhënësit përkatësisht në datat 26.10.2002 dhe 3.6.2004, formalizuar me deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 26.11.2005; (ii) provohet ligjshmëria e burimeve të huadhënësit për dhënien e huas; (iii) provohet që babai i bashkëshortit nuk ka pasur depozita në emër të tij apo të bashkëshortes; (iv) ndërkohë që familja e subjektit nuk ka pasur mundësi të krijojë kursime në masën e pretenduar; (v) kursimet e vetme që ka deklaruar në deklaratimet si OPGJ, janë kursimet në depozitat bankare; (vi) fakti që bashkëshorti ishte i vetmi që dispononte llogari bankare e kryente transaksione me bankat në atë periudhë; (vii) periudha e miratimit të projektit dhe zbardhja e lejes në tremujorin e dytë të vitit 2004; (viii) nuk kanë deklaruar shtim pasurie apo shpenzim të kryer në deklaratën 2003; (ix) mosdeklarimi i burimit të krijimit të depozitës nga ana e bashkëshortit, ndërkohë që e ka deklaruar shumën e depozitës, tregon pasaktësi formale e të paqëllimshme në kuadër të deklaratimeve fillestare, ende të paqartë për plotësimin e tyre.
38. Nga sa më sipër, konkludohet se kursimet e mundshme për periudhën 2002 – 2004 janë ato të mbetura në depozita në vitin 2005 dhe të tërhequra në vijim për blerjen e banesës në Tiranë. Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, pasaktësia e personit të lidhur në deklarimin e burimit të krijimit të depozitës, e pashoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme, nuk ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

39. Nisur nga sa është shpjeguar në prapësimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet, vlerëson se ndonëse mosdeklarimi i burimit të krijimit të depozitës së bashkëshortit në vitin 2004 mbetet pasaktësi në deklaram, pasi nuk është provuar me ndonjë dokumentacion që pjesë e kësaj depozite të ketë pasur si burim pikërisht edhe huan e marrë nga babai i bashkëshortit të subjektit të huadhënësi I. Ç.

Në këto kushte, Komisioni, nisur nga: (i) marrëdhënia e posaçme babë e bir; (ii) mospasja e një llogarie bankare në emër të babait të bashkëshortit të subjektit; (iii) mungesa e përfshirjes së subjektit në këtë marrëdhënie; (iv) mungesa e burimeve financiare të vetë bashkëshortit të subjektit; (v) koha kur janë kryer këto veprime, parë edhe në raport me statusin e subjektit – e konsideron të pranueshëm pretendimin se shumt e depozituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit pjesërisht rrjedhin nga huaja e marrë nga babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**Tabela nr. 1 – Analiza për depozitim e kryer në datën 18.6.2004**

Te ardhura te subjektit 1.1.2004 - 18.6.2004	263,466
Te ardhura te b/shortit 1.1.2004 - 18.6.2004	213,924
Dhene nga babai b/shortit (nga huaja e marre nga I. Ç.)	1,500,000
Shpenzime jetese janar - qershor 2004	(140,796)
Te terhequra nga depozitat bankare	189,727
Depozituar ne date 18.6.2004	(1,950,000)
<b>Rezultati në datë 18.6.2004</b>	<b>76,321</b>

40. Në konkluzion, lidhur me këtë depozitë, nisur nga rrethanat specifike të lartpërmendura dhe kryesisht marrëdhënia e posaçme familjare, si dhe fakti se kjo marrëdhënie huaje ka ekzistuar ndërmjet babait të bashkëshortit dhe një personi tjetër, duke u vlerësuar në harmoni me të gjitha rrethanat dhe se kjo marrëdhënie juridiko - civile ka ndodhur përpara fillimit të detyrës së subjektit dhe për aq kohë sa nuk shoqërohet me mungesë të burimit të ligjshëm financiar, trupi gjykues çmon se ky fakt nuk mund të passjellë ndonjë pasojë penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

#### **b) Të ardhurat nga supermarketi**

41. Lidhur me këtë burim krijimi të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit, ajo ka shpjeguar se është përdorur shuma 800.000 lekë, e cila përbëhet nga vlera 400.000 lekë, e depozituar prej saj në datën 26.4.2005 dhe vlera 400.000 lekë, e përfituar deri në datën 11.6.2007 nga dhënia me qira e objektit kumatit të saj, “E.Z.” person fizik. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar dhënia me qira e objektit prej bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në favor të vëllait të tij, duke filluar nga muaji dhjetor 2006, kur rezulton të jetë nënshkruar kontrata e qirasë mes tyre.

42. Nëpërmjet kontratës së qirasë<sup>24</sup> bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e qiradhënësit, cilësuar në kontratë si pronar i 1/2 pjesë takuese të pasurisë objekt kontrate, i ka dhënë me qira personit fizik “E.Z.” një dyqan me sipërfaqe 251 m<sup>2</sup>, të ndodhur në “\*\*\*\*”, Fier, me një afat 10-vjeçar, kundrejt vlerës totale prej 3.000.000 lekësh. Vlera e qirasë do të paguhej për vitin e parë 750.000 lekë, për vitin e dytë 500.000 lekë dhe në vitet në vijim jo

<sup>24</sup> Kontrata e qirasë nr. “\*\*\*\*”, datë 29.12.2006.

më pak se 150.000 lekë. Palët kontraktuese kanë përcaktuar se pala qiramarrëse merr përsipër të paguajë tatimin në burim<sup>25</sup> për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës, tatim ky që duket se është mbajtur për sa kohë shuma e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si e përfituar nga bashkëshorti i saj nga qiradhënia, për të gjithë periudhën, ka qenë 2.660.000 lekë. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga qiradhënia, sipas përcaktimeve ligjore, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se nuk mund të paraqesë dokumentacion për ta provuar, por ka cituar qëndrimin e mbajtur nga Kolegji, në raste të ngjashme<sup>26</sup>, ku në të gjitha rastet, edhe nëse nuk do të ishte paguar tatimi në burim prej qiramarrësit “E.Z.” person fizik, ajo nuk do të mund ta penalizonte atë.

43. Nga shqyrtimi i deklaratës *Vetting* ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga dyqani<sup>27</sup> në shumën totale prej 7.440.000 lekësh për periudhën 2003 – dhjetor 2015, për këtë arsye Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të specifikonte shumën e përfituar konkretisht për çdo vit. Në përgjigje, ajo ka deklaruar se nga momenti i regjistrimit të aktivitetit të vëllait të bashkëshortit të saj e deri në fund të vitit 2006, fitimet e aktivitetit janë ndarë në dakordësi mes vëllezërve e, më pas, pas largimit të tyre nga banesa e përbashkët ata kanë nënshkruar kontratën e qirasë.
44. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti paraqiti një deklaratë noteriale të lëshuar nga babai i bashkëshortit të saj në vitin 2022<sup>28</sup>, në të cilën ai ka deklaruar se deri në momentin e largimit të djalit të tij nga banesa e përbashkët në vitin 2007, bashkëshorti i saj ka përfituar të ardhura nga fitimi i aktivitetit tregtar në mënyrë proporcionale si pjesë e bashkësisë familjare. Ndërsa, pas largimit të tyre, pra të familjes së subjektit të rivlerësimit nga banesa e përbashkët në vitin 2007, bashkëshorti i subjektit ka përfituar të gjitha të ardhurat nga dhënia me qira e ambientit.
45. Nga analizimi i deklarimeve/pretendimeve të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, duket se ato bien ndesh me shpjegimet dhe qëndrimet e saj për sa i përket mospasjes së një ekonomie të përbashkët familjare me prindërit e bashkëshortit të subjektit, të trajtuar më lart, ndonëse ata kanë banuar në të njëjtën godinë deri në vitin 2007.
46. Gjithashtu, pretendimet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka përfituar të ardhura edhe nga aktiviteti i vëllait të tij, duket se, përpos faktit se nuk janë të provuara me ndonjë dokumentacion/transferte bankare, ato bien ndesh me dispozitat ligjore lidhur me legjitimitetin e përfitimit të të ardhurave të gjeneruara nga një biznes, e drejtë kjo që i përket ortakëve/administratorit dhe jo personave të tretë. Për më tepër, që nga shqyrtimi i deklarimeve ndër vite nuk ka rezultuar deklarimi i ndonjë dhurimi të shumave me këtë burim dhe as ndonjë përfitim i mjaftueshëm nga aktiviteti tregtar, nga ku mund të justifikohet/legjitimohet gjenerimi/përfitimi fitimet neto të pretenduara, nga të ardhura të tatuara.
47. Lidhur me aktivitetin tregtar të vëllait të bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka paraqitur një shkresë nga Bashkia “\*\*\*\*”<sup>29</sup> dhe nga DRT

<sup>25</sup> Referuar ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, person fizik “E.Z.” ka pasur detyrim për të mbajtur në burim tatimin mbi qiranë.

<sup>26</sup> Vendimi nr. “\*\*\*\*”, datë 17.3.2022, pika 17.4; vendimi nr. “\*\*\*\*”, datë 15.6.2021, pika 70.

<sup>27</sup> Pa specifikuar nëse janë nga dhënia me qira e tij apo nga aktiviteti, si dhe pjesë përbërëse të secilës prej tyre.

<sup>28</sup> Deklarata noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.11.2022.

<sup>29</sup> Shkresat nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.9.2020 dhe nr. “\*\*\*\*” prot., datë 14.11.2022.

Fier<sup>30</sup>, ku informon mbi të ardhurat/qarkullimin dhe fitimin nga aktiviteti tregtar “E.Z.” person fizik, si dhe një tabelë për periudhën prill 2004 – 2015, ku ka përlogaritur fitimin e aktivitetit tregtar, që rezulton në masën 5.897.590 lekë. Po ashtu, DRT Fier, me shkresën nr. “\*\*\*” prot., datë 15.5.2018, dërguar ILDKPKI-së, ndër të tjera, ka bërë me dije se “E.Z.”, person fizik, nuk ka pasur detyrimin ligjor për shpërndarjen e dividendit.

48. Në vijim të hetimit administrativ, Komisioni iu drejtua DPT-së Tiranë<sup>31</sup>, e cila vuri në dispozicion të dhëna statistikore mbi marzhet e fitimit të këtij lloji aktiviteti për periudhën 2004 – 2015. Nisur nga fakti që bashkëshorti i subjektit nuk e ka deklaruar ndër vite dhurimin e pjesës takuese të babait të tij nga të ardhurat nga qiradhënia, përgjatë periudhës 2007 – 2015, si dhe nuk ka një dokumentacion të kohës për ta provuar atë, pretendimi i subjektit mbetet në nivel deklarativ dhe Komisioni ka konsideruar si të ardhura me burim të ligjshëm nga qiradhënia vetëm pjesën e tij takuese prej 1/2 të tyre, në masën totale 1.330.000 lekë.
49. Sa i përket të ardhurave të pretenduara nga fitimi i aktivitetit tregtar “E.Z.”, person fizik, përgjatë periudhës prill 2004 – 2006, nisur nga sa u përshkrua më sipër lidhur me këtë pretendim, si dhe duke i konsideruar ekonomitë familjare të ndara me vëllain e bashkëshortit të subjektit, në emër të të cilit ekzistonte biznesi në fjalë, edhe ato mbeten në nivel deklarativ.
50. Komisioni mbërrin në konkluzionin se për sa kohë: (i) nuk ka ndonjë dokumentacion të kohës mbi ndonjë marrëveshje të mundshme mes palëve/vëllezërve mbi ndarjen e fitimit nga ky biznes; (ii) bashkëshorti i subjektit nuk ka rezultuar të ketë qenë ndonjëherë ortak në këtë aktivitet tregtar; (iii) për më tepër që ka rezultuar se të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga ndarja e fitimeve të këtij aktiviteti janë edhe më të larta edhe se vetë fitimet totale të realizuara, sipas bilanceve, nga ky aktivitet përgjatë periudhës prill 2004 – 2006 – duket se pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ dhe këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të ardhura të disponuara nga familja e subjektit me burim të ligjshëm financiar.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

51. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e depozituara pasi është njohur me rezultatet e hetimit, lidhur me këtë konstatim për sa i përket qirasë, është shprehur: *së pari*, kontrata e qirasë nr. “\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 29.12.2006, është nënshkruar me palë qiradhënëse bashkëshortin dhe palë qiramarrëse “E.Z.”, person fizik, dhe se në këtë kontratë babai i bashkëshortit nuk figuron palë në këtë kontratë, në referencë të dispozitave të Kodit Civil, ai nuk përfiton të drejta apo detyrime nga kjo kontratë<sup>32</sup>; *së dyti*, sikurse është specifikuar në kontratë, qiradhënësi ka qenë në cilësinë e zotëruesit të 1/2 pjesë takuese të pasurisë objekt kontrate<sup>33</sup> dhe ka nënshkruar përfitimin e qirasë për këtë pjesë takuese, sikurse përcaktohet në pikën 2.1 të kontratës, qiradhënësi garanton që ai është i vetmi pronar ligjor i pronës për pjesën e tij takuese prej 1/2 pjesë që është fuqiptotë të ndërmarrë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, të përcaktuara nga momenti i firmosjes së marrëveshjes; *së treti*, referuar certifikatës familjare<sup>34</sup> të familjes së bashkëshortit, rezulton të jenë anëtarë të një familjeje

<sup>30</sup> Shkresë nr. “\*\*\*” prot., datë 9.12.2022.

<sup>31</sup> Shkresë nr. “\*\*\*” prot., datë 2.2.2023.

<sup>32</sup> Sipas dispozitave të Kodit Civil, “Mbi të drejtat e bashkëpronarëve, Bashkëpronësia në pjesë.

<sup>33</sup> Pasuria nr. “\*\*\*\*”, ndodhur në z. k. “\*\*\*\*”, me sipërfaqe 251 m<sup>2</sup>, vërtetuar sipas vërtetimit hipotekor nr. “\*\*\*\*”, datë 7.12.2006.

<sup>34</sup> Certifikatë e përbërjes familjare të familjes së babait të bashkëshortit, datë 1.1.2016, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia “\*\*\*\*”, lëshuar në datën 22.5.2023.

babai i bashkëshortit, z. E.Z., dhe djali i tij E.Z., i cili ushtronte aktivitetin si person fizik në pasurinë “njësi”, pjesë e objektit.

52. Në kushtet e jetesës së përbashkët të babait të bashkëshortit me vëllanë e tij, dhënia me qira djalit tjetër të tij të pjesës takuese nga babai, nuk ka kuptim logjik, ekonomik e ligjor, pasi transaksioni i qiradhënies e qiramarrjes do të kishte efekt zero në ekonominë e kësaj familjeje. Nga ana tjetër, dhënia e qirasë nga aktiviteti ekonomik do të rriste të ardhurat nga qiraja duke pakësuar fitimin neto nga aktiviteti (shpenzime qiraje dhe fitim më i ulët). “E.Z.”, person fizik, dhe babai, individ bashkëpronar i pasurisë së paluajtshme, kanë përfituar vetëm fitimin neto nga aktiviteti ekonomik; *së katërti*, babai i bashkëshortit nëpërmjet deklaratës noteriale<sup>35</sup> ka deklaruar se *të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e ambienteve tregtare të dyqanit tek personi fizik “E.Z.”, [...] janë përfituar në tërësi nga djali im, shtetasi E. Z.; së pesti*, për analogji, ka paraqitur kontrata qiraje të lidhura nga babai i bashkëshortit<sup>36</sup> me palë të treta, sikundër ka vepruar bashkëshorti në rastin konkret, ku babai i bashkëshortit është përfitues i vetëm i të ardhurave nga qiraja, të përfituara për pjesën e tij takuese sipas kontratave.
53. Në përmbledhje të sa më sipër, bashkëshorti nuk ndodhej në kushtet e dhurimit të ndonjë pjese takuese të të ardhurave nga qiradhënia e, për më tepër, t’i provojë me dokumentacion të kohës ato, pasi ai ka përfituar thjesht qiranë nga pjesa e tij takuese sipas kontratës respektive e, për rrjedhojë, detyrimi kanalizohet në deklaram të të ardhurave të realizuara prej tij, duke kërkuar përfshirjen në analizën financiare të së gjithë shumës 2.660.000 lekë të përfituar nga qiradhënia.
54. Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga fitimi i aktivitetit “E.Z.”, person fizik, përgjatë periudhës prill 2004 – 2006, subjekti ka sqaruar se: *“Së pari, në deklaratën e interesave privatë 2004 kam deklaruar të ardhurat nga dyqani pjesë këmbimi 1.500.000 lekë, [...]”. Termi “e ardhur” është përdorur në vend të “qarkullimit”/“marzhit bruto”, informacion i dhënë nga vëllai i bashkëshortit<sup>37</sup>, i pakonsultuar me dokumentacion, pasi në vitet 2004 – 2007, bizneset e vogla nuk depozitonin bilanc financiar, por deklaronin qarkullimin vjetor të realizuar sipas ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore për biznesin e vogël” dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe jo fitimin vjetor neto.*
55. *E paqartë për mënyrën e deklaramit, nisur nga fakti që bashkëshorti ishte një nga dy mbajtësit e lejes së ndërtimit të objektit, për shkak të ndihmesës fizike që jepte, ka deklaruar edhe qarkullimin e aktivitetit ekonomik që ushtrohej në pasurinë “njësi”, në rubrikën “Të ardhura”. Nuk ka pretenduar nga kjo shumë burim krijimi të kursimeve gjendje likuiditeti në bankë në këtë vit, pasi nuk ka poseduar pasuri tjetër përveç depozitës. Sipas përlllogaritjeve të kryera, sikundër konfirmuar, fitimi neto i vitit 2004 optimalisht arrin vlerën 574.789 lekë; së dyti, në deklaratën e interesave privatë pas mbarimit të detyrës si OPGJ (1.1.2005 –*

<sup>35</sup> Deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 22.11.2022.

<sup>36</sup> Kontratë qiraje nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 5.10.2015, kontratë qiraje nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 6.9.2016, kontratë qiraje nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 3.10.2017.

<sup>37</sup> Me shkresën kthim përgjigjeje nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.9.2020, lëshuar nga Bashkia “\*\*\*\*” si dhe me shkresën kthim përgjigjeje nr. “\*\*\*\*” prot., datë 9.12.2022, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier, konfirmohen të ardhurat/qarkullimi dhe fitimi nga aktiviteti ekonomik person fizik “E.Z.”, me NIPT “\*\*\*\*”, për periudhën prill 2004 – 2015, konkretisht për vitin 2004, të ardhurat nga aktiviteti janë në vlerën 1.800.000 lekë. Termi “të ardhura” në rastin konkret është përdorur për qarkullimin e realizuar nga aktiviteti.

30.9.2005) ka deklaruar depozitë bankare në “Credins Bank”, dega Fier, nr. llogarie “\*\*\*\*”, shumën 400.000 lekë, krijuar më 26.4.2005, me burim të ardhurat nga dyqani pjesë këmbimi.

56. Kjo shumë i është dhënë bashkëshortit kundrejt lënies së njësisë në përdorim/enfiteozë vëllait, për të ushtruar aktivitetin e tregtimit të pjesëve të këmbimit, si dhe shërbime automjetesh (service), duke depozituar dokumentin kontratë huapërdorje pasurie të paluajtshme datë 12.4.2004 dhe kontratë enfiteozë nr. “\*\*\*\*” kol., datë 25.2.2005, lidhur midis bashkëshortit dhe vëllait të tij E.Z., një deklaratë noteriale<sup>38</sup> datë 2.6.2023, me të cilën shtetasi E.Z., deklaron dhe konfirmon faktin se ai ka paguar vlerë përdorimi dhe qiraje vetëm për llogari të bashkëshortit E.Z., dhe për pjesën e tij takuese prej 1/2, në vitet 2005 – 2015, duke konfirmuar deklarin e bërë nga babai i bashkëshortit me deklaratën noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.11.2022, lidhur me përfitimin e vetëm nga bashkëshorti të vlerave të qirasë, në kushtet kur prej tij është disponuar vetëm pjesa takuese prej 1/2 në sendin në bashkëpronësi”.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

57. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e depozituar prej saj, duke mbajtur në vëmendje faktet se lidhur me përftimin nga qiraja nga Komisioni është konstatuar se bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit i mungonte legjitimiteti për të përfituar të gjithë shumën e qirasë, për sa kohë në pikën 1.1. të kontratës së qirasë, si objekt cilësohet pasuria me sipërfaqe 251 m<sup>2</sup>, pra i gjithë sendi/pasuria në totalin e saj dhe jo vetëm 1/2 pjesë. Ndërkohë, në pikën 2.1 të së njëjtës kontratë është përshkruar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është i vetmi pronar ligjor i pjesës së tij takuese prej 1/2. Në këtë kontekst, për sa kohë në të nuk ishte specifikuar konkretisht nëse kundërshtëpërblimi ishte në raport me sipërfaqen totale apo të pjesës takuese, duke krijuar kështu një konfuzion dhe kontradiktë midis elementeve të së njëjtës kontratë, Komisioni nuk e konsideron të provuar pretendimin e subjektit, ndonëse çka nuk mund të përjashtohet, për sa kohë gjendemi përballë një paqartësie kontraktore dhe sërish në gamën e një marrëdhënieje të veçantë.

58. Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerësoi se ndonëse konfuzioni i përshkruar më lart, që i përket anës formale në përshkrimin e elementeve përbërëse të objektit të kontratës së qirasë, duke u ndërthurur me marrëdhënien e posaçme familjare të palëve kontraktuese, e bëjnë të vështirë vlerësimin, për sa kohë nuk mund të përjashtohet *de facto* disponimi i të gjithë vlerës nga qiraja nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, sikurse pretendohet nga subjekti i rivlerësimit.

59. Në këtë kushte, ndonëse legjitimiteti i përfitimit të shumave nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga kontrata nuk është provuar, Komisioni e vlerëson si një alternativë të mundshme disponimin nga ky i fundit të shumave të plota të përshkruara si kundërshtëpërblim në kontratën *de qua*, e kështu, edhe për shkak të rrethanave familjare, kjo rrethanë nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit, që nuk ka qenë palë apo personalisht e përfshirë në hartimin (konfuz) e kësaj kontrate. Gjithashtu, duhet shtuar se nga disa kontrata të lidhura nga vetë babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, është konstatuar ekzistenca e *modus operandi* e dhënies me qira tek të tretët, nga njëri bashkëpronar (babai) vetëm i një pjese të pjesës së vet takuese (1/2) – ndonëse në këto raste objekti i kontratës ka rezultuar më i qartë,

<sup>38</sup> Deklarata noteriale nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol.



duke specifikuar vetëm sipërfaqen e pjesës që jepej me qira dhe jo të tërë pasurinë në bashkëpronësi.

60. Analiza dhe arsyetimi i mësipërm vlen të mbahet në konsideratë edhe për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me përfitim të shumës 400.000 lekë nga nënshkrimi i një kontrate të enfiteozës në vitin 2005. Edhe lidhur me këtë rrethanë, trupi gjykues, duke mbajtur në vëmendje për sa u arsyetua më sipër, si dhe nga fakti se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, pas njoftimit të rezultateve, një kontratë enfiteoze (të noterizuar) që ka për objekt dhënien me enfiteozë të pjesës së tij prej ½ të objektit kundrejt shumës 400.000 lekë, si dhe nga fakti se kjo shumë është deklaruar nga subjekti që në krye të herës me burim nga aktiviteti tregtar. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se për sa kohë subjekti ka paraqitur një akt noterial të kohës, mbi të cilin bazohet pretendimi në fjalë dhe përbën një arsye më tepër që edhe kjo shumë, sikurse ajo e përfituar nga qiramarrja, mund të konsiderohet dhe të merret e plotë në analizën financiare të viteve përkatëse.

### c) Dhuratë nga prindërit e bashkëshortit

61. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-në përpara fillimit të detyrës në vitin 2007, ka deklaruar si një ndër burimet e krijimit të pasurisë në analizë një dhuratë në shumën 700.000 lekë nga prindërit e bashkëshortit, burim ky i cili nuk është deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting*. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ajo bëri me dije se kjo shumë i është dhënë bashkëshortit nga prindërit e tij si pjesë e ekonomisë familjare. Për të provuar sa më sipër, ajo paraqiti një deklaratë noteriale<sup>39</sup> të lëshuar nga prindërit e bashkëshortit, të cilët kanë deklaruar se nga kursimet e tyre ndër vite i kanë dhuruar djalit të tyre në vitin 2007 shumën 700.000 lekë.

62. Në vijim të hetimit administrativ nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqiste dokumentacionin që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të bashkëshortit të saj, që kanë mundësuar dhurimin e kësaj shume, duke paraqitur dokumentacionin që provon punësimin e tyre në vitet 1994 – 2007, nga Drejtoria Rajonale Fier e ISSH-së<sup>40</sup>, si dhe dokumentacionin për të ardhurat e realizuara nga aktiviteti tregtar i kumatit të saj, “E.Z.”, person fizik, si pjesë e bashkësisë familjare të kohës.

63. Në vijim të analizës financiare të kryer për prindërit e bashkëshortit të subjektit, duket se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhurimin e shumës 700.000 lekë, bashkëshortit të saj.

64. Në përmbledhje të burimeve të sipërtrajtuara ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë në analizë, prej – 70.789 lekësh, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme.

<sup>39</sup> Deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, të datës 9.3.2020.

<sup>40</sup> Vërtetimet nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.2.2020 dhe nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.2.2020.

**Tabela nr. 2 – Analiza për blerjen e apartamentit**

Te ardhura te subjektit nga Shk. Magjistratures	680,000
Te ardhura nga paga e b/shortit	697,500
Te ardhura nga qiradhenia e dyqanit	200,000
Dhurate nga prinderit e b/shortit	700,000
Shpenzime jetese 1.10.2005 - 11.6.2007	(595,472)
Shpenzime udhetimi 1.10.2005 - 11.6.2007	(341,411)
Terhequr nga depozitat bankare	1,980,000
Depozituar ne T. Bank nga b/shorti	(247,406)
Shpenzim per blerjen e apartamentit	(3,144,000)
<b>Rezultati në 11.6.2007</b>	<b>(70,789)</b>

65. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit nga sa ka rezultuar se:

➤ *Duket se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit sa i përket burimeve të krijimit të pasurisë në analizë, në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2007, krahasuar me atë Vetting, në të cilën nuk është deklaruar burimi nga dhurimi prej prindërve, në vlerën 700.000 lekë.*

➤ *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përfitimin nga ana e bashkëshortit të saj të dhurimit nga ana e babait të tij, të pjesës takuese nga të ardhurat nga qiradhenia e objektit në bashkëpronësi dhe kjo nuk rezulton e provuar me dokumente të kohës.*

➤ *Duket se bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 burimin e krijimit të depozitës së tij bankare.*

➤ *Duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë në analizë, prej – 70.789 lekësh.*

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

66. Në shpjegimet e depozituara me prapësimet subjekti ka sqaruar se në deklaratën e pasurisë Vetting nuk është shprehur specifikisht e ardhura me burim dhuratë nga prindërit e bashkëshortit në shumën 700.000 lekë, e cila, në fakt, buron kryesisht nga të ardhurat neto të aktivitetit, ndërkohë në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2007 ka deklaruar si një ndër burimet e krijimit të pasurisë, [...], *dhuratë nga prindërit e bashkëshortit në shumën 700.000 lekë.* Po ashtu, sikurse ka rezultuar në analizën financiare të kryer për vlerësimin e mundësisë financiare të prindërve të bashkëshortit, ata kanë pasur mjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të tyre për dhurimin e kësaj shume.

67. Në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratën e pasurisë Vetting nuk ka ndryshim mes deklarimeve për burimin e ligjshëm, pasi ato grupohen nga dy burime: (i) kursime nga të ardhurat nga pagat; (ii) të ardhurat nga aktiviteti ekonomik, të dyja burime të ligjshme, të provuara me dokumentacion justifikues. Por edhe nëse do të konsiderohet e kundërta, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka tashmë një praktikë të konsoliduar sa i takon pasaktësisë në deklaram të pashoqëruar me pamjaftueshmëri burimesh financiare të ligjshme, që në asnjë rast nuk e ngarkon subjektin me përgjegjësi.

68. Lidhur me gjetjen se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të vërtetuar mundësinë e saj financiare për blerjen e apartamentit në datën 11.6.2007, do të ndryshonte, pasi, të ardhurat nga pagat e përlllogaritura sipas të hyrave/kreditimeve të llogarisë së saj të pagës dhe asaj të bashkëshortit në “Raiffeisen Bank” për periudhën 1.10.2005 – 11.6.2007, rezultojnë të ndryshme nga përlllogaritjet në analizën e Komisionit. Në kolonën e dytë të tabelës paraqitet versioni i rregulluar në reflektim të vlerave të konstatuara nga përlllogaritjet e kryera prej saj. Vetëm duke bërë këtë ndryshim diferenca negative do të kthehej në pozitive. Komisioni ka përdorur tërheqjet nga llogaritë bankare si burim për krijimin e pasurisë apartament. Komisioni ka konsideruar gjithashtu si shpenzim në përlllogaritje (fluks dalës) krijimin e depozitës në “Tirana Bank”, e cila daton më 24.11.2006, në shumën 2.000 euro. Në kolonën e tretë të tabelës ka korrektuar shpenzimet e udhëtimit si shpjeguar në vijim dhe ka pasqyruar zërin *ndryshim gjendje likuiditeti* balancë më 11.6.2007, krahasuar me balancën e llogarive bankare të saj dhe bashkëshortit, më 1.10.2005 (aneksi nr. 1 përlllogaritja e zërit ndryshim likuiditeti).
69. Nga sa më sipër, subjekti, nëpërmjet shpjegimeve të dhëna më sipër, ka kërkuar që të ardhurat nga qiraja të përfshihen në analizë në masën 100%, si edhe shuma 400.000 lekë e deklaruar *depozitë me burim të ardhura nga aktiviteti* në deklaratën e interesave privatë pas largimit nga detyra 1.1.2005 - 30.9.2005 ku, në përfundim, rezulton se pasuria apartament është blerë më 11.6.2007, me të ardhura nga burime të ligjshme, duke rezultuar me balancë pozitive prej 595.505 lekësh.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

70. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit lidhur me mospërputhjen midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për sa i përket burimeve të krijimit të pasurisë, në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2007, krahasuar me deklaratën *Vetting*, vlerëson se mbetet një pasaktësi e cila për sa kohë nuk shoqërohet me mungesa financiare, për sa kohë burimi i krijimit rezulton e provuar me dokumentacion, si dhe për më tepër dhurimi rezulton i deklaruar në mënyrë të qartë në deklaratën e vitit 2007.
71. Nisur nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacioni i paraqitur, trupi gjykues, duke mbajtur në vëmendje faktin se të ardhurat nga qiraja dhe enfitëza janë të ardhura me burime të ligjshme, referuar kësaj marrëdhënieje juridiko - civile, të provuara me dokumentacion – përpos pasaktësisë së mosdeklarimit saktësisht të këtij burimi, për sa kohë nuk shoqërohet me mungesë financiare – vlerëson bindës shpjegimin e subjektit të rivlerësimit e, në përfundim, çmon se kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë në analizë.
72. Lidhur me mosdeklarimin nga ana e personit të lidhur të burimit të krijimit të depozitës në DIPP-në e vitit 2004, rezultati i njoftuar subjektit nuk ndryshon, duke e klasifikuar atë si një pasaktësi, e cila, e pashoqëruar me mungesë të burimit të ligjshëm, nuk e ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit.

### **2. Supermarket për pjesë këmbimi dhe godinë banimi në “\*\*\*\*”, “\*\*\*\*”**

73. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2003 si dy pasuri, përkatësisht: (i) banesë private me sipërfaqe 80 m<sup>2</sup>, në të njëjtën ndërtesë me banesën e prindërve të bashkëshortit, me vlerë 3.500.000 lekë; (ii) dyqan për tregtimin e pjesëve

auto/vajra lubrifikantë, që ndodhet në të njëjtën ndërtesë me banesën, me vlerë të deklaruar 7.000.000 lekë, për të dyja këto pasuri subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se janë *ndërtuar në vitin 1998*.

74. Ndërsa në DIPP-në para fillimit të detyrës si prokuror në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit supermarket dhe shtëpi banimi, me sipërfaqe 251 m<sup>2</sup>, me vlerë 250.000 euro, duke shpjeguar se trualli është marrë nga shteti, ndërsa objekti është ndërtuar ndër vite, prej vitit 1995 e në vazhdim, nga vjehri dhe bashkëshorti me të ardhurat nga pagat dhe nga dyqani.
75. Në deklaratën *Vetting*, pasuria është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me sipërfaqe totale 634 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi të tij dhe të babait të tij, me burim krijimi nga të ardhurat nga puna e prindërve të tij dhe nga shitja e apartamentit të mëparshëm. Ai ka deklaruar vlerën e rivlerësuar të objektit nga ZVRPP-ja Fier prej 11.295.000 lekësh<sup>41</sup>. Bashkëshorti i subjektit ka shpjeguar se në këtë godinë ndodhen: (i) banesa prej 80 m<sup>2</sup>, ku ka jetuar më herët së bashku me subjektin e rivlerësimit dhe se aktualisht aty nuk banon askush; dhe (ii) biznesi nga i cili fitimi është ndarë çdo vit me marrëveshje verbale në 50% ose 40% ndërmjet tij dhe familjes së babait, për shkak të marrëdhënies së posaçme.
76. E pyetur në lidhje me mospërputhjet midis deklaramëve të saj në deklaratat periodike vjetore dhe *Vetting*, për sa i përket sipërfaqes së objekteve dhe vlerave të tyre, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ajo është shprehur se në vitet 2003 dhe 2007 ka deklaruar vlerat e menduara të tregut të objekteve për kohën e deklaramit. Ndërsa, sa i përket sipërfaqeve ka bërë me dije se në vitin 2007 i është referuar vërtetimit hipotekor të vitit 2006, ku është cituar sipërfaqja 251 m<sup>2</sup>, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar sipërfaqen totale 634 m<sup>2</sup> sipas aktit të kolaudimit.
77. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Fier<sup>42</sup>, kjo e fundit ka bërë me dije se nga verifikimi i të dhënave dixhitale ka rezultuar se në emër të shtetasve E.Z., E.Z., L.Z., dhe Mirela Zavalani figurojnë pasuritë si vijon: (a) *Pasuria e llojit ndërtesë godinë banimi 2 kate, ku kati përdhe 172 m<sup>2</sup> dhe kati i parë 178.1 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe totale 172 m<sup>2</sup>, e ndodhur në z. k. “\*\*\*\*”, me nr. pasurie “\*\*\*\*”, e regjistruar me anë të lejes së legalizimit nr. “\*\*\*\*”, datë 28.2.2020, me shënimin në seksionin D “objekti pozicionohet mbi pasurinë nr. “\*\*\*\*” dhe shënimin në seksionin E “mungojnë marrëdhëniet me truallin, në pritje të VKM-së”;* dhe (b) *pasuria e llojit ndërtesë godinë ekonomike 2 kate, ku kati përdhe 105.4 m<sup>2</sup> dhe kati i parë 96.1 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe totale 105.4 m<sup>2</sup>, e ndodhur në z. k. “\*\*\*\*”, me nr. pasurie “\*\*\*\*”, regjistruar me anë të lejes së legalizimit nr. “\*\*\*\*”, datë 28.2.2020, me shënimin në seksionin D “objekti pozicionohet mbi pasurinë nr. “\*\*\*\*” dhe shënimin në seksionin E “mungojnë marrëdhëniet me truallin, në pritje të VKM-së”.*
78. Gjithashtu, bashkëlidhur ka rezultuar dokumenti deklaratë noteriale<sup>43</sup> e bashkëshortit të subjektit dhe prindërve të tij, ku kanë deklaruar se ndonëse procedurat e legalizimit janë kryer nga z. E.Z., regjistrimi i pasurisë të vazhdojë edhe në emër të z. E.Z., pasi djali i tyre ka kontribuar në ndërtimin e këtij objekti. Ndërkohë, me qëllim vijimin dhe regjistrimin e pasurisë në emër të bashkëshortit, ka rezultuar se subjekti kishte nënshkruar një deklaratë

<sup>41</sup> Vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 11.12.2006 për pasurinë me nr. “\*\*\*\*”, z. k. “\*\*\*\*”, ndërtesë me sip. 251 m<sup>2</sup>, në “\*\*\*\*”, në bashkëpronësi të shtetasve E., dhe E.Z., bërë rivlerësimi në vlerën 11.295.000 lekë, në vitin 2012.

<sup>42</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 14.9.2021.

<sup>43</sup> Deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 24.2.2020.

noteriale<sup>44</sup>, ku kishte shprehur dakordësinë që pasuria në fjalë të regjistrohej në emër të bashkëshortit dhe prindërve të tij, pasi në këtë pasuri është investuar prej tyre përpara martesës së saj. Në dosje ndodhet një urdhër i brendshëm nr. “\*\*\*\*”, datë 26.2.2020 për ndryshimin e bazës dixhitale të dhënave, duke urdhëruar vijimin e procedurave vetëm në emër të poseduesve E., L., dhe E.Z., duke përjashtuar subjektin e rivlerësimit. Pasuria është regjistruar në emër të shtetasve E., E., L., dhe Mirela Zavalani.

79. ASHK Fier<sup>45</sup> ka vënë në dispozicion dosjen e pasurive të sipërcituara, mes të cilave ka rezultuar se investitori E.Z., (vjehtëri i subjektit) ka dorëzuar dokumentacionin: (i) formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e objektit informal me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 15.11.2006; (ii) akt kolaudimi datë 20.10.2006 për kolaudimin e objektit “market dhe banesë 3 kate” me sipërfaqe sheshi 500 m<sup>2</sup>, sipërfaqe bodrumi 79 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi e katit përdhe (market) 251 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe e katit të parë (banesë) 304 m<sup>2</sup>, nga ku sipërfaqja totale rezulton 634 m<sup>2</sup>; (iii) akt kontrolli datë 11.6.2006 nga përfaqësuesit e seksionit të urbanistikës së Këshillit të Qarkut Fier, të cilët gjatë kontrollit kanë konkluduar se ka përfunduar objekti dhe se është zbatuar projekti teknik; (iv) leje shfrytëzimi datë 6.11.2006 i objektit “market dhe banesë”, ku është cituar se objekti ka filluar funksionimin sipas destinacionit të miratuar në sheshin dhe lejen e ndërtimit; (v) vendimi nr. “\*\*\*\*”, datë 8.12.1995, i Këshillit të Bashkisë “\*\*\*\*” për dhënie sheshi ndërtimi me sipërfaqe 800 m<sup>2</sup>; (vi) leje ndërtimi për objektin supermarket me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 26.3.1996, të KRT-së Fier<sup>46</sup>. Në përfundim të sa më sipër, duket se sipërfaqja totale e ndërtimit të të dyja godinave është në total 551.6 m<sup>2</sup>.
80. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bënte me dije mbi periudhën e saktë të ndërtimit të këtyre pasurive, duke shoqëruar përgjigjen me dokumentacion që mund të provojë shpenzimet e kryera për këtë ndërtim, subjekti i rivlerësimit është shprehur se ndërtimi ka filluar në vitin 1994 me sheshimin e sipërfaqes së truallit dhe ndërtimit pjesor të banesës.
81. Më tej ka vijuar ndërtimi i dy kateve të banesës dhe i një pjese të dyqanit prej 35 m<sup>2</sup> nga viti 1995 deri në vitin 1998, ndërtim ky që referuar shpjegimeve të babait të bashkëshortit është kryer konkretisht: (i) në vitin 1994 është ndërtuar 100% kati përdhe i banesës; (ii) në vitin 1995 është ndërtuar rreth 20% i katit të parë të banesës; (iii) në vitin 1996 rreth 30% e punimeve të katit të parë të banesës; (iv) në vitin 1997 është kryer rreth 30% e punimeve të katit të parë të banesës dhe pjesa më e madhe e punimeve për njësinë; dhe (v) në vitin 1998 është kryer rreth 20% e punimeve të katit të parë të banesës dhe përfundimi i njësisë. Pjesa e mbetur e njësisë ka vijuar të ndërtohet në vitet 2004 – 2006, përkatësisht 45%, 45% dhe 10% e punimeve. Për ndërtimin e tyre, subjekti është shprehur se punëtoria është kryer nga babai i bashkëshortit, i asistuar nga vëllai i tij dhe disa të afërm, duke paraqitur disa deklarata noteriale<sup>47</sup> të këtyre të fundit, ku kanë deklaruar se kanë dhënë kontributin e tyre fizik në ndërtimin e objektit, për shkak të lidhjeve familjare dhe miqësore.

<sup>44</sup> Deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.2.2020.

<sup>45</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 24.11.2022.

<sup>46</sup> Pas verifikimit në terren sipas procesverbalit të datës 26.2.2020 ka rezultuar se ndërtimi informal ekonomik ka sipërfaqe totale 201.5 m<sup>2</sup>, nga ku kati përdhe 105.4 m<sup>2</sup> dhe kati i parë 96.1 m<sup>2</sup>, ndërsa ndërtimi informal godinë banimi me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 500 m<sup>2</sup>, ka sipërfaqe totale ndërtimi 350.1 m<sup>2</sup>, nga ku kati përdhe 172 m<sup>2</sup> dhe kati i parë 178.1 m<sup>2</sup>.

<sup>47</sup> Deklarata noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 23.11.2022; deklarata noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 23.11.2022, deklarata noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 5.12.2022.

82. Nga verifikimet e kryera nga Komisioni në faqen zyrtare të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor<sup>48</sup> ka rezultuar se imazhi i parë për këtë pasuri paraqitet në vitin 1994, nga ku dallohet një gjurmë ndërtimi i godinës së banimit, së paku njëkatëshe. Imazhi i radhës paraqitet në vitin 2001, në të cilin duket se godina e banimit është e përfunduar, pasi paraqitet në të njëjtën gjendje me imazhet e mëvonshme. Ndërsa, njësia e shërbimit duket se është pjesërisht e ndërtuar, me përafërsi rreth 1/3 e ndërtimit të katit të parë.
83. Me qëllim saktësimin e periudhës së ndërtimit, Komisioni i është drejtuar edhe ASIG-ut<sup>49</sup> për të dërguar pamjet imazherike të disponuara prej tyre përgjatë periudhës 1993 – 2006, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ASIG-u ka vënë në dispozicion<sup>50</sup> ortofotot e vitit 1994 dhe ato të vitit 2001, duke bërë me dije se për territorin në të cilën ndodhet pasuria, disponohen vetëm fotografimet ajrore të viteve të sipërcituara. Po ashtu, edhe nga verifikimet e kryera nga Komisioni në aplikacionin *Google Earth Pro*<sup>51</sup> është konstatuar se imazhi i parë për këtë pasuri paraqitet në muajin korrik 2004, në të cilin duket se ndërtesa e banimit paraqitet në të njëjtën gjendje si në atë të vitit 2001 dhe në ato të mëtejshme, ndërsa pjesa e njësisë së shërbimit përpara godinës së banimit duket sërish e papërfunduar, por ka një ndryshim me imazhin e vitit 2001, ku duket se është kryer një ndërtim shtesë prej rreth 1/3 në katin e parë.
84. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka paraqitur edhe një raport vlerësimi tekniko-ekonomik, të datës 12.12.2022, i përgatitur sipas pretendimeve të subjektit nga ekspertë të fushës mbi periudhat e ndërtimit, sipas të cilit kostoja totale e ndërtimit ka qenë rreth 4.017.937 lekë.
85. Komisioni, nëpërmjet shkresës nr. “\*\*\*\*” prot., datë 27.5.2021, i ka kërkuar ILDKPKI-së informacion dhe dokumentacion të mundshëm të dorëzuar prej subjektit pranë këtij institucioni. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 4.6.2021, ka paraqitur një procesverbal të mbajtur në datën 24.3.2016 “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive”, ku ajo është shprehur se: *“Banesa është ndërtuar ndër vite duke filluar nga viti 1995 e më tej. Ky objekt është ndërtuar nga babai i bashkëshortit dhe bashkëshorti im me të ardhurat e tyre familjare të krijuara ndër vite. Sqaroj se ky objekt është bërë para martesës sime dhe është në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe babait të tij”*.
86. Nisur nga sa është përshkruar më sipër, ky deklaram duket kontradiktor në pjesën ku pretendohet se objekti është ndërtuar totalisht përpara martesës së saj, ndërkohë që, në përgjigje të pyetësorit, vetë subjekti i rivlerësimit ka pohuar se ndërtimet kanë vijuar (së paku) edhe në vitet 2004 – 2006.
87. Për sa më sipër, Komisioni ka përllogaritur koston e këtij ndërtimi, duke konsideruar periudhën e ndërtimit sipas specifikimeve të dhëna nga subjekti, me kostot mesatare të ndërtimit të banesave, të përcaktuara nga EKB-ja për vitet përkatëse<sup>52</sup>, duke zbritur kostot për fitimin e planifikuar dhe fondin rezervë<sup>53</sup> e, në përfundim të së cilës, ka rezultuar një kosto totale prej 8.634.323 lekësh, sipas detajimit në tabelën në vijim, nga ku faza e parë e

<sup>48</sup> <https://geoportal.asig.gov.al/>

<sup>49</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 24.4.2023.

<sup>50</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 28.4.2023.

<sup>51</sup> Objekti me koordinatat “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”.

<sup>52</sup> Për vitin 1994, për të cilin EKB-ja nuk ka një përcaktim të koston mesatare të ndërtimit është konsideruar vlera e vitit 1995, e korrektuar kjo me normën e inflacionit të atij viti.

<sup>53</sup> Në referencë të jurisprudencës së Kolegjit, vendimet nr. 6, datë 17.3.2022 (JR) dhe nr. 7, datë 29.3.2022.

ndërtimit 4.830.371 lekë (në vitet 1994 – 1998) dhe faza e dytë e ndërtimit 3.803.952 lekë (në vitet 2004 – 2006).

88. Kjo përllogaritje është kryer me këtë mënyrë të shpërndarjes së shumave të investuara si më sipër, duke marrë për bazë faktet se: (i) sipas *Google Earth* dhe ASIG-ut, së paku deri në vitin 2001, ku ka përfunduar ndërtimi i fazës së parë të pretenduar nga subjekti, pra ndërtimi i godinës së banimit dhe pjesërisht rreth 34.46 m<sup>2</sup> të njësisë së shërbimit; (ii) në deklarin e parë të subjektit në vitin 2003 është shënuar për godinën e banimit dhe njësinë “ndërtuar në vitin 1998”; (iii) shitja prej prindërve të bashkëshortit të subjektit të apartamentit të tyre ekzistues në vitin 1999, është një *indicie* se, së paku, godina e banimit në atë periudhë ka qenë minimalisht e banueshme.

**Tabela nr. 3 – Kostot e ndërtimit të objektit “banesë 3 kate dhe supermarket”**

Viti	1994	1995	1996	1997	1998	2004	2005	2006
Sipërfaqja e banesës	172.00	207.62	261.05	314.48	350.10			
Sipërfaqja e dyqanit				27.57	34.46	109.63	184.80	201.50
Sipërfaqja e ndërtuar brenda vitit	172.00	35.62	53.43	81.00	42.51	75.17	75.17	16.70
Kosto ndërtimi/m <sup>2</sup>	11,363.45	12,323.45	11,957.86	11,957.86	19,510.38	22,185.14	23,318.51	22,960.57
<b>Kosto e ndërtimit</b>	<b>1,954,514</b>	<b>438,961</b>	<b>638,908</b>	<b>968,563</b>	<b>829,425</b>	<b>1,667,612</b>	<b>1,752,806</b>	<b>383,533</b>

### 2.1 Analiza e burimeve për ndërtimin e pasurisë

89. Për ndërtimin e objektit nga ana e prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka bërë me dije se kanë shërbyer: (i) të ardhurat e tyre nga punësimi ndër vite; (ii) të ardhurat nga interesa të fituar nga investimi në firmat rentiere “\*\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*\*”; (iii) të ardhurat nga dyqani; (iv) të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm; (v) një hua e marrë nga shtetasi I.Ç., në shumën 3.000.000 lekë.
90. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se: (a) të ardhurat nga punësimi i prindërve të bashkëshortit të subjektit, përgjatë periudhës 1994 – 2006, kanë qenë në masën totale 6.275.104 lekë, sipas të dhënave të konfirmuara nga ISSH Fier<sup>54</sup>; (b) subjekti ka paraqitur një kontratë shitblerjeje të vitit 1999<sup>55</sup>, me anë të së cilës prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë shitur një apartament të ndodhur në “\*\*\*\*\*”, “\*\*\*\*\*”, kundrejt çmimit 300.000 lekë<sup>56</sup>; (c) huaja e marrë nga vjehri i subjektit të rivlerësimit prej z. I. Ç., sipas deklaratës noteriale nr. “\*\*\*\*\*”, datë 26.11.2005, ka marrë hua vlerën prej 3.000.000 lekësh, përkatësisht 1.500.000 lekë në datën 26.10.2002 dhe 1.500.000 lekë në datën 3.6.2004, të cilat referuar shpjegimeve të subjektit janë depozituar prej bashkëshortit të saj në llogaritë e tij bankare.
91. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit ka rezultuar se shuma e parë është tërhequr prej tij në vitin 2003 (përkatësisht 800.000 lekë në datën 20.8.2003 dhe 544.000 lekë në datën 10.9.2003), ndërsa shuma e dytë në datën 12.5.2005, nga ku duket se këto mund të ishin përdorur për vijimin e punimeve të ndërtimit të njësisë dhe jo për ndërtimin e banesës, e cila duket e përfunduar maksimalisht në vitin 2001, ndonëse nuk përjashtohet mundësia që të jenë kryer investime pas vitit 2001, për punime të brendshme.

<sup>54</sup> Shkresat nr. “\*\*\*\*\*” prot., datë 25.2.2020 dhe nr. “\*\*\*\*\*” prot., datë 25.2.2020.

<sup>55</sup> Kontrata nr. “\*\*\*\*\*”, datë 7.5.1999.

<sup>56</sup> Apartamenti ishte përfituar më herët nga prindërit nëpërmjet privatizimit të banesave shtetërore, me anë të kontratës së datës 15.12.1993.

92. Gjithashtu, të ardhurat nga dyqani pjesë këmbimi, për sa kohë ky aktivitet është regjistruar në muajin prill të vitit 2004, mund të kenë shërbyer si burim për ndërtimin e pjesës së mbetur të njësisë, përgjatë periudhës 2004 – 2006.
93. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet, DRT Fier ka paraqitur të dhënat mbi fitimin e realizuar duke filluar nga viti 2008, ndërsa për vitet e mëparshme disponojnë vetëm qarkullimin vjetor të deklaruar. Nga DRT Fier dhe nga Bashkia “\*\*\*\*” janë konfirmuar pagimet e detyrimeve tatimore nga ky aktivitet për të gjitha vitet e ushtrimit të aktivitetit. Për sa i përket fitimit neto për vitet në të cilat nuk disponohet kjo e dhënë, nga Komisioni është përlllogaritur një mesatare e marzhit të fitimit të viteve të mëpasshme, nga ku ka rezultuar një mesatare prej 15% e qarkullimit të deklaruar. E pyetur nga Komisioni, subjekti është shprehur se periudha për të cilën disponohen të dhënat mbi fitimin e aktivitetit, i përket periudhës në të cilën personi fizik nuk ka pasur shpenzime të qirasë për ambientin, duke bërë që marzhi i rezultuar prej 15% të jetë më i ulët se marzhi real i fitimit në vitet e mëparshme, ku shpenzimi i qirasë nuk ka ekzistuar.
94. Në vijim të sa më sipër, Komisioni ka kryer korrektimin e marzhit të fitimit bruto për vitet 2008 – 2015, duke i shtuar qiranë e paguar në këto vite, për të pasur një pasqyrë më të qartë të situatës në rast se ky shpenzim nuk do të kishte ekzistuar edhe në këto vite. Nga korrektimi me shpenzimin e qirasë ka rezultuar një marzh fitimi bruto mesatar prej 35%, i cili është aplikuar nga Komisioni edhe në vitet 2004 – 2007 dhe është zbritur tatimi i paguar prej personit fizik “E.Z.”. Në vijim të sa më sipër, ka rezultuar se të ardhurat nga ky aktivitet përgjatë periudhës së analizuar kanë qenë përkatësisht 574.789 lekë në vitin 2004, 578.019 lekë në vitin 2005, 768.952 lekë në vitin 2006 dhe 793.385 lekë në vitin 2007.
95. Nga shqyrtimi dokumentacionit të kohës së ndërtimit ka rezultuar se në lejen e ndërtimit të vitit 1996 dhe në lejen për dhënien e sheshit të ndërtimit të vitit 1995, përpos emrit të vjehrrit të subjektit, është edhe emri i bashkëshortit të subjektit në seksionin e investitorit të pasurisë që do të ndërtohej. Gjithashtu, edhe në deklaratën noteriale<sup>57</sup> të vitit 2020, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe prindërit e tij kanë deklaruar se ndonëse procedurat e legalizimit janë kryer nga z. E.Z., regjistrimi i pasurisë të vazhdojë edhe në emër të z. E.Z., pasi djali i tyre ka kontribuar në ndërtimin e këtij objekti.
96. Komisioni ka konsideruar ndërtimin e godinës së banimit dhe asaj të shërbimit, sipas viteve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, duke përfshirë për pjesën e parë të ndërtimit vetëm të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit, bazuar në këto fakte: (i) për ndërtimin e pjesës së parë të ndërtimit përgjatë periudhës 1994 – 1998, subjekti nuk kishte lidhur martesë me bashkëshortin dhe as ky i fundit nuk kishte gjeneruar të ardhura financiare në atë periudhë; (ii) përgjatë periudhës së ndërtimit të fazës së dytë të godinës në analizë, subjekti i rivlerësimit ka filluar Shkollën e Magjistraturës, duke jetuar në Tiranë, gjatë viteve 2005 – 2007; (iii) subjekti ka deklaruar se ajo ka pasur një ekonomi të ndarë familjare nga prindërit e bashkëshortit të saj; (iv) subjekti i ka kërkuar ASHK-së në vijim, me anë të një deklaratë noteriale në kohën që po kryhej regjistrimi i pasurisë, që ajo të mos regjistrohej edhe në emër të saj, për shkak se vetë subjekti nuk ka kontribuar në ndërtim; si dhe (v) në DIPP-në e vitit 2003, kur është deklaruar për herë të parë pasuria në fjalë, ajo ka deklaruar se ndërtimi është kryer në vitin 1998 nga vjehri dhe bashkëshorti i saj.

<sup>57</sup> Deklarata noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 24.2.2020.



97. Për pjesën e dytë të ndërtimit, përgjatë periudhës 2004 – 2006, pas martesës së subjektit me bashkëshortin, Komisioni ka kryer analizën financiare, duke konsideruar kontribut të barabartë mes saj dhe bashkëshortit, si dhe prindërve të tij, përkatësisht në masën 1.901.796 lekë për secilën familje.
98. Në vijim të sa më sipër, nga analiza financiare ka rezultuar se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej - 4.503.237 lekësh për periudhën 1994 – 1998, ndërsa për ndërtimin e fazës së dytë, në vitet 2004 – 2006, ata do të kishin mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.
99. E po ashtu, ka rezultuar se prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për dhurimin e shumës 700.000 lekë në vitin 2007.

**Tabela nr. 4 – Analiza financiare për ndërtimin e objektit**

Te ardhura te babait b/shortit 1994 - 1998	520,961
Te ardhura te nenes b/shortit 1994 - 1998	441,197
Shpenzime jetese 1994 - 1998	(635,024)
Shpenzimet e ndertimit 1994 - 1998	(4,830,371)
<b>Rezultati ne 1998</b>	<b>(4,503,237)</b>
Te ardhura te babait b/shortit 1999 - 2006	1,767,325
Te ardhura te nenes b/shortit 1999 - 2006	1,545,621
Te ardhura te vellaib b/shortit 2004 - 2006	1,921,760
Te ardhura nga shitja e pasurise	300,000
Te terhequra nga depozita e b/shortit 2003 & 2005	3,000,000
Kthyer pjese e huas z. I. Ç. ne nentor 2005	(300,000)
Shpenzime jetese 1999 - 2006	(2,302,029)
Shpenzimet e ndertimit 2004 - 2006	(1,901,976)
<b>Rezultati ne 2006</b>	<b>4,030,701</b>
Te mbartura pas ndertimit	4,030,701
Dhene bashkeshortit te subjektit ne vitin 2007	(700,000)
Te ardhura te babait b/shortit janar - qershor 2007	199,884
Te ardhura te nenes b/shortit janar - qershor 2007	141,198
Te ardhura te vellaib b/shortit janar - qershor 2007	396,692
Shpenzime jetese janar - qershor 2007	(164,336)
<b>Rezultati ne qershor 2007</b>	<b>3,904,140</b>

100. Nga sa më lartpërshkruar, ka rezultuar se për ndërtimin e godinës së banimit dhe njësisë së shërbimit, prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -4.503.237 lekësh, përgjatë periudhës 1994 – 1998, nga sa është përshkruar, Komisioni i ka kërkuar subjekti të rivlerësimit shpjegime.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

101. Në prapësimet e dërguara subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në mënyrë të përmblodhur se ashtu sikurse është shpjeguar edhe më parë, ndërtimi ka filluar në vitin 1994 me ndërtimin pjesor të banesës, e më tej ka vijuar ndërtimi i dy kateve të banesës dhe i një pjese të dyqanit prej 35m<sup>2</sup> nga viti 1995 deri në vitin 1998, ndërtim që referuar përgjigjeve të vjehrrit të saj, është kryer konkretisht: (i) në vitin 1994 është ndërtuar 100% kati përdhe i banesës; (ii) në vitin 1995 është kryer rreth 20% e ndërtimit të katit të parë të banesës; (iii) në vitin 1996 rreth 30% e punimeve të katit të parë të banesës; (iv) në vitin 1997 është kryer rreth 30% e punimeve të katit të parë të banesës dhe pjesa më e madhe e punimeve për njësinë; (v) në vitin 1998 është kryer rreth 20% e punimeve të katit të parë të banesës dhe përfundimi i njësisë.
102. Lidhur me konstatimin mbi mungesën e burimeve të ligjshme financiare përgjatë periudhës 1994 – 1998 të prindërve të bashkëshortit, ajo është shprehur se në ndryshim nga sa është

konstatuar nga Komisioni, ekspertët vlerësues kanë përlogaritur kostot e ndërtimit për objektin në “\*\*\*\*” bazuar në manualet referuese të kohës dhe legjislacionit në fuqi. Ndërkohë që Komisioni i referohet jurisprudencës së Kolegjit për elementet e kostos së përcaktuar në udhëzimin 2, datë 8.5.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të pakombinuar me elemente të tjera të përcaktuara me ligj, të cilat janë marrë në konsideratë në hartimin e raportit nga vlerësuesit. Komisioni, për vitin 1994, ka përlogaritur koston e ndërtimit për sipërfaqen 172 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.954.514 lekë ose 73 herë më të lartë se kostoja e përlogaritur nga vlerësuesit (26.832 lekë). Kjo kosto e përlogaritur nga Komisioni është disproporcionale me të ardhurat nga pagat për këtë vit.

103. Gjithashtu, kostoja e apartamentit të përfituar prej babait të bashkëshortit me kontratë privatizimi në vitin 1993, ka qenë 3.317 lekë dhe shitur me kontratën e vitit 1999<sup>58</sup> në vlerën 300.000 lekë, ku çmimi i shitjes për metër katror ka qenë rreth 5.200 lekë/m<sup>2</sup>. Pra, si mund të ketë qenë kostoja e ndërtimit në vitin 1994, 11.363 lekë/m<sup>2</sup> e, për rrjedhojë, i ka kërkuar Komisionit ta konsiderojë në analizën financiare koston e ndërtimit sipas aktit të ekspertimit të depozituar me provat e përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, datë 15.11.2022.
104. Lidhur me burimin e shumave të investuara për ndërtimin e banesës dhe sipërfaqes 35 m<sup>2</sup> së njësisë deri në fund të vitit 1998 subjekti ka shpjeguar se kanë qenë edhe të ardhurat nga interesa të përfituar nga firmat rentiere “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*” dhe se pavarësisht përpjekjeve për të siguruar dokumentacionin provues, në kushtet kur prindërit e bashkëshortit nuk kanë qenë subjekte deklaruese as ata dhe as ndonjë prej anëtarëve të familjes së tyre nuk kanë ruajtur dokumente, duke u ndodhur realisht në kushtet e parashikuara nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive.
105. Po ashtu, ajo ka deklaruar se me fillimin e bashkëjetesës me bashkëshortin e ka gjetur tërësisht të ndërtuar banesën, ku në një pjesë të saj ata edhe kanë jetuar, si dhe një pjesë e dyqanit ka qenë e ndërtuar, pasi aty vijohej të ushtrohej aktiviteti ekonomik nga familjarët e bashkëshortit, pra e gjithë banesa prej 35 m<sup>2</sup> nga pjesa e dyqanit, ka qenë e krijuar para regjimit martesor e, për rrjedhojë, nuk ka pasur dijeni mbi kostot e ndërtimit të objektit. Po ashtu, lidhur me dhënien e kontributit të bashkëshortit të saj në ndërtimin e objektit ka shpjeguar se i vetmi kontribut i tij ka qenë puna fizike, pasi ai nuk ka qenë në marrëdhënie punësimi.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

106. Trupi gjykues, duke pasur parasysh deklaratimet, shpjegimet, si dhe pasi analizoi koston e ndërtimit, vlerëson se për atë kohë sa nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion i kohës që të mund të provojë vlerën e investimit, nisur edhe nga jurisprudenca e Kolegjit, vlerat e referuara nga EKB-ja konsiderohen si i vetmi element referues, i cili veç të tjerash përbën një nivel minimal të kostove të ndërtimit për metër katror.
107. Lidhur me mungesën financiare të prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit përgjatë periudhës 1994 – 1998, Komisioni vlerëson se në këndvështrimin financiar nuk ka vend për ndryshime të rezultatit të njoftuar subjektit për këtë pikë. Ndërkohë, duke e vlerësuar këtë rezultat në raport me subjektin dhe me rivlerësimin e tij, vlen të theksohet se në kushtet që kjo mungesë financiare e prindërve të bashkëshortit të subjektit i referohet

<sup>58</sup> Kontrata nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 7.5.1999.

periudhës deri në vitin 1998, kur: (i) subjekti i rivlerësimit ende nuk kishte lidhur martesë me bashkëshortin, që ky të gëzonte statusin e personit të lidhur; (ii) edhe bashkëshorti i subjektit ende nuk ishte në marrëdhënie pune në mënyrë që të mund të kontribuonte në ndërtimin e pasurisë në analizë – trupi gjykues vlerëson se mungesa financiare e prindërve të bashkëshortit, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit<sup>59</sup> për këtë situatë, nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, me pasojë aplikimin e masës disiplinore.

108. Ndërsa nga analizimi i situatës financiare për kontributin në ndërtimin e objektit nga bashkëshorti i subjektit, sikurse është detajuar më sipër, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën – 1.479.821 lekë, për ndërtimin e pjesës së tyre prej 50% të njësisë së shërbimit, përgjatë viteve 2004 – 2006.

**Tabela nr. 5 – Analiza për kontributin në ndërtimin e objektit nga bashkëshorti i subjektit**

Viti	2004	1.1.2005 - 30.9.2005	1.10.2005 - 31.10.2007
Te ardhura te subjektit dhe b/shortit	1,067,540	785,132	3,058,441
Shpenzime te subjektit dhe b/shortit	(300,603)	(354,098)	(1,059,971)
Kontributi ne ndertim nga subjekti dhe b/shorti	(833,806)	(657,302)	(410,867)
Marre/Dhene babait te b/shortit (nga hua e I.Ç.)	1,500,000	(1,500,000)	
Investime te tjera te familjes			(3,344,000)
Ndryshimi ne likuiditetet	(1,844,782)	798,411	822,240
<b>Rezultati i periudhes</b>	<b>(411,651)</b>	<b>(927,858)</b>	<b>(934,158)</b>
<b>Rezultati vetem per ndertimin</b>	<b>(411,651)</b>	<b>(657,302)</b>	<b>(410,867)</b>

109. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit se shumat prej 1.500.000 lekësh/secila, që i janë dhënë babait të bashkëshortit për të vijuar me punimet, janë krijuar përkatësisht: (i) nga shumat e tërhequra prej bashkëshortit të subjektit në datat 20.8.2003 dhe 10.9.2003, si dhe disa kursime *cash* të saj dhe të bashkëshortit, deri në shtator të vitit 2003; (ii) shuma e tërhequr nga bashkëshorti i subjektit në datën 12.5.2005, së bashku me disa kursime *cash* të saj dhe të bashkëshortit, përfshirë këtu edhe të ardhurat e krijuara nga interesat e depozitave bankarë.
110. Në vijim të sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare për mundësinë e krijimit prej subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, të këtyre shumave. Nga analiza financiare e detajuar në tabelën e mëposhtme duket se mund të depozitohet shuma 2.000.000 lekë në vitin 2002, e përbërë kjo nga 1.500.000 lekë hua e marrë nga vjehri i subjektit tek z. I. Ç., dhe 500.000 lekë kursime nga të ardhurat e tyre.
111. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se së bashku me interesat e fituara, kjo depozitë, në muajin gusht 2003, ka arritur vlerën 2.544.580 lekë. Nga kjo shumë bashkëshorti i subjektit ka tërhequr 1.344.000 lekë (përkatësisht 800.000 lekë më 20.8.2003 dhe 544.000 lekë më 10.9.2003) dhe ka bërë me dije se së bashku me disa kursime të tyre prej 156.000 lekësh kanë përbërë shumën 1.500.000 lekë, të dhëna babait të bashkëshortit në vitin 2003, për të vijuar me punimet.

<sup>59</sup> Vendimet nr. 35, datë 22.9.2022, pika 51 dhe nr. 19 (JR), datë 10.6.2022, të Kolegjit.

112. Nga kjo analizë në vijim, gjithashtu, duket se nga subjekti dhe bashkëshorti mund të kursehej shuma 156.000 lekë, me burime të ligjshme financiare.

**Tabela nr. 6** – Analiza financiare për kthimin e shumës 1.500.000 lekë në vitin 2003

<b>Veprimet gjate periudhes 1999 - 2002</b>	<b>Shuma</b>
Te ardhura te subjektit 1999 - 2002	1,272,758
Te ardhura te b/shortit 1999 - 2002	593,565
Dhene nga babai b/shortit (nga huaja e marre nga I. Ç.)	1,500,000
Depozituar ne nentor 2002	(2,000,000)
Shpenzime jetese 1999 - 2002	(764,053)
<b>Rezultati në 2002</b>	<b>602,270</b>
<b>Veprimet gjate periudhes janar - gusht 2003</b>	<b>Shuma</b>
Depozituar gjate vitit 2003 (shkurt & maj)	(422,000)
Kthyer babait te b/shortit (nga huaja e marre nga I.Ç.) ne 2003	(1,500,000)
Terhequr nga depozita bankare ne 2003	1,344,000
Te ardhura te subjektit janar - gusht 2003	299,970
Te ardhura te b/shortit janar - gusht 2003	243,580
Shpenzime jetese janar - gusht 2003	(187,728)
<b>Mundesia per te kthyer shumen prej 1.500.000 leke</b>	<b>380,092</b>

113. Në përfundim të veprimeve të mësipërme, të kryera nga bashkëshorti i subjektit, në depozitën e tij në “Tirana Bank”, në datën 10.9.2003, kishte mbetur shuma 1.200.580 lekë. Kjo shumë është shtuar me të ardhurat nga interesat në periudhën shtator 2003 – maj 2005, duke arritur vlerën 1.315.000 lekë, të tërhequr prej bashkëshortit të subjektit në datën 12.5.2005. Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, është shprehur se kjo shumë, së bashku me disa kursime të saj dhe të bashkëshortit, prej 185.000 lekësh, i janë dhënë babait të bashkëshortit në vitin 2005 për të vijuar me punimet.
114. Nga analiza financiare duket se ata mund të kursenin shumën 185.000 lekë, me burime të ligjshme financiare.

**Tabela nr. 7** – Analiza financiare për kthimin e shumës 1.500.000 lekë në vitin 2005

Te ardhura te subjektit janar - prill 2005	180,000
Te ardhura te b/shortit janar - prill 2005	178,270
Terhequr nga depozita bankare ne 2005	1,315,000
Shpenzime jetese janar - prill 2005	(136,946)
Kthyer babait te b/shortit (nga huaja e marre nga I.Ç.) ne 2005	(1,500,000)
<b>Mundesia per te kthyer shumen prej 1.500.000 leke</b>	<b>36,324</b>

115. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se si burim krijimi ka shërbyer edhe një shumë e përfutur nga prindërit e bashkëshortit nga firmat piramidale/rentiere, për të cilën ka paraqitur një kontratë huaje në shumën 100.000 lekë me shoqërinë “\*\*\*\*”, por që nuk evidentohet nëse këto shuma janë tërhequr prej tij.

116. Komisioni ka kërkuar të dhëna për sa më sipër, pranë Ministrisë së Financave, shoqërive huamarrëse në administrim<sup>60</sup>, ka bërë me dije se z. E.Z., rezulton të jetë kreditor në shoqërinë “\*\*\*\*”, sipas kontratës me kapital të dorëzuar prej 100.000 lekësh, por që nuk ka tërhequr interesa dhe se nuk figuron të jetë kreditor në shoqëritë e tjera huamarrëse.
117. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se duket se për ndërtimin e kryer përgjatë periudhës 2004 – 2006, prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për pjesën e tyre të kontributit.
118. Ndërsa, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, për pjesën e tyre të kontributit në këtë ndërtim, gjatë periudhës 2004 – 2006, kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -1.479.821 lekësh.
119. Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse lidhur me të gjitha problematikat e konstatuara, si dhe për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit për këtë pasuri.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

120. Në prapësimet e depozituara subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nisur nga fakti që ndërtimi nuk është realizuar me shoqëri ndërtimi, Komisioni, përveç zbritjes në masën 8.83% të koston sipas EKB-së, duhet të zbresë nga kjo kosto edhe TVSH të pagueshme dhe sigurime shoqërore e shëndetësore. Arsyen përse duhet zbritur kjo kosto, sipas subjektit, e shpjegon marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, datë 17.5.2006, ku përcaktohet se TVSH-ja që krijohet në procesin e ndërtimit (puna e gjallë, shpenzimet plotësuese, ngritja e kantierit, lidhja me rrjetin, etj.) për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi apartament përfaqëson 27.4% të TVSH-së së llogaritur bazuar në çmimin e koston së ndërtimit në atë vit. Në zbatim të këtij parashikimi, nga kostoja e ndërtimit për çdo vit duhet zbritur 27.4% e TVSH-së dhe masa e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore që paguan shoqëria ndërtuese për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi apartament. Kontributi minimal i sigurimeve që duhet të paguajë shoqëria ndërtuese për 1 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi sipas marrëveshjes është 1.274 lekë (918 + 356 = 1.274 lekë) në zbatim të parashikimeve të marrëveshjes në fjalë, kostoja e ndërtimit për periudhën 2004 – 2006 do të ulet në vlerën 3.399.541 lekë nga 3.803.952 lekë, përllogaritur nga Komisioni.
121. Ndërtimi i objektit për periudhën 2004 – 2006 ka vijuar nga vjehri, pasi subjekti dhe bashkëshorti u martuan në vitin 1999 dhe bashkëshorti filloi punë në fillim të vitit 2000, ndërkohë jetonin në një pjesë të objektit më vete, ndërsa në vitin 2001 lind fëmija i parë. Në vitin 2002, kursimet e tyre, sikundër provuar edhe nga analiza financiare e Komisionit, kanë qenë në masën që lejonte ekonomia e kohës, me të ardhura nga pagat, familje me tre anëtarë, banesë pa qira. Në kushtet kur ekzistonte një pjesë e njësisë/sipërfaqja 34.6 m<sup>2</sup>, për shkak të nevojës për të siguruar ambient pune për djalin e vogël dhe ndërtimi nuk kishte përfunduar sipas lejes, babai i bashkëshortit huazoi burime financiare për të vijuar me zhvillimin e projektit. Kronologjia e ngjarjeve tregon mungesën e interesit të familjes së subjektit për të investuar në objekt. Pas 6 viteve eksperiencë pune si OPGJ, rritjes së fëmijës, me objektiv karrierën profesionale, u përgatit për konkursin e Magjistraturës gjatë vitit 2004 dhe vijoi

<sup>60</sup> Shkresa nr. “\*\*\*\*” prot., datë 13.1.2023.

studimet përkatëse në vitet 2005 – 2007. Nuk kishte kuptim të investonin në objektin në “\*\*\*”, ndërkohë që pritshmëritë ishin të vijonin jetesën në Tiranë.

122. Arsye tjetër që duhet të bindi Komisionin për investimin tërësor nga babai është ekzistenca e kontratave të kohës, të thjeshta dhe noteriale, që vërtetojnë plotësisht transaksionet e huamarrjes dhe atë të kthimit të huas nga ana e tij. Mundësia për kursime në shumën 3.9 milionë lekë e babait të bashkëshortit për periudhën 1999 – qershor 2007, nuk përkon me logjikën e marrjes së huas, pasi babai i bashkëshortit ka marrë hua 3.000.000 lekë, shlyen për këtë periudhë vetëm 300.000 lekë, ka investuar shumën 1.901.976 lekë dhe ka mundësi financiare të dhurojë shumën 700.000 lekë në vitin 2007. Ndërkohë familja e saj investon në ndërtim, krijon mungesë burimesh në vlerën -1.479.821 lekë, ndërsa në vitin 2006 likuidon 60% të vlerës së apartamentit.
123. Situata financiare e ndërtuar në këtë mënyrë nuk reflekton atë çka ka ndodhur realisht, atë çka ka deklaruar dhe rezulton e provuar me dokumentet shkresore, depozituar pranë Komisionit. Komisioni duhet të ketë qasje të njëjtë si në rastin kur nuk llogarit kursime *cash* për shkak se ajo nuk i ka disponuar për t’i deklaruar, ashtu edhe për vlerat e investimeve, të cilat nuk i ka kryer, ndërkohë që Komisioni i përlllogarit në analizë.
124. Indicie e vetme e Komisionit për të shpërndarë investimin në objekt për periudhën 2004 – 2006 ndërmjet vjehrrit dhe bashkëshortit është deklarata noteriale nr. “\*\*\*”, datë 24.2.2020, ku prindërit e bashkëshortit kanë deklaruar se *pavarësisht se vetëdeklarimi është bërë prej z. E. Z., procedurat e legalizimit [...] të vazhdojnë edhe në emër të djalit tonë E.Z., pasi edhe ai ka kontribuar në ndërtimin e këtij objekti [...]. Ky deklarim është shprehje e vullnetit personal të prindërve ndaj fëmijës, djalit të madh të tyre, në vijim të iniciativës së ndërmarrë nga babai, prej vitit 1994. Kontributi i bashkëshortit në këtë objekt ka qenë ndihmesa me punë fizike, pasi burimet monetare kanë qenë të kufizuara. Nga sa më sipër, subjekti ka kërkuar që të përfshijë totalin e investimit për periudhën 2004 – 2006, në vlerën 3.399.541 lekë, përlllogaritur më lart në analizën financiare të prindërve të bashkëshortit dhe të mos konsiderohet si e shpenzuar prej saj dhe bashkëshortit.*
125. Në funksion të sa më sipër, ajo ka paraqitur në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. “\*\*\*”, datë 3.6.2023, të lëshuar nga prindërit e bashkëshortit, të cilët kanë deklaruar se për investimin e kryer në periudhën 2004 – 2006 kanë përdorur shumat e marra hua nga z. I. Ç., dhe kursimet e tyre, duke qenë se babai i bashkëshortit ka pasur për qëllim ndarjen e pasurisë mes djemve të tij, ka investuar vetë në përfundimin e objektit, pa kontribut material nga djali i madh.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

126. Trupi gjykues, nisur nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat janë të ndërthurura në vijimësinë dhe dinamikën e tyre, por edhe nga dokumentacioni i depozituar vlerëson se lidhur me koston e ndërtimit, në kushtet që nuk ka ndonjë dokumentacion të kohës që të mund të provojë nivelin e tyre të ndryshëm nga sa është përlllogaritur nga Komisioni, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vërehet se vlerat e referuara nga EKB-ja vlerësohen si një nivel referues dhe i aplikueshëm, duke zbritur vetëm kostot e fitimit të planifikuar dhe fondin rezervë, ndërsa vlera e TVSH-së – sipas praktikës së deritanishme dhe jurisprudencës specifike – nuk mund të zbritet nga kostot e ndërtimit.

127. Lidhur me përmbajtjen e deklaratës noteriale të sjellë me prapësimet, Komisioni çmon se deklarimi i prindërve të bashkëshortit është kontradiktor, krahasuar me deklarimin e tyre në deklaratën noteriale të vitit 2020 e, për rrjedhojë, nuk sjell asnjë pasojë, duke mbetur ky deklarim në një nivel deklarativ.
128. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar përgjatë hetimit administrativ dhe të prapësimeve të paraqitura nga subjekti, pas njoftimit të rezultateve, si dhe pas vlerësimit të shpjegimeve e pretendimeve të tij, në përfundim të sa më sipër, por edhe në harmonizim me sa është përshkruar dhe vlerësuar edhe me lart, çmon se për sa i përket shpenzimit lidhur me kostot e ndërtimit në periudhën 2004 – 2006, subjekti mbetet në një balancë negative prej -1.359.401 lekësh.
129. Komisioni, në konkluzion lidhur me këtë pasuri, vlerëson se rezultati i njoftuar subjektit të rivlerësimit nuk ndryshon dhe se rezultati financiar negativ – duke mbajtur në vëmendje parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit – çmohet i pamjaftueshëm që të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, me aplikimin e pikës 3 të nenit 63 të ligjit nr. 84/2016.

### 3. Automjet tip “Ford Fiesta”

130. Ky automjet është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2015, blerë nga shoqëria shitëse “\*\*\*\*” sh.p.k., kundrejt shumës 4.000 euro, me burim nga të ardhurat e dyqanit pjesë këmbimi dhe tërheqja e një shume nga depozita në “Raiffeisen Bank”. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat nga dyqani pjesë këmbimi dhe kursimet nga paga e saj dhe e bashkëshortit.
131. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 18.11.2022, ka bërë me dije se në emër të bashkëshortit të subjektit figuron, ndër të tjera, i regjistruar automjeti tip “Ford Fiesta”, me targë “\*\*\*\*”<sup>61</sup>, blerë me anë të kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 9.1.2015, konfirmuar kjo edhe nga regjistri noterial<sup>62</sup>, kundrejt çmimit 4.000 euro, ku çmimi është paguar në llogarinë bankare të shitësit<sup>63</sup>.
132. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka shpjeguar se pagesa për likuidimin e çmimit është kryer *cash* nga bashkëshorti duke paraqitur një deklaratë noteriale<sup>64</sup> të përfaqësuesit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., i cili ka deklaruar se pagesa edhe pse ishte parashikuar ndryshe në kontratë, është kryer *cash* në datën 14.1.2015, duke vendosur në dispozicion mandatarkëtimin e datës 14.1.2015, duke shpjeguar se me shumën e arkëtuar nga z. Zavalani është kryer kjo pagesë që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka pasur ndaj shoqërisë “Landeslease” sh.a.
133. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit ka rezultuar se shuma prej 3.500 euro nga depozita e tij në “Raiffeisen Bank” është tërhequr prej tij në datën 26.1.2015, pra, pas datës së nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së automjetit, si dhe pas datës së pretenduar të pagesës e, për rrjedhojë, ajo nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë në analizë.

<sup>61</sup> Fillimisht automjeti ka pasur targën “\*\*\*\*”.

<sup>62</sup> RNSH-ja me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.11.2022.

<sup>63</sup> Referuar dokumentacionit në dosjen e mjetit, ka rezultuar se vetë pala shitëse “\*\*\*\*” sh.p.k. e ka blerë këtë automjet në datën 31.12.2014 në shumën 2.666 euro.

<sup>64</sup> Deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.11.2022.

134. Po ashtu, të ardhurat nga dhënia me qira e njësisë për vitin 2015 janë deklaruar të kenë qenë në masën 200.000 lekë, të cilat edhe po të ishin arkëtuar deri në datën e kryerjes së pagesës, sërish pjesa takuese e një muaji do të ishte veç 16.666 lekë, të cilat nuk do të ishin të mjaftueshme as për të mbuluar shpenzimet e jetesës së familjes së subjektit për të njëjtën periudhë, duke rezultuar kështu një mungesë e burimeve të ligjshme financiare për të gjithë vlerën e blerjes së automjetit prej -550.600 lekësh<sup>65</sup>.
135. Për sa i përket kursimeve në formën *cash*, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit ndër vite, duket se në fund të vitit 2014 ato kanë qenë në masën 4.329.335 lekë, si dhe në DIPP-në e vitit 2015 ajo nuk ka deklaruar ndryshim të tyre. Nga analiza financiare e vitit 2015<sup>66</sup> duket se subjekti i rivlerësimit, në rast të përdorimit të këtyre kursimeve për blerjen e mjetit, ka pasur mundësi për t'i zëvendësuar ato deri në fund të vitit, me burime të ligjshme financiare.
136. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se për blerjen e automjetit subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare nga kursimet e disponuara në banesë.
137. Lidhur me verifikimin e konfliktit të interesit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>67</sup> ka informuar se për shtetasin A.B., pas verifikimit në indeksin e kallëzimeve të procedimeve penale 2002 – 2022, rezulton të jenë regjistruar katër procedime penale. Lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka paraqitur shkresat nga prokuroritë Lezhë, Durrës dhe Tiranë, të cilat kanë konfirmuar se ndaj këtij shtetasi nuk janë regjistruar procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.

#### 4. Automjet tip “Daimler Chrysler”

138. Ky automjet është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2016, si dhe në deklaratën *Vetting*, blerë nga bashkëshorti i saj me anë të kontratës së shitjes<sup>68</sup> nga pala shitëse Y.Gj.<sup>69</sup>, kundrejt çmimit 2.000 euro, me burim nga kursimet e saj dhe të bashkëshortit nga pagat respektive. DPSHTRR-ja<sup>70</sup> ka konfirmuar automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targë “\*\*\*\*”.
139. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit dhe të bashkëshortit të saj ka rezultuar se deri në datën e nënshkrimit të pagesës së çmimit të blerjes së automjetit, prej tyre është tërhequr vetëm shuma 10.000 lekë, e cila nuk është e mjaftueshme as për të mbuluar shpenzimet e jetesës së familjes së subjektit për të njëjtën periudhë, duke rezultuar kështu një mungesë e burimeve të ligjshme financiare për të gjithë vlerën e blerjes së automjetit prej -270.540 lekësh<sup>71</sup> (varianti I).
140. Për sa i përket kursimeve në formën *cash*, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit ndër vite, duket se në fund të vitit 2015 ato kanë qenë në masën 4.329.335 lekë, të cilat duken të mjaftueshme për të kryer pagesën prej 2.000 euro për blerjen e automjetit në analizë.

<sup>65</sup> Ekuivalenti i çmimit të blerjes prej 4.000 euro.

<sup>66</sup> Referojuni analizës financiare për periudhën 2003 – 2016, bashkëngjitur këtij relacioni.

<sup>67</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 1.12.2022.

<sup>68</sup> Kontrata nr. “\*\*\*\*”, datë 25.1.2016.

<sup>69</sup> Nga pala shitëse Y.Gj., automjeti ishte blerë në datën 27.10.2014, kundrejt çmimit 800 euro.

<sup>70</sup> Shkresë nr. “\*\*\*\*” prot., datë 18.11.2022.

<sup>71</sup> Ekuivalenti i çmimit të blerjes prej 2.000 euro.



Gjithashtu, nga analiza financiare e vitit 2016, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për t'i zëvendësuar ato, deri në fund të vitit, me burime të ligjshme financiare.

**5. Llogari rrjedhëse në ABI Bank në emër të bashkëshortit, në shumën 9.000 euro**

**6. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortit, në shumën 8.250 euro**

**7. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortit, në shumën 5.027 USD**

141. Këto llogari në emër të bashkëshortit të subjektit janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2016, në shumën 9.000 euro, në ABI Bank, si dhe 8.250 euro dhe 5.027 USD pranë “Raiffeisen Bank”, të çelura gjatë vitit 2016, me burim nga gjendja *cash* e deklaruar në vitet e mëparshme dhe e krijuar nga të ardhurat nga pagat ndër vite. Subjekti ka shtuar se depozitimi është kryer në bazë të detyrimeve të ligjit nr. 84/2016, për kursimet e disponuara në banesë.
142. Në deklaratën *Vetting*, këto depozita janë deklaruar nga subjekti me burim nga kursimet nga të ardhurat e pagës së saj dhe të bashkëshortit, si dhe të ardhurat nga dyqani pjesë këmbimi. Konkretisht, ABI Bank<sup>72</sup> ka bërë me dije se shtetasi E.Z., ka llogari rrjedhëse në monedhën euro, në të cilën ka depozituar 5.000 euro në datën 14.12.2016 dhe 4.000 euro në datën 30.12.2016.
143. “Raiffeisen Bank”<sup>73</sup> ka bërë me dije, ndër të tjera, se bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën 8.000 euro në datën 14.10.2016 dhe 5.000 USD në datën 30.12.2016.
144. Lidhur me kursimet e disponuara në formën *cash* në banesë, subjekti i rivlerësimit, në deklaratat e saj periodike ndër vite, ka deklaruar sipas detajimeve në tabelë, nga ku duket se shumat dhe veprimet e deklaruara prej saj ndër vite përputhen me shumën e deklaruar në deklaratën *Vetting*. Nga këto deklarime duket se në fund të vitit 2015 subjekti i rivlerësimit ka pasur kursime në formën *cash* në shumën totale 4.329.335 lekë, të cilat duken të mjaftueshme për të kryer depozitimet e shumave në analizë, prej përkatësisht 9.000 euro, 8.000 euro dhe 5.000 USD (të konvertuara në 2.941.040 lekë).
145. Ndërkohë, nga analiza financiare duket se për t'i krijuar këto kursime ndër vite subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, që do të trajtohet në vijim.
146. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarinimin e pasurive në fjalë, si dhe me burimet e ligjshme financiare për krijimin e tyre.

**8. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” në emër të bashkëshortit, në shumën 2.091 euro**

147. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë bankare në fjalë, si dhe deklarimeve ndër vite të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se kjo depozitë ka filluar në vitin 2008, me depozitimin në datën 4.1.2008 të shumës 7.000 euro<sup>74</sup> nga bashkëshorti i subjektit, ku si burim krijimi ka

<sup>72</sup> Shkresë nr. “\*\*\*” prot., datë 31.5.2021.

<sup>73</sup> Shkresë nr. “\*\*\*” prot., datë 16.6.2021.

<sup>74</sup> Në vitin 2009, bashkëshorti i subjektit e ka tërhequr këtë shumë në muajin shkurt, për ta depozituar më tej në datën 24.12.2009, në monedhën lekë, 980.000, e për t'u tërhequr sërish në shkurt 2010. Nga kjo shumë është depozituar më pas, në datën 9.11.2010, 5.000 euro, e cila së bashku me dy depozitime prej 1.000 euro në datën 10.2.2011 dhe 1.500 euro në datën 12.8.2011, si dhe të ardhurat nga interesat, ka arritur vlerën 7.691 euro në datën 15.2.2012. Në vijim, shuma 7.691 euro është bashkuar me dy shuma të tjera prej 8.500 euro dhe 4.000 euro, e janë tërhequr prej bashkëshortit të subjektit gjatë viteve 2012

deklaruar të ardhurat nga dyqani dhe kursimet e pagave. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar gjithashtu të njëjtin burim për pjesën e mbetur prej 2.091 euro të kësaj depozite.

148. Në vijim të analizës së mësipërme mbi gjendjet e disponuara në banesë nga subjekti i rivlerësimit, duket se në fund të vitit 2007 ata dispononin shumën prej 1.291.365 lekësh, shumë kjo që duket e mjaftueshme për të mbuluar depozitën prej 7.000 euro të datës 4.1.2008. Gjithashtu, nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit mund të rikrijonte këto kursime deri në fund të vitit 2008, me burime të ligjshme financiare, për sa kohë në DIPP-në e vitit 2008 nuk janë deklaruar ndryshime të kursimeve në formën *cash*.
149. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarimin e pasurisë në fjalë, si dhe burimet e ligjshme financiare për krijimin e saj.

#### **9. Depozitë me afat në “Raiffeisen Bank” në emër të subjektit, në shumën 1.087.588 lekë**

150. Kjo depozitë është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit fillimisht në DIPP-në e vitit 2011, në shumën 450.000 lekë, me burim nga kursimet e pagës që kanë qenë në llogarinë e pagës. Në vijim, kjo depozitë është shtuar ndër vite me kursimet nga të ardhurat nga pagat e kredituara, si dhe interesat, duke arritur vlerën 1.087.612 lekë në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*.
151. Nga shqyrtimi i lëvizjeve në këtë llogari bankare është konfirmuar se përputhet<sup>75</sup> gjendja e deklaruar me atë të rezultuar në dokumentacionin e administruar, si dhe është konfirmuar krijimi i kësaj gjendjeje me të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit.
152. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarimin e pasurisë në fjalë, si dhe burimet e ligjshme financiare për krijimin e saj.

#### **10. Llogari rrjedhëse e pagës në “Credins Bank”, në shumën 177.643 lekë dhe llogari rrjedhëse e kartës në “Credins Bank”, në shumën 12.253 lekë**

153. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar llogarinë e pagës së saj në “Credins Bank”, të krijuar nga kreditimet e të ardhurave nga pagat e saj, si dhe llogarinë e kartës *Visa Classic*, të krijuar në datën 29.1.2015, me transfertat nga llogaria e pagës. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të kësaj llogarie është konfirmuar se përputhen gjendjet e deklaruara me ato të rezultuara në dokumentacionin e administruar, si dhe është konfirmuar krijimi i këtyre gjendjeve me të ardhurat nga pagat e saj, të kredituara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
154. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarimin e pasurive në fjalë, si dhe burimet e ligjshme financiare për krijimin e tyre.

#### **11. Llogari rrjedhëse e pagës së bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”, në shumën 308.858 lekë**

155. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar llogarinë e pagës së bashkëshortit të saj në “Raiffeisen Bank”, të krijuar nga kreditimet e të ardhurave nga pagat e tij si oficer i policisë gjyqësore. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të kësaj llogarie është konfirmuar se përputhet gjendja

---

dhe 2013, duke mbetur veç gjendja prej 590 euro. Në datën 30.12.2013, bashkëshorti i subjektit ka depozituar sërish 5.000 euro dhe pas tërheqjes së shumës prej 3.500 euro në datën 26.1.2015, në këtë llogari ka mbetur shuma e deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*, prej 2.091 euro.

<sup>75</sup> Ka një diferencë prej 24 lekësh në deklarimin e subjektit, e cila vjen nga të ardhurat nga interesat e 3-mujorit të fundit.

e deklaruar me atë të rezultuar në dokumentacionin e administruar, si dhe është konfirmuar krijimi i kësaj gjendjeje me të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit.

156. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarin e pasurisë në fjalë, si dhe burimet e ligjshme financiare për krijimin e saj.

### 12. Llogari në “Raiffeisen Bank” në emër të vajzës, në shumën 6.800 lekë

157. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar llogarinë e vajzës A.Z., në “Raiffeisen Bank”. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të kësaj llogarie ka rezultuar se kjo llogari është çelur në vitin 2009, me depozitim e shumës 5.000 lekë dhe është shtuar me të ardhurat nga interesat ndër vite. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarin e pasurisë në fjalë, si dhe burimet e ligjshme financiare për krijimin e saj.

### 13. Gjendje *cash* në masën 10.000 USD dhe 100.000 lekë

158. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si gjendje të disponuar *cash* në banesë shumat 10.000 USD dhe 100.000 lekë, me burim kursimet e të ardhurave nga paga e saj, paga e bashkëshortit, të ardhurat e dyqanit pjesë këmbimi, si dhe dhuratat, sjellë nga të afërmit për lindjen e vajzës.

159. Sa i përket të ardhurave nga dhuratat, sjellë nga të afërmit për lindjen e vajzës, ato janë deklaruar prej subjektit në DIPP-në e vitit 2013, në shumën totale 330.000 lekë. E pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se me rastin e lindjes së vajzës së saj W., në vitin 2013, miq dhe familjarë i kanë dhuruar sipas traditës shumën e deklaruar. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit, subjekti ka paraqitur deklaratat noteriale<sup>76</sup> të lëshuara nga dhuruesit, si dhe dokumentacionin përkatës të të ardhurave të secilit prej tyre, për të provuar burimin e ligjshëm.

160. Lidhur me deklarin e subjektit mbi gjendjen e disponuar *cash*, si dhe ndryshimet e tyre ndër vite, sipas detajimit në tabelën e mëposhtme, duket se përpunet gjendja e deklaruar në deklaratën *Vetting* me veprimet e deklaruara prej subjektit me to, ndër vite.

**Tabela nr. 8 – Deklarimet e gjendjeve të disponuara *cash* në banesë**

Viti	Forma e deklaramit	Shuma e vitit ekuivalenti ALL	Shuma kumulative ne leke	Burimi deklaruar
2007	Gjendje cash 9.000 USD dhe 4.500 euro	1,291,365	1,291,365	Kursime nga paga ime, b/shortit dhe dyqani
2008	-	-	1,291,365	
2009	Gjendje cash 400.000 leke	400,000	1,691,365	Kursimet nga paga ime dhe e bashkeshortit
2010	Shtim pasurie gjendje cash nga 400.000 leke ne 650.000 leke	250,000	1,941,365	Kursime nga paga ime, b/shortit dhe dyqani
2011	Pakesim pasurie gjendje cash prej 650.000 leke	(650,000)	1,291,365	Krijuar depozite bankare prej 8.500 euro
2012	Shtim pasurie gjendje cash valute USD 21.000	2,237,970	3,529,335	Nga terheqja e depozitave ne euro dhe kembimi ne USD, pagat dhe dyqani
2013	Gjendje cash 400.000 leke	400,000	3,929,335	Nga te ardhurat nga pagat, nga dyqani dhe dhuratat per lindjen e vajzes
2014	Gjendje cash 400.000 leke	400,000	4,329,335	Kursime nga paga ime dhe e bashkeshortit
2015	-	-	4,329,335	
2016	Pakesim gjendjes cash nga 21.000 USD dhe 800.000 leke ne 10.000 USD dhe 100.000 leke	(2,941,040)	1,388,295	Krijuar depozitat deklaruar ne pikat 3, 6 dhe 7 (9.000 euro; 8.000 euro dhe 5.000 USD)
<b>Vetting</b>	<b>Gjendje cash 10.000 USD dhe 100.000 leke</b>		<b>1,382,900</b>	<b>Nga kursimet e pages time, te b/shortit dhe dyqanit pjese kembimi</b>

<sup>76</sup> Deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.11.2022; deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 23.11.2022; deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 23.11.2022; deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.11.2022; deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.11.2022; deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 22.11.2022; deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 12.12.2022; deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 12.12.2022; deklaratë noteriale nr. “\*\*\*\*”, datë 12.12.2022.

161. Ndërkohë, nga analiza financiare ka rezultuar se për krijimin e kursimeve në formën *cash* apo për shtesat e tyre ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën -1.088.057 lekë [përkatësisht -523.291 lekë më 31.10.2007 (përpara detyrës); -228.035 lekë në vitin 2012 dhe -336.731 lekë në vitin 2014)].
162. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se për krijimin e kursimeve të disponuara *cash* në banesë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -1.088.057 lekë.
163. Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse lidhur me të gjitha problematikat e konstatuara, si dhe për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit për këtë pasuri.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

164. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e saj të cilat janë të detajuara edhe më sipër, ka pretenduar se analiza financiare ndryshohet, duke shpjeguar se, për sa kohë: (i) përfshihen të ardhurat nga qiraja për të gjithë shumën 2.660.000 lekë, përfituar nga qiradhënia për periudhën janar 2007 – 2015, pasi janë provuar se këto të ardhura i përkasin vetëm bashkëshortit për dhënien me qira të pjesës së tij; (ii) të ndryshohen shpenzimet e udhëtimit bazuar në arsyet dhe shpjegimet e trajtuara më sipër; (iii) për vitet 2012 dhe 2014, të cilat kanë rezultuar nga analiza financiare e kryer me diferencë negative, shpenzimet e udhëtimit duhet të përlllogariten përkatësisht në vlerat 39.894 dhe 188.502 lekë.
165. Nga analiza financiare e rikryer, sipas ndryshimeve më sipër, ka rezultuar se për krijimin e kursimeve në formën *cash* apo për shtesat e tyre ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën -260.387 lekë [përkatësisht -66.493 lekë më 31.10.2007 (përpara detyrës); -139.824 lekë në vitin 2012 dhe -54.071 lekë në vitin 2014].

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

166. Pas analizimit të shpjegimeve dhe dokumentacionit të depozituar, parë ky në harmoni me çka reflektohet më tej në situatën financiare, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, pas korrigjimit të rezultatit, për krijimin e gjendjes *cash* do të rezultonte në një balancë negative prej -495.450 lekësh.

#### **14. Shpenzime shkollimi**

167. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzime për shkollimin e fëmijëve të saj ndër vite dhe as në deklaratën *Vetting*. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka bërë me dije se vajza e saj A.Z., ka ndjekur shkollën 9-vjeçare “\*\*\*\*”, në Tiranë dhe ka paguar 600 euro për vit akademik, duke filluar nga viti 2008. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti ka paraqitur një vërtetim nga institucioni arsimor “\*\*\*\*”, të datës 2.3.2023, i cili ka konfirmuar pagesën për vit akademik prej 600 euro, duke bërë me dije edhe periudhën e kryerjes së pagesës.

#### **15. Udhëtime jashtë Shqipërisë**

168. Në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve të subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes së saj, Komisioni i ka përlllogaritur bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS, sipas metodikës në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit dhe deklarimeve të vetë subjektit në përgjigje të pyetësorëve.
169. Nga pretendimet e përmendura në dokumentacionin e mësipërm, Komisioni nuk ka konsideruar mbulimin e shpenzimeve të biletave të avionit nga të afërmit e bashkëshortit të subjektit për në SHBA, për sa kohë ato nuk janë deklaruar nga subjekti në DIPP-të e viteve përkatëse, në rubrikat e dhuratave dhe trajtimeve preferenciale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

170. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar duke pretenduar se, për sa i takon udhëtimit të datës 2.3.2012, sikurse ka deklaruar në përgjigje të pyetjes nr. 12 të pyetësorit standard, datë 2.3.2012 – 2.3.2012. *Hyrje për pak orë në PKK Murriqan për marrjen e automjetit me targë “\*\*\*”, sipas prokurës së posaçme nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 7.10.2010, lëshuar nga shtetasi E.M.Sh., banues në Durrës, bashkëshorti ka shkuar në pikën kufitare Murriqan për të tërhequr automjetin e sipërcituar me prokurë. Për këtë arsye, kërkoj nga Komisioni, të mos përfshijë koston 95 euro për këtë udhëtim.*
171. *Duke qenë se edhe në rastin e udhëtimit të vajzës e A., me bashkëshortin në SHBA, në datën 21.6.2016, është konsideruar nga ana juaj në analizë në vlerën 869 euro, pa marrë parasysh shpjegimet e dhëna nga ana ime në pyetësin standard (përgjigje e pyetjes nr. 4 dhe nr. 12) dhe provat e depozituara për këtë qëllim. Kërkoj korrigjimin e shpenzimeve të udhëtimit, sipas përgjigjeve të mia në pyetësin standard dhe pyetësin nr. 4.*
172. Nga sa më sipër, ajo ka pretenduar korrigjimin e shpenzimeve të udhëtimit sipas shpjegimeve që ka dhënë në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, së bashku me dokumentacionin e depozituar për këtë qëllim, duke referuar edhe raste të ngjashme sipas vendimmarrjes së Kolegjit<sup>77</sup>.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

173. Nisur nga sa është shpjeguar dhe argumentuar nga subjekti i rivlerësimit, përpos çështjeve të trajtuara më sipër në pasuritë përkatëse, lidhur me shpenzimet e udhëtimit, në analizë janë korrigjuar sipas pretendimeve të subjektit kostot e biletave për vajzën (0-2 vjeç) me 60 USD, në vend të 600 USD që ishte përlllogaritur më herët, për sa kohë shpjegimet e subjektit janë vlerësuar bindëse. Gjithashtu, është ndryshuar shpenzimi për dy udhëtimet në SHBA të bashkëshortit të subjektit në vitet 2006 dhe 2007, periudha në të cilat ajo nuk ka qenë subjekt deklarimi për të deklaruar mbulimin e këtyre shpenzimeve, duke vlerësuar se edhe në këtë rast pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse.

## **16. Konstatime të tjera**

174. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se përveç automjeteve të trajtuara më herët, bashkëshorti i subjektit ka blerë dhe shitur disa automjete të tjera ndër vite.
175. Konkretisht, në vitin 2003, bashkëshorti i subjektit ka blerë një automjet tip “Mercedes-Benz”, me anë të kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 13.3.2003, kundrejt çmimit 200.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2003, ky automjet është deklaruar nga subjekti me vlerë 650.000 lekë. Më

<sup>77</sup> Vendimi nr. 2/2023 i Kolegjit, pikat 19.6 dhe 19.7.

tej, bashkëshorti i subjektit e ka shitur këtë automjet me anë të kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 14.3.2008, kundrejt çmimit 200.000 lekë. Në vitin 2007, bashkëshorti i subjektit ka blerë një automjet tip “Mercedes-Benz C210”, me anë të kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 26.4.2007, kundrejt çmimit 200.000 lekë. Në DIPP-në përpara fillimit të detyrës, ky automjet është deklaruar nga subjekti me vlerë 1.200.000 lekë. Më tej, bashkëshorti i subjektit e ka shitur këtë automjet me anë të kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 8.2.2016, kundrejt çmimit 3.500 euro.

176. Në vitin 2012, bashkëshorti i subjektit ka blerë një automjet tip “Volkswagen Golf”, me anë të kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 5.3.2012, kundrejt çmimit 50.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2012, ky automjet është deklaruar nga subjekti me vlerë 50.000 lekë dhe me burim kursimet nga pagat. Më tej, bashkëshorti i subjektit e ka shitur këtë automjet me anë të kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 24.7.2015, kundrejt çmimit 2.500 euro.
177. Në vitin 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e një automjeti tip “Fiat Punto”, në shumën 2.500 euro, të shitur me anë të kontratës nr. “\*\*\*\*”, datë 22.11.2013. Ky automjet ka rezultuar të jetë blerë kundrejt çmimit 500 euro, me anë të deklaratës për shitje, në gjuhën italiane, të datës 24.12.2012, si dhe është zhdoganuar më 24.1.2013, kundrejt tarifës së zhdoganimit prej 24.188 lekësh. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti nuk e ka deklaruar blerjen e këtij mjeti. E pyetur nga Komisioni, ajo ka bërë me dije se nuk e kanë deklaruar automjetin në fjalë, duke qenë se automjeti deri në fund të vitit 2012 ende nuk kishte mbërritur në Shqipëri, siç konfirmohet edhe nga zhdoganimi që është kryer në vitin 2013.
178. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegonte arsyet e shitjes së disa prej automjeteve të mësipërme, me çmim më të lartë se të blerjes, si dhe të paraqiste dokumentacionin që provon pagimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e realizuara nga këto shitje. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se vlera e shtuar e mjeteve ka ardhur si pasojë e kryerjes së shërbimeve dhe riparimeve. Ndërsa, lidhur me detyrimet tatimore, ajo është shprehur se nuk ka paguar tatim mbi të ardhurat, pasi vetë organet tatimore nuk e kanë mbledhur atë.
179. E pyetur gjithashtu mbi mospërputhjet e rezultuara mes deklarimeve të saj në DIPP-në e vitit 2003 dhe atë përpara detyrës në vitin 2007 dhe çmimeve të rezultuara në përmbajtje të kontratave të shitblerjeve të mjeteve, subjekti është shprehur se kanë qenë lapsuse nga ana e saj në deklarim dhe se çmimi i paguar ka qenë sipas parashikimeve në kontratat përkatëse.
180. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se:
- *Duket se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit në DIPP-në e vitit 2003 dhe atë përpara detyrës në vitin 2007, mbi çmimet e blerjeve të automjeteve, krahasuar me çka ka rezultuar në përmbajtje të kontratave të shitblerjes së tyre.*
  - *Duket se në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Fiat Punto” nga ana e bashkëshortit të saj.*
  - *Duket se nuk ka logjikë ekonomike në shitjen e tre automjeteve nga ana e bashkëshortit të subjektit me çmim më të lartë se ai i blerjes së tyre, pas vitesh përdorimi dhe amortizimi.*
  - *Duket se të ardhurat e realizuara nga shitja e tre automjeteve në vitet 2013, 2015 dhe 2016, sa i përket diferencës midis çmimit të shitjes dhe asaj të blerjes, nuk mund të*

*konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm financiar, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë për to nuk janë paguar detyrimet tatimore.*

181. Nga sa është përshkruar më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse lidhur me të gjitha problematikat e konstatuara, si dhe për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e rezultateve për këtë pasuri.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

182. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e dërguara ka shpjeguar dhe ka mbajtur qëndrimin se: *“Lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 2003, ka shpjeguar se bashkëshorti me kontratën e shitblerjes nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 13.3.2003, ka blerë nga shtetasi B.G., automjetin tip “Mercedes-Benz”, me tragë “\*\*\*\*”, kundrejt çmimit 200.000 lekë. Sqaroj se në DPV-në e vitit 2003 ka qenë lapsus deklarimi i vlerës së blerjes së këtij automjeti në shumën 650.000 lekë, pasi ky automjet është blerë nga shtetasi B.G., në datën 8.7.2002, sipas kontratës së shitblerjes nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., në vlerën 200.000 lekë. Automjeti është shitur më pas nga bashkëshorti, në datën 14.3.2008, sipas kontratës së shitblerje nr. “\*\*\*\*” rep., “\*\*\*\*” kol., kundrejt çmimit 200.000 lekë, me palë blerëse shtetasin F.P., (kunati i bashkëshortit). Siç konstatohet, çmimi i blerjes së automjetit nga bashkëshorti është 200.000 lekë dhe vetë shitësi e ka blerë po në vlerën 200.000 lekë, duke provuar tej çdo dyshimi që realisht çmimi i blerjes ka qenë 200.000 lekë. Kontratat e shitblerjes janë në të dyja rastet noteriale me fuqi të plotë provuese. Mbështetur në këto argumente, deklarimi i vlerës së blerjes prej 650.000 lekësh në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim, viti 2003, është thjesht lapsus.*
183. *Lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz C210”, blerë në vitin 2007, bashkëshorti ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz 210” (290 E), vit prodhimi 1997, me targë “\*\*\*\*” (“\*\*\*\*”, targë e ndryshuar nga bashkëshorti pas kalimit të pronësisë), kundrejt çmimit 200.000 lekë, vërtetuar me kontratë shitblerjeje nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 26.4.2007. Deklarimi i vlerës së blerjes së këtij automjeti, prej 1.200.000 lekësh, në deklaratën para fillimit të detyrës 2007, ka qenë pasaktësi, pasi në kontratën e shitblerjes përcaktohet se vlera e blerjes ka qenë 200.000 lekë. Vetë shitësi i automjetit, shtetasi A. M., e ka blerë këtë automjet në vlerën 500.000 lekë, sipas përcaktimeve në kontratën e shitjes nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 15.11.2002. Nga verifikimi i transaksioneve të mëparshme për shitblerjen e këtij automjeti, del qartë se vlera e tij është disa herë më e ulët në krahasim me vlerën e deklaruar nga ana ime në deklaratën para fillimit të detyrës. Referuar vitit të prodhimit, kohës së blerjes nga bashkëshorti, vlerës së tij në transaksionet e mëparshme, por edhe çmimit të përcaktuar në kontratë, vërtetohet se ky automjet në asnjë rast nuk mund të jetë blerë në vlerën 1.200.000 lekë. Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. “\*\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*\*” kol., datë 8.2.2016, bashkëshorti E.Z., e ka shitur këtë automjet tek shtetasi R.L., kundrejt çmimit 3.500 euro. Vlera e shtuar e këtij automjeti ka ardhur për arsye të servisit dhe riparimit të investuar nga bashkëshorti. Automjeti ka pasur përmirësime në rritjen e fuqisë motorike, ndryshimin e disqeve dhe gomave, sistemin elektrik dhe tapicerinë. Një pjesë e mirë e shërbimeve janë kryer në servis në pronësi të vëllait të bashkëshortit. Ky automjet ka qëndruar për një kohë të gjatë në banesën në “\*\*\*\*” dhe ka qenë propozimi dhe këmbëngulja e blerësit R. L., banues në “\*\*\*\*”, për ta blerë kundrejt çmimit 3.500 euro.*

Sqaroj Komisionin se nuk kemi paguar tatim mbi të ardhurën nga shitja e këtij automjeti, pasi ky tatim nuk është mbajtur në burim, sikundër veprohet në rastin e shitjes së pasurisë së paluajtshme. Theksoj se për këtë çështje DPT-ja, me shkresën e datës 7.3.2022<sup>78</sup>, ka arsyetuar se: “Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së luajtshme (në rastin tuaj autoveturë dhe/ose mjet motorik) nuk janë të ardhura të listuara në nenin 8 “Të ardhura të tatueshme”, si dhe pikën 2.3 të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006 (i ndryshuar) në zbatim të dispozitave ligjore”.

184. Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen Golf”, blerë në vitin 2012, është blerë në datën 5.3.2012, sipas kontratës së shitblerjes automjeti nr. “\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*” kol., kundrejt çmimit 50.000 lekë. Bashkëshorti ka pasur prokurë të posaçme nr. “\*\*\*” rep., nr. “\*\*\*” kol., datë 7.1.2010, autorizuar nga shtetasi E.Sh., nëpërmjet së cilës i janë dhënë të gjitha tagrat ligjore për transaksionet e shitjes, blerjes dhe përdorimit, ku në cilësinë e blerësit mund të ishte edhe vetë bashkëshorti ose persona të tretë dhe me një çmim që e gjykonte të arsyeshëm. Për fitimin nga shitja e automjetit (diferenca midis shitjes në shumën 2.500 euro dhe blerjes në shumën 50.000 lekë) nuk është paguar tatim në burim, me arsyetimin më lart.
185. Lidhur me pasurinë automjet tip “Fiat Punto”, blerë në vitin 2013, tip 188, dhe vit prodhimi 2000 është përfituar nga bashkëshorti sipas deklaratës së shitjes së mjetit, përpiluar nga shitësi E.K., në Itali, në datën 24.12.2012, në shumën 500 euro. Deri në fund të muajit dhjetor 2012, automjeti nuk kishte ardhur ende në Shqipëri dhe nuk ishte marrë në dorëzim nga bashkëshorti. Sipas deklaratë doganore “\*\*\*”, ky automjet është zhdoganuar në datën 24.1.2013 dhe në atë moment ka hyrë në qarkullim civil në Shqipëri. Për këtë arsye, ky automjet nuk është deklaruar nga ana ime në DPV-në e vitit të mëparshëm 2012, kur thjesht palët janë dakordësuar për blerjen, por në DPV-në e vitit 2013, kur ky automjet është përfituar realisht. Pikërisht për këtë shkak, unë gjykoj se kam deklaruar saktësisht si zhdoganimin, ashtu edhe shitjen e këtij automjeti në DPV-në e vitit 2013. Diferenca ndërmjet kohës së deklarimit nga shtetasi E.K., në Itali dhe zhdoganimit të këtij automjeti në vendin tonë është 1 muaj, pavarësisht se përfitimi në kohë zgjatet nga fundi i vitit 2012 deri në janar 2013. Bashkëshorti, përveç pagesës së çmimit të blerjes, ka paguar transportin e automjetit nga Italia në Shqipëri në shumën 20.938 lekë (referuar rubrikës 12 të deklaratës doganore), pagesën e zhdoganimit në shumën 24.188 lekë, si dhe të gjitha pagesat për regjistrimin e mjetit. Por, edhe nëse konsiderohet pasaktësi në deklarimin e vitit 2012, kjo është e karakterit formal e pa pasoja dhe është korrigjuar në deklarimin e bërë në deklaratën e interesave privatë 2013. Për të ardhurat nga shitblerja e automjetit në shumën 1.500 euro, nuk kam paguar tatim në burim, pasi vetë organet tatimore nuk e kanë mbledhur këtë tatim, duke mos qenë i cituar specifikisht në nenin 8 “Të ardhura të tatueshme”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, shpjeguar më sipër”.

<sup>78</sup> Poshtëshënimin nr. “\*\*\*” të vendimit nr. “\*\*\*”, datë 6.7.2022, për subjektin e rivlerësimit L. F.: “46. Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2022, nga ku rezulton se pas një interpretimi të nenit 8 “Të ardhura të tatueshme”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ky institucion në përfundim deklaroi se: “Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë së luajtshme (në rastin tuaj autoveturë dhe/ose mjet motorik) nuk janë të ardhura të listuara në nenin 8 “Të ardhura të tatueshme”, si dhe pikën 2.3 të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006 (i ndryshuar), në zbatim të dispozitave ligjore”.



## Vlerësimi i trupit gjykues

186. Nisur nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, për sa është përshkruar për secilin automjet, në mënyrë të përmblodhur trupi gjykues vlerëson se: (i) lidhur me deklarin e blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” në një shumë më të madhe se ajo e pasqyruar në kontratën e blerjes, trupi gjykues i vlerëson shpjegimet e subjektit shteruese, për sa kohë rezultoi e pasqyruar vlera e mjetit në dokumentin e kohës; (ii) lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz C210”, blerë në vitin 2007, për at kohë sa nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk u depozituan dokumentacione për sa u pretendua mbi shërbimet e kryera, si dhe faktit se nuk është paguar tatimi mbi të ardhurat, konkluzionet e arritura dhe të njoftuara në rezultate nuk ndryshojnë; (iii) lidhur me automjetin tip “Volkswagen Golf”, i cili është blerë nga vetë bashkëshorti i subjektit, vlerësohet si përfitues i vetëm i kësaj pasurie e, për rrjedhojë, shpenzimet për transportin konsiderohen si të paguara prej tij, edhe për këtë gjetje rezultati i njoftuar nuk ndryshon; (iv) lidhur me automjetin tip “Fiat Punto”, i cili nuk ishte deklaruar në DIPP-në e vitit 2012, por në vitin 2013, duke e konsideruar këtë mosdeklarim si pasaktësi, trupi gjykues vlerëson se rezultati i njoftuar nuk ndryshon. Megjithatë, për at kohë sa pasaktësitë në deklarin nuk shoqërohen me mungesa të burimit financiar, ato nuk do të sillnin pasoja penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

## REZULTATET SIPAS ANALIZËS FINANCIARE

187. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklarinet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe përlllogaritjen krahasimore të tyre mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
188. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat për pasuritë e realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të pasqyruara në vitin e kryerjes së investimit me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin e përfitimit, të gjitha të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, i bashkëngjitur deklaratës *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve, gjendja e likuiditeteve, shpenzimet jetike dhe shpenzimet e arsimimit dhe të udhëtimeve, sipas korigjimeve të kryera, si dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të bazuar mbi dokumentacion.
189. Nga sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse, si dhe për të paraqitur dokumentacionin ligjor për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit lidhur me të gjitha problematikat e konstatuara për kriterin e pasurisë.

## Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Viti	2003	2004	30.9.2005	1.10.2005-31.10.2007	1.11-31.12.2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>-962,458</b>	<b>2,678,588</b>	<b>-141,109</b>	<b>2,932,627</b>	<b>-4,548</b>	<b>1,054,493</b>	<b>598,557</b>	<b>-34,997</b>	<b>1,376,337</b>	<b>1,469,932</b>	<b>472,313</b>	<b>802,244</b>	<b>114,314</b>	<b>261,564</b>
Banese dhe njësi ne Fier		833,806	657,302	410,867										
Automjet Mercedes Benz FR***C	200,000													
Apartament banimi ne Tirane				3,144,000										
Automjet Mercedes Benz TR***N				200,000										
Automjet VW Golf										50,000				
Automjet Fiat Punto										69,860				
Automjet Ford Fiesta													550,600	
Automjet Mercedes Benz AA***KN														270,540
Ndryshim likuiditeti	-1,162,458	1,844,782	-798,411	-822,240	-4,548	1,054,493	598,557	-34,997	1,376,337	1,350,072	472,313	802,244	-436,286	-8,976
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>1,439,812</b>	<b>3,284,594</b>	<b>2,486,182</b>	<b>1,663,943</b>	<b>1,659,395</b>	<b>2,713,888</b>	<b>3,312,445</b>	<b>3,277,449</b>	<b>4,653,786</b>	<b>6,003,858</b>	<b>6,476,171</b>	<b>7,278,415</b>	<b>6,842,130</b>	<b>6,833,153</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>-1,500,000</b>	<b>1,500,000</b>	<b>-1,500,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Dhene nga babai b'shortit (nga huaja e z. I.C.)		1,500,000												
Kthyer babait te b'shortit (nga huaja e z. I.C.)	-1,500,000		-1,500,000											
<b>PASURI NETO</b>	<b>537,542</b>	<b>1,178,588</b>	<b>1,358,891</b>	<b>2,932,627</b>	<b>-4,548</b>	<b>1,054,493</b>	<b>598,557</b>	<b>-34,997</b>	<b>1,376,337</b>	<b>1,469,932</b>	<b>472,313</b>	<b>802,244</b>	<b>114,314</b>	<b>261,564</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>959,757</b>	<b>1,067,540</b>	<b>1,176,107</b>	<b>3,407,465</b>	<b>221,184</b>	<b>2,194,253</b>	<b>1,931,144</b>	<b>1,842,303</b>	<b>2,061,015</b>	<b>1,819,941</b>	<b>2,091,548</b>	<b>1,816,668</b>	<b>2,196,452</b>	<b>2,054,746</b>
Te ardhura te subjektit	449,955	526,932	402,456	993,299	45,750	842,625	946,184	893,296	1,000,739	948,207	891,365	1,025,836	1,106,710	1,095,915
Te ardhura te bashkeshortit	365,370	427,848	301,524	964,848	102,434	638,867	668,237	690,496	696,255	657,346	592,828	786,056	836,464	754,467
Te ardhura nga interesat e depozitave	144,432	112,760	72,127	69,318	3,000	12,761	16,723	8,511	14,021	24,388	23,061	4,776	3,278	4,364
Te ardhura nga dyqani			400,000	680,000	70,000	500,000	300,000	250,000	350,000	150,000	160,000	-	200,000	-
Te ardhura nga shitja e automjeteve						200,000					94,293		50,000	200,000
Dhurate nga prinderit e b'sh				700,000										
Dhurate nga motra e b'shortit										40,000				
Dhurate per lindjen e vajzes											330,000			
<b>SHPENZIME</b>	<b>281,592</b>	<b>300,603</b>	<b>354,098</b>	<b>952,799</b>	<b>165,368</b>	<b>976,892</b>	<b>875,811</b>	<b>650,975</b>	<b>611,109</b>	<b>503,044</b>	<b>744,634</b>	<b>1,289,745</b>	<b>1,420,662</b>	<b>1,343,958</b>
Shpenzime jetese	281,592	281,592	246,503	718,560	61,544	409,860	409,860	409,860	409,860	423,072	423,072	879,992	897,104	940,368
Shpenzime arsimimi							164,604		165,960		168,252		165,180	
Shpenzime mobilimi					90,000	360,000	200,000							
Shpenzime udhetimi		19,011	107,595	234,239	0	181,632	90,147	230,015	27,789	53,106	114,972	409,753	327,828	366,846
Shpenzim per zhdoganim automjeti											24,188			
Shpenzim per rivleresim pasurie										26,866				
Shpenzim per sigurancion automjeti					13,824	25,400	11,200	11,100	7,500		14,150		30,550	36,744
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>140,623</b>	<b>-411,651</b>	<b>-536,882</b>	<b>-477,961</b>	<b>60,364</b>	<b>162,867</b>	<b>456,776</b>	<b>1,226,324</b>	<b>73,568</b>	<b>-153,035</b>	<b>874,600</b>	<b>-275,321</b>	<b>661,476</b>	<b>449,224</b>
Gjendje cash ne banese				1,291,365	1,291,365	1,291,365	1,691,365	1,941,365	1,291,365	3,529,335	3,929,335	4,329,335	4,329,335	1,382,900
Gjendje ne llogaritë bankare	1,439,812	3,284,594	2,486,182	372,578	368,030	1,422,523	1,621,080	1,336,084	3,362,421	2,474,523	2,546,836	2,949,080	2,512,795	5,450,253
<b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>				<b>-1,854,851</b>										

190. Komisioni çmon se lidhur me analizën financiare për gjithë periudhën e rivlerësimit, 2003 – 2016, ndonëse është konstatuar një pamjaftueshmëri financiare, pasi janë marrë në konsideratë të ardhurat nga qiradhënia dhe enfiteoza, shpenzimet e ndërtimit të kryera nga subjekti në periudhën 2004 – 2006, si dhe korigjimet në shpenzimet e udhëtimit, ka rezultuar një balancë negative prej -1.854.851 lekësh. Vlen të theksohet se nga ky bilanc i përgjithshëm negativ pamundësia financiare pas vitit 2007 – përgjatë periudhës që subjekti ka ushtruar detyrën e prokurorit – ka rezultuar në vetëm - 428.356 lekë, ndërkohë që pjesa tjetër i referohet periudhës së mëhershme. Në këto kushte, trupi gjykues – bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe të objektivitetit – nisur nga vlera e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, të rezultuar edhe nga shpërndarja e saj ndër vite, e vlerëson atë të pamjaftueshme për të passjellë pasoja për subjektin e rivlerësimit, duke mos e gjetur në këtë rast të aplikueshëm nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

191. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit, me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 31.10.2017, i përpiluar me përgjigjet e të tria organeve ligjzbatuese, në të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Mirela Zavalani.
192. Më pas, në përgjigje të kërkesës së nisur nga Komisioni, me shkresën e datës 30.5.2022, organet ligjzbatuese kanë bërë me dije se për këtë subjekt rivlerësimi nuk disponohen të dhëna të përditësuara për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme.
193. Ndërkohë, në datën 9.6.2021, ky raport i AKSIK-së është deklasifikuar plotësisht nga organi kompetent, me vendimin nr. “\*\*\*\*” të KDZH-së dhe është përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 11.6.2021.
194. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që ky subjekt rivlerësimi të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se znj. Mirela Zavalani arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi të ketë pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklaratime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

195. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Mirela Zavalani, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
196. Raporti nr. “\*\*\*\*” prot., datë 16.1.2023, i përcjellë nga KLP-ja, është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
197. Referuar të dhënave të deklaruara në formular, konstatohet se: për periudhën nëntor 2007 – nëntor 2008 ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; për periudhat nëntor 2008 – dhjetor 2009 dhe shtator 2011 – prill 2012 ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë; për periudhën dhjetor 2009 – shtator 2011 ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës; nga prilli i vitit 2012 e deri aktualisht ushtron funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
198. Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore – subjekti i rivlerësimit Mirela Zavalani ka deklaruar se për periudhën tetor 2013 – tetor 2016 e në vazhdim ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrat e

saj kanë konsistuar në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin dhe kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore dhe përfaqësimin e çështjeve penale në gjykatë.

199. Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak të dokumentuar, ku të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.
200. Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, për sa i përket 3 dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe 5 dosjeve të administruara mbi bazë shorti, përgjithësisht nuk vërejtí problematika të natyrës procedurale dhe as mangësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.
201. Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, rezulton se për prokuroren Mirela Zavalani nuk ka pasur masa disiplinore apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.
202. Nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2020, rezulton se ka 5 ankesa, ku në përfundim të analizimit të tyre ato janë arkivuar, ndërsa lidhur me ankesën që i përket kallëzimit penal nr. “\*\*\*\*”, që bën fjalë për një aksident rrugor të ndodhur në Tiranë, ka rezultuar se:
203. Në datën 17.4.2018, në zonën e Laprakës janë përplasur dy mjete, për pasojë kanë pësuar dëmtime të lehta dy drejtueset e tyre. Një nga drejtueset e mjeteve ishte Mirela Zavalani, prokurore në Prokurorinë e Rrethit Tiranë. Nga veprimet hetimore rezultoi se shkak i aksidentit ka qenë shkelja e rregullave të qarkullimit nga shtetasja R.I. Në funksion të këtij kallëzimi, prokurori ka kryer veprime hetimore, në përfundim të të cilave ka konkluduar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Prokurori argumenton se nuk janë të pranishme elementet e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, pasi mungon pasoja dhe dëmtimet sipas përcaktimeve që bën dispozita përkatëse. Në këto rrethana, prokurori, në datën 9.5.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, sipas nenit 290/1, shkronjat “ç” dhe “d” të Kodit të Procedurës Penale.
204. Nisur nga sa më sipër, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 4, e cila paraqiti praktikën e plotë lidhur me aksidentin e ndodhur, si aktet e ekspertimit<sup>79</sup>, aktet mjekoligjore, aktin e vlerësimit financiar dhe vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 18.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur detyrimin e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. t’i paguajë paditëses Mirela Zavalani shumën 6.815.031 lekë si shpërbllim për dëmin pasuror për dëmtimin e shëndetit nga aksidenti automobilistik, detyrimin e shoqërisë t’i paguajë shumën 700.000 lekë si dëmshpërbllim jopasuror (moral dhe ekzistencial), si dhe shumat prej 133.333 lekësh shtetasve E., W., dhe A.Z., për dëmtimin e shëndetit të nënës së tyre. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas vërtetimit të lëshuar nga sekretaria e gjykatës, në datën 3.3.2023. Ndërsa, lidhur me

---

<sup>79</sup> Referuar aktit të ekspertimit, ka rezultuar se e dëmtuara Mirela Zavalani ka dëmtime që hyjnë në kategorinë e dëmtimeve që kanë shkaktuar humbje të aftësisë së përkohshme për punë, në masën mbi 9 ditë dhe se ajo ka aftësi të përkohshme për punë mbi 9 ditë, si dhe humbje të aftësisë për punë në masën 40%.

dëmshpërblimin për dëmin material të automjetit me targë “\*\*\*”, në pronësi të bashkëshortit, nga pala kreditore është pranuar oferta e dhënë nga shoqëria për dëmshpërblimin në shumën 4.000 euro, shumë e cila është ekzekutuar nëpërmjet një çeku bankar. Automjeti i sipërcituar është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2015, si dhe në deklaratën *Vetting*, si pasuri e blerë nga pala shitëse, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., kundrejt shumës 4.000 euro.

205. Po ashtu, Komisioni është informuar edhe nga DPPPP-ja<sup>80</sup>, ku ka rezultuar se familjarëve të subjektit të rivlerësimit (E., E., dhe L.Z.) pas aksidentit të ndodhur në Tiranë në vitin 2019 me automjetin<sup>81</sup> tip “Fiat” me targë “\*\*\*”, kanë kërkuar dëmshpërblim për aksidentin e ndodhur, duke i kërkuar kompanive të sigurimit dëmin moral, dëmin ekzistencial, dëmin biologjik, si dhe dëmin shëndetësor. Sipas kontratës<sup>82</sup> nr. “\*\*\*”, datë 24.9.2019, është vendosur zgjidhja me mirëkuptim mes palës debitore, shoqërisë gjermane të sigurimeve “\*\*\*\*”, përfaqësuar nga korrespondenti “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palës kreditore E., E., dhe L.Z., përfaqësuar nga shtetasi E.Z., për dëmshpërblimin e shumës në total prej 135.000 euro<sup>83</sup>, ku pas marrjes së kështit të parë prej 50.000 euro palët do të heqin dorë plotësisht nga e drejta e padisë lidhur me këtë çështje. Nisur nga fakti që çështja u zgjidh me marrëveshje e nuk vijoi procedura gjyqësore, rezultoi të mos ketë një akt vlerësimi financiar që të përcaktonte masën e dëmshpërblimit të kreditorëve, por rezultoi se ajo u përcaktua në kontratë. Në vendimin gjyqësor nr. “\*\*\*”, datë 18.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pala kreditore/paditëse ka kërkuar të heqë dorë nga e drejta e padisë, pasi e ka zgjidhur çështjen me marrëveshje me palën e paditur/debitore e, në këto kushte, është vendosur rrëzimi i padisë. Nga sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të jepte shpjegime, për sa më sipër.
206. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentin nr. “\*\*\*” prot., datë 26.5.2023, ku nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për vitin 2008 dhe për periudhën 2013 – 2023, nuk ka rezultuar që ndaj shtetasve dhe personit fizik të përmendur në këtë shkresë të jenë regjistruar procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

207. Subjekti i rivlerësimit, përveç sa kishte sqaruar në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, datë 14.3.2023, informoi në prapësime se si pasojë e aksidentit të ndodhur në Tiranë në vitin 2018 janë dëmtuar familjarët e saj rezidentë në SHBA. Avokati i të dëmtuarve u ka paraqitur një kërkesë subjekteve “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit. Nëpërmjet kësaj kërkesë është kërkuar dëmshpërblimi dhe palët vendosën që të zgjidhin çështjen me marrëveshje ndërmjet tyre, duke e finalizuar me kontratën e lidhur mes palës debitore, shoqërisë gjermane të sigurimeve dhe palës kreditore. Duke qenë se palët e zgjidhën çështjen me marrëveshje, shoqëria e sigurimit nuk ka kryer një akt vlerësimi financiar për të evituar

<sup>80</sup> Shkresë nr. “\*\*\*” prot., datë 17.6.2021.

<sup>81</sup> Nga shqyrtimi i AMF-së ka rezultuar se ky automjet ka qenë në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe nga kontrolli i sistemit TIMS nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj të kenë hyrje-dalje me këtë automjet.

<sup>82</sup> Sipas shkresës së noterit E.H., protokolluar me tonën me nr. “\*\*\*” prot., datë 2.3.2023.

<sup>83</sup> Objekt i kësaj kontrate ka qenë shpërblimi i plotë i dëmit pasuror dhe jopasuror që u është shkaktuar paditësve, nga dëmtimi i shëndetit të shtetasit E.Z., në aksidentin e datës 6.10.2018, të ndodhur në aksin rrugor Tiranë-Durrës, shkaktuar nga mjeti me targë “\*\*\*”, me drejtues shtetasin A.M. Vendimi për mosfillimin e procedimit penal datë 26.10.2018, për kallëzimin nr. “\*\*\*”, datë 15.10.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, hetuar nga prokurori Z.H.

edhe shpenzime ekstra, të cilat në përfundim do të përballohen po nga shoqëritë e sigurimit. Më pas, të dëmtuarit, me arritjen e marrëveshjes, kanë hequr dorë nga zgjidhja e çështjes gjyqësisht, provuar me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 18.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku evidentohet fakti se pala kreditore/paditëse ka kërkuar të heqë dorë nga e drejta e padisë, pasi e ka zgjidhur çështjen me marrëveshje me palën e paditur/debitore. Në këto kushte është vendosur rrëzimi i padisë dhe nuk ka lindur nevoja për kryerjen e aktit të vlerësimit financiar. Ashtu siç rezulton edhe nga shkresa kthim përgjigjeje nr. “\*\*\*\*” prot., datë 26.5.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, nuk ka pasur në hetim procedime penale të regjistruara ndaj kësaj kompanie dhe ortakëve të saj, duke mos u gjendur në situatën e konfliktit të interesit.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

208. Nga sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë shteruese, për aq kohë sa edhe nga hetimi administrativ nuk rezultoi ndonjë procedim penal i hetuar nga subjekti i rivlerësimit ndaj kësaj shoqërie sigurimi.

### **C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI**

209. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet publike të administruara për këtë qëllim.

### **Mbi ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit**

210. Lidhur me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit me personat e lidhur në një marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 8.11.2022, e cila me shkresën kthim përgjigjeje nr. “\*\*\*\*” prot., datë 1.12.2022, bëri me dije se në lidhje me shtetasit apo personat juridikë<sup>84</sup> të listuar në shkresë nuk rezulton të jenë regjistruar procedime penale, ndërsa lidhur me shtetasit<sup>85</sup> ka informuar se ka procedime penale, por që nuk janë ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Po ashtu, edhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 16.11.2022 dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 22.11.2022, kanë informuar se nuk rezulton të ketë regjistruar procedime penale në emër të shtetasve të përmendur në shkresë. Gjithashtu, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 9.1.2023 dhe shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 31.1.2023, ka informuar se procedimet penale të përmendura në këtë shkresë nuk janë ndjekur nga subjekti i rivlerësimit Mirela Zavalani. Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 10.3.2023, e cila ka informuar se pas verifikimeve në regjistrin e veprave

<sup>84</sup> Shoqëria “\*\*\*\*”, shtetasit Y./Y.Gj., F.P., R.L, B.G., dhe A.Ç.

<sup>85</sup> A.M., rezulton me një procedim penal, por që nuk është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, por nga prokurori S.H, si dhe për shtetasin A. B., rezultonin disa procedime penale. Subjekti i rivlerësimit paraqiti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, me shkresat nr. “\*\*\*\*” prot., datë 5.12.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 30.11.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 30.11.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda nuk rezultojnë që në emër të shtetasve<sup>86</sup> të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

### DENONCIME NGA PUBLIKU

211. Pranë Komisionit janë paraqitur nga publiku gjithsej 8 denoncime dhe disa fakte të bëra publike, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar sa vijon:

#### **Denoncim/ankesë nr. “\*\*\*” prot., datë 1.9.2022, i shtetas A.Sh.**

212. Kjo shtetase denoncon prokuroren për vendimmarrje të gabuar lidhur me pushimin e hetimeve për kallëzimin penal nr. “\*\*\*”, viti 2018, pasi sipas saj nga ana e prokurores nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore. Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “\*\*\*” prot., datë 17.11.2022, për të vënë në dispozicion praktikën përkatëse. Kjo e fundit përcolli kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq të procedimit penal nr. “\*\*\*”, viti 2018, për veprën penale të ngritur “falsifikim i dokumenteve shëndetësore” dhe veprën penale “shpërdorim detyre”, me të pandehur shtetasen E.S., të hetuar nga prokurori E.K. Nga sa më sipër, ka rezultuar se kallëzimi penal është ndjekur nga një tjetër prokuror dhe nuk shihen rrethana për thellimin e hetimit.

#### **Denoncim nr. “\*\*\*” prot., datë 2.6.2022, i shtetasit E.S.**

213. Ky shtetas ka informuar nëpërmjet një shkrese lidhur me një situatë të mundshme të ekzistencës së konfliktit të interesit, duke bërë me dije se midis subjektit të rivlerësimit Mirela Zavalani dhe një anëtari të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit kishte një marrëdhënie familjare. Për sa më sipër, nga ky shtetas është informuar se kjo rrethanë është tejkaluar, duke u shoqëruar me dorëheqjen e komisioneres dhe se aktualisht procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit është duke u shqyrtuar administrativisht nga një trup tjetër gjyqësor.

#### **Denoncim nr. “\*\*\*” prot., datë 25.4.2019, i shtetas R. Q. B.**

214. Nëpërmjet formularit të denoncimit, kjo shtetase ka denoncuar prokuroren Mirela Zavalani, duke parashtruar shkelje të ligjit nga prokurorja, si vijon: (i) nuk e ka thirrur atë asnjëherë në mënyrë që të vinte në dispozicion provat që vërtetohnin se ishte dhunuar; (ii) nuk ka thirrur dëshmitarët e pranishëm, duke bashkëlidhur edhe vendimin e pushimit të kallëzimit penal. Nga shqyrtimi i vendimit të pushimit të procedimit penal datë 10.10.2018, ka rezultuar se përpos faktit se janë kryer veprimet hetimore si akti i ekspertizës mjekoligjore, janë marrë edhe deklaratimet e vetë denoncueses dhe personit ndaj të cilit janë ngritur akuzat. Nga vlerësimi i dokumentit mjekoligjor nr. “\*\*\*”, datë 17.9.2018, është arritur në përfundimin se gjatë ekzaminimit të shtetas nuk janë konstatuar dëmtime të jashtme trupore të kallëzueses/denoncuese e, për rrjedhojë, prokurorja ka marrë vendim për mosfillimin e kallëzimit penal nr. “\*\*\*”, viti 2018, për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, vendim që është konfirmuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.

<sup>86</sup> A.B., Dh.B., E.Sh., Y./Y.Gj., A.M., K.M., A.Ll., V.Gj., F.P., R.L., E.K., A.M., E.M.Sh., I.B., A.B., E.S., G.T./M., (psikologe/materiali është dërguar për vlerësim dhe kompetencë në Prokurorinë e Përgjithshme, në datën 29.4.2022), Q. Z., dhe F.G.

“\*\*\*” regj. themeltar, datë 19.12.2018, që ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar. Po ashtu, prokurorja ka orientuar palën e dëmtuar për zgjidhjen e konfliktit për të cilin duhet t’i drejtohet me kërkesë gjykatës. Nisur nga sa më sipër, nuk shihen shkaqe për thellimin e hetimit, për sa kohë pretendimet e ngritura në këtë denoncim nuk provohen, duke qenë se nga ana e organit të prokurorisë janë ezauruar të gjitha veprimet hetimore në funksion të hetimit, ashtu sikurse është shprehur me vendim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka marrë formë të prerë.

**Denoncim nr. “\*\*\*” prot., datë 29.8.2018, i shtetasit K.Z.**

215. Shtetasi K. Z. denoncon disa subjekte rivlerësimi, ndërmjet tyre edhe prokuroren që ka ndjekur hetimin e kallëzimit penal nr. “\*\*\*”, viti 2016, në ngarkim të denoncuesit, për veprat penale “kanosje për shkak të detyrës” dhe “keqpërdorim i thirrjeve telefonike”<sup>87</sup>, duke dërguar kërkesën për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. “\*\*\*”, datë 18.12.2015, ka shpallur denoncuesin fajtor për konsumimin e disa veprave penale. Vendimi është ankimuar nga denoncuesi në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. “\*\*\*”, datë 31.3.2017, ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pushuar çështjen vetëm për sa i përket akuzës “keqpërdorim i thirrjeve telefonike”<sup>88</sup> dhe lënien në fuqi të vendimit për akuzën “kanosje për shkak të detyrës”. Nga shqyrtimi i akteve të administruara, Komisioni vlerëson se nga analiza në tërësi e akteve të disponuara nuk konstatohen mangësi në drejtim të hetimit të çështjes penale apo shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit.

**Denoncim nr. “\*\*\*” prot., datë 30.5.2018, i shtetases A.K.**

216. Administratorja e shoqërisë së udhëtimit “\*\*\*” sh.p.k. ka pretenduar se organi i akuzës, i përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit Mirela Zavalani, nuk ka kryer asnjë hetim serioz dhe është mjaftuar me deponimet e shtetasve të përfshirë në konsumimin e veprës penale “mashttrim”. Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “\*\*\*” prot., datë 17.11.2022, për të vënë në dispozicion praktikën përkatëse. Kjo e fundit, me shkresën nr. “\*\*\*” prot., datë 30.11.2022, paraqiti kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. “\*\*\*”, viti 2019. Nga shqyrtimi ka rezultuar se kallëzimi penal nr. “\*\*\*”, datë 9.1.2019, i hetuar nga subjekti i rivlerësimit, është rikthyer për hetim nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. “\*\*\*”, datë 3.12.2018, me argumentimin se nga ana e prokurorisë nuk janë kryer veprime të plota hetimore sa i përket evidentimit dhe sqarimit të lidhjes mes administruarës dhe shoqërisë dentare. Pas disponimit nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë bashkuar dy procedime penale, nr. “\*\*\*” dhe nr. “\*\*\*” të vitit 2019 e, më tej, prokurorja Mirela Zavalani ka kryer veprimet hetimore dhe me kërkesën e datës 14.2.2020 ka vendosur përsëri pushimin e procedimit penal nr. “\*\*\*”, viti 2019. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. “\*\*\*”, datë 18.6.2020, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. “\*\*\*”, të bashkuar me procedimin penal nr. “\*\*\*”, viti 2019, duke konfirmuar kështu vendimin e subjektit të rivlerësimit, vendim i cili është ankimuar<sup>89</sup>. Lidhur me çështjen penale nr. “\*\*\*”, me ankuese denoncuesen, ka rezultuar se prokurorja ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. “\*\*\*”, datë 26.3.2018, vendim

<sup>87</sup> Mbi bazën e kallëzimit të ish-ministres L.N., dhe shtetasit P.N.

<sup>88</sup> Pushuar për shkak të plotësimit të kritereve të nenit 6 të ligjit nr. 141/2016 datë 22.12.2016, “Për dhënie amnistie”, që nuk ka lejuar vijimin e procedimit për veprën penale.

<sup>89</sup> Referuar praktikës nr. “\*\*\*” prot., datë 18.1.2023, të ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



që është ankimuar nga denoncuesja dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 21.6.2018, ka vendosur rrëzimin e ankimit. Gjithashtu, ky vendim është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 3.12.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe pranimin e ankimit, duke shfuqizuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal, duke urdhëruar vijimin e hetimeve. Gjykata e Apelit Tiranë ka argumentuar se nga ana e prokurorisë nuk janë kryer veprime të plota lidhur me argumentimin, evidentimin apo sqarimin midis administratores dhe shoqërisë “\*\*\*\*”, punonjësve të saj dhe shtetasve italianë, si dhe faktit se si këta shtetas të huaj kanë gjetur kontaktet e klientëve italianë apo se kush i priti ata në aeroport.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar sqarime subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë denoncim. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ajo ka shpjeguar lidhur me dinamikën e procedimit/eve, duke shpjeguar se në rastin e këtij kallëzimi e procedimi penal të regjistruar më pas, edhe pas kryerjes së veprimeve hetimore të thelluara dhe ezauruese të urdhëruara nga Gjykata e Apelit Tiranë, sërish është arritur në konkluzionin se nuk ndodhemi përpara ndonjë vepre penale. Vendimmarrja ishte e bazuar në ligjin procedural penal, nuk ka fakte penale dhe se hetimi i mëvonshëm thjesht ka ezauruar kohë dhe burime njerëzore të kufizuara për prokurorinë, pasi e ka provuar të drejtë vendimmarrjen fillestare për mosfillimin e procedimit penal<sup>90</sup>. Për sa më sipër, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit të jepte shpjegime lidhur me marrjen e vendimit të mosfillimit të hetimeve, pa kryer të gjitha veprimet verifikuese dhe hetimore, konkretisht të mosevidentimit dhe të mossqarimit të lidhjes që ekzistonte midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasve të huaj, si dhe në mosvlerësimin e regjistrimit të markës tregtare të shoqërisë, për aq kohë sa kjo shoqëri dispononte shenjat dalluese – sikurse është pretenduar nga organi i prokurorisë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

217. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar nëpërmjet prapësimeve për vendimin e mosfillimit të kallëzimeve penale pa kryer të gjitha veprimet verifikuese dhe hetimore, duke bërë një vlerësim dhe analizim nëse faktet e pretenduara përbëjnë vepër penale<sup>91</sup>, ndaj edhe afati për marrjen e një vendimi të tillë është 15 ditë nga momenti i regjistrimit të kallëzimit penal. Lidhur me mosvlerësimin e regjistrimit të markës tregtare të shoqërisë, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se pas vlerësimit të rastit konkret për veprën penale “shkelja e të drejtave të pronësisë industriale”<sup>92</sup> nuk rezultonte të ishin konsumuar elementet e figurës së kësaj vepre, edhe pas hetimit të çështjes penale në asnjë rast nuk rezultoi që shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. të kishte ofruar shërbime, duke përdorur shenja dalluese apo markën e shoqërisë tjetër, pasi ata kishin nënshkruar deklarata pëlqimi ku shprehnin pëlqimin për shërbimin pranë kësaj shoqërie.

Lidhur me moskryerjen e hetimeve, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se dhe në fazën fillestare nuk ka qenë e nevojshme të kryheshin hetime, pasi faktet e pretenduara si vepra penale nuk

<sup>90</sup> Kërkesë “Për pushimin e çështjes penale”, nr. “\*\*\*\*”, viti 2019 (e bashkuar); kthim përgjigjeje nr. “\*\*\*\*”, datë 17.1.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; si dhe vendimi nr. “\*\*\*\*” regj. themeltar, datë 18.6.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>91</sup> Neni 291 i këtij Kodi, “Vendimi për mosfillimin e procedimit”: “1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit”.

<sup>92</sup> Neni 149/a i Kodit Penal: “Prodhimi, shpërndarja, mbajtja për qëllime tregtimi, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, shpërndarja, eksportimi ose importimi për këto qëllime i: [...] c) mallrave ose shërbimeve që mbrohen nga një markë tregtare, pa pëlqimin e pronarit të markës tregtare [...] të kryera me dashje, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit [...]”.

ekzistonin, pasi ishin konflikte personale. Qëllimi i këtyre kallëzimeve ka qenë marrja e një vendimi nga ana e prokurorisë, me qëllim që të përdorej nga palët në proces civil për shpërblim dëmi. Aktualisht kjo çështje është për gjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe ende nuk ka një vendimmarrje për çështjen nga kjo Gjykatë. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar sa më sipër lidhur me ekzistencën e një konflikti personal midis shoqërisë dentare dhe punonjësve, ka paraqitur shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 2.6.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga ku informohet se janë dhënë tri vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe të paditurve R.H., M.O. C., dhe T.D., e po ashtu ka paraqitur edhe kopje të ekstraktit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

218. Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti, vlerëson se shpjegimet e saj në lidhje me konstatimet janë bindëse dhe duhet të pranohen, kjo nisur nga fakti se referuar ecurisë së çështjes ka treguar se edhe pas kryerjes së hetimeve të plota e të gjithanshme nga prokuroria, mbështetur në detyrat e urdhëruara nga gjykata, sërish nuk janë evidentuar elemente të ndonjë veprë penale dhe se po ashtu hetimi i mëvonshëm ka provuar të drejtë vendimin fillestar të subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili ka qenë në koherencë me vendimmarrjen e mëvonshme të gjykatës.

### **Denoncim nr. “\*\*\*\*” prot., datë 6.12.2018, i shtetasit D.L.**

219. Shtetasi në fjalë denoncon subjektin e rivlerësimit për hetim të paplotë të ngjarjes, duke pretenduar se është korrupsuar nga autorët e ngjarjes dhe se nga ana e saj nuk është marrë në konsideratë memorandumimi dhe kërkesat për ballafaqim me disa persona që kanë qenë prezentë. Në kushtet kur nuk kishte paraqitur dokumentacion, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 30.11.2022, e cila vuri në dispozicion kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. “\*\*\*\*”, viti 2018, me të pandehur shtetasit D.L., dhe E.M. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka dërguar për gjykim çështjen nr. “\*\*\*\*”, viti 2018, në ngarkim të shtetasit E.M., për veprën penale “vrasje e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, i cili deri në momentin e marrjes së vendimit nga gjykata ka qenë nën masën “arrest shtëpie”, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, si dhe shtetasit D.L., për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. “\*\*\*\*” akti, datë 29.7.2019, ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit, duke dërguar çështjen në gjykim për shtetasin E.M., i akuzuar për veprën penale “vrasje e mbetur në tentativë”, pushimin e procedimit penal nr. “\*\*\*\*” për shtetasin D.L., për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” dhe pushimin e çështjes për shtetasit E.M., dhe A.T., për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”. Vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar nga palët. Pas dërgimit të çështjes për gjykim, në konkluzionet përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar deklarinimin fajtor të shtetasit E.M., dhe dënimin e tij fillimisht me 3 vjet e 6 muaj, e më pas me aplikimin e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale ka kërkuar vënien në provë të të pandehurit për një periudhë prej 3 vjetësh, kërkesë që është pranuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 19.6.2020, duke e deklaruar fajtor dhe duke e vendosur në provë për një periudhë 3-vjeçare. Sipas informacionit të disponuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi është aktualisht i ankimuar.

Gjykata ka marrë në shqyrtim kërkesën e prokurorit “Për pushimin e procedimit penal nr. “\*\*\*\*”, viti 2018, në dëm të shtetasit E.M., në ngarkim të shtetasit D.L., pasi për këtë veprë penale, bazuar në nenin 89 të Kodit Penal, ndjekja penale ushtrohet vetëm mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit, shtetasi E.M.<sup>93</sup>, me anë të procesverbalit ka deklaruar vullnetin e tij se nuk dëshiron të ndjekë ligjërisht veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. “\*\*\*\*” akti, datë 29.7.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit dhe dërgimin e çështjes në gjyq në Dhomën Penale të Gjykatës së Tiranës, në ngarkim të shtetasit E.M. Po ashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 19.6.2020, ka deklaruar fajtor këtë shtetas për veprën penale, duke e dënuar përfundimisht me detyrim paraqitjeje, vendim që është ankimuar. Pas kryerjes së detyrave të lëna nga gjyqtari i seancës paraprake, në bazë të nenit 332/d, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, nga ana e organit të prokurorisë është kërkuar edhe ndryshimi i cilësimit të veprës penale nga “plagosje e rëndë me dashje” në “plagosje e lehtë me dashje”, ndaj të pandehurit/denoncuesit D.L. Gjykata ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të shtetasit E.M., për veprën penale “vrasje e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, mbetur në tentativë, në dëm të shtetasit D.L. Nisur nga pretendimet e denoncuesit dhe nga shqyrtimi i vendimit, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka marrë deklaratimet e shtetasve, të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes. Janë sekuestruar pamjet filmike, janë ripyetur disa herë shtetasit, të cilët kanë dhënë deklaratimet e tyre, si dhe ka rezultuar se vetë denoncuesi ka nënshkruar një deklaratë noteriale me shtetasin E.M., duke u shprehur mbi normalizimin e situatës/marrëdhënies mes tyre dhe duke falur njëri-tjetrin dhe se vetë denoncuesi është pyetur disa herë duke dhënë deklaratimet e tij. Ndërsa lidhur me pretendimin e tij se ai është goditur në befasi, prokurorja ka argumentuar se pretendimet nuk përputhen me kronologjinë dhe logjikën e ngjarjes.

Lidhur me pretendimin e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në konsideratë memorandumin e depozituar prej denoncuesit, Komisioni konstaton se në listën e burimeve dhe provave të përshkruara në kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. “\*\*\*\*”, viti 2018, nuk përshkruhet dokumenti/memorandumi, sikurse pretendon denoncuesi. Për sa më sipër, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit të jepte shpjegime lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore si, ballafaqimi i shtetasve që kanë qenë të pranishëm në vendin ku ka ndodhur ngjarja, si dhe përsëritjen e aktit të ekspertimit mjekoligjor për të përcaktuar shkallën e dëmtimit. Gjithashtu, të informonte lidhur me vendimmarrjen e saj në raport me memorandumin e paraqitur nga shtetasi D.L., në funksion të këtij hetimi, si dhe mbi vijimësinë e kësaj çështjeje.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

220. Në prapësimet e dërguara dhe në dokumentacion<sup>94</sup>, subjekti i rivlerësimit, lidhur me hetimin e kësaj çështjeje penale, ka sqaruar se lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore si,

<sup>93</sup> Prokuroria, pas provave të administruara, ka arritur në përfundimin se personi që ka qëlluar ka qenë E.M., i vetëm dhe jo në bashkëpunim dhe po ashtu ka paraqitur kërkesën për pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit A.K., e cila është pranuar nga gjykata.

<sup>94</sup> Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provave dokumentacionin: aktin e ekspertimit mjekoligjor nr. “\*\*\*\*”, datë 28.5.2018, të Institutit të Mjekësisë Ligjore; procesverbal; memorandumet nr. “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\*”, datë 9.10.2018; kthim përgjigjen e memorandumeve datë 11.10.2018; ankesë ndaj prokurores Mirela Zavalani; informacion mbi ankesën e të pandehurit D.L., datë 18.1.2019; kthim përgjigjen nr. “\*\*\*\*” prot., datë 25.1.2019, të shtetasit D.L.; procesverbal për njoftimin

ballafaqimi i shtetasve që kanë qenë të pranishëm në vendin ku ka ndodhur ngjarja, pasi ka vlerësuar rëndësinë e veprës penale dhe zbardhjen e së vërtetës, ka kryer veprime procedurale, veçanërisht pyetjen e viktimës/të pandehurit D.L., pyetjen e të arrestuarit E.M., pyetjen e ekspertit mjekoligjor I.R., si dhe veprime të tjera hetimore e procedurale dhe se të gjithë personat janë pyetur dhe ripyetur disa herë, në mënyrë të detajuar. Për sa i takon mosballafaqimit të shtetasve, ajo ka sqaruar se nuk është vlerësuar kryerja e ballafaqimeve<sup>95</sup> ndërmjet personave të pyetur, nisur edhe nga fakti se ky veprim procedural nuk është i detyrueshëm për t'u kryer në çdo rast kundërthëniesh, por edhe faktit se shumë dëshmitarë justifikohen me faktin se nuk kanë parë ose dëgjuar asgjë rreth detajeve të ngjarjes apo veprimeve të autorëve.

Lidhur me moskryerjen e riekspertimit mjekoligjor të shtetasit E.M., nga ana e prokurores është konstatuar se akti i ekspertimit mjekoligjor është kryer nga një ekspert i Institutit të Mjekësisë Ligjore, i kualifikuar për detyrën e ngarkuar dhe nuk ka pasur dyshime gjithashtu që eksperti të ketë shprehur njëanshmëri apo të ketë shtrembëruar realitetin, pasi akti i hartuar prej tij ishte i qartë, i saktë dhe kategorik dhe nuk linte vend për interpretime<sup>96</sup>. Po ashtu, eksperti mjekoligjor është pyetur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e deklaruësit, sipas nenit 363 të Kodit të Procedurës Penale, për aktin e realizuar dhe e ka shpjeguar qartë se kualifikimi si plagosje e rëndë për shtetasin E.M., është bazuar në kartelën klinike dhe në përshkrimin e ekzaminimit imazherik të bërë në datën 24.5.2018. Në përfundim, eksperti ka deklaruar se gjendej para një rasti me një traumë kafko-trunore, shkaktuar me mjete të forta, që kualifikohet si plagosje e rëndë. Bazuar në këto dy akte mjekoligjore dhe deklarinimin e ekspertit, subjekti i rivlerësimit nuk e ka çmuar të nevojshme kryerjen e riekspertimit mjekoligjor, nisur edhe nga fakti se nuk është një veprim i detyrueshëm për t'u kryer në çdo rast, aq më tepër që eksperti e ka mbrojtur mendimin e tij edhe me deklarinimin e dhënë.

Gjatë seancës paraprake, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 28.1.2019, me vendimin nr. “\*\*\*”, ka vendosur në bazë të nenit 332/ç të Kodit të Procedurës Penale të urdhërojë Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për plotësimin e hetimeve, duke kryer këto veprime hetimore. Referuar detyrave të caktuara nga gjykata u krye ballafaqimi ndërmjet personave të sipërcituar, të cilët mbajtën qëndrimet e mëparshme si në deklarinimet e tyre, nga veprimet hetimore të kryera sipas vendimit të gjykatës rezultoi se mekanizmi i ngjarjes është i njëjti, pasi thuajse të gjitha faktet u ripohuan njësoj nga personat e ballafaquar. Gjithashtu, në zbatim të detyrave të gjyqtarit të seancës paraprake, është vendosur në datën 15.3.2019 kryerja e riekspertimit mjekoligjor të shtetasit E.M., nga një grup i përbërë nga dy ekspertë mjekoligjorë. Nga sa më sipër, pas kryerjes së detyrave të lëna nga gjyqtari i seancës paraprake, në bazë të nenit 332/d, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, nuk ndryshoi cilësimi juridik i veprës penale për të pandehurin E.M., por ndryshoi cilësimi juridik i veprës penale

---

me telefon; kthim përgjigjen nr. “\*\*\*” prot., datë 23.5.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm; kthim përgjigjen nr. “\*\*\*” prot., datë 25.5.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; vendim për konstatimin e përfundimit të kohës së provës, datë 25.10.2021.

<sup>95</sup> Nenet 169-170 të Kodit të Procedurës Penale: “*Ballafaqimi lejohet vetëm ndërmjet personave që janë pyetur, kur ka mospërputhje midis tyre për fakte dhe rrethana të caktuara [...]*”. Neni 170, “Rregullat e ballafaqimit”: “*1. Organi procedues, pasi u kujton deklarinimet e mëparshme personave që do të ballafaqohen, i pyet nëse i konfirmojnë ose i ndryshojnë ato, duke i fuar, kur lind nevoja, për të bërë kundërshtimet reciproke. 2. Në procesverbal shënohen pyetjet e bëra nga organi procedues, deklarinimet e bëra nga personat e ballafaquar dhe gjithçka tjetër që ka ndodhur gjatë ballafaqimit*”.

<sup>96</sup> Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. “\*\*\*”, datë 28.5.2018, të Institutit të Mjekësisë Ligjore, rezultoi se tek shtetasi E.M., u konstatua traumë e kokës, plagë në kokë, grumbullim gjaku minimal në cipat e trurit, shembje hemorragjike e indit trunor. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet mprehës. Dëmtimet hyjnë në kategorinë e atyre të rënda që kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shaktimit të tyre.

nga “plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal, në “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, ndaj të pandehurit D.L. Lidhur me vendimmarrjen me kërkesat e parashtruara në memorandum, të paraqitur nga shtetasi D. L., në funksion të këtij hetimi, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Në përfundim të hetimeve, organi i prokurorisë ka akuzuar të pandehurin E.M., për veprën penale “vrasje e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”. Në datën 1.10.2018 i është njoftuar akuza dhe marrë në cilësinë e të pandehurit shtetasi D. L., për veprën penale “plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal, në dëm të shtetasit E.M. Në njoftimin e përfundimit të hetimeve, i pandehuri D.L., dhe mbrojtësi kanë kërkuar kopje të akteve dhe pas marrjes së tyre, mbrojtësi i të pandehurit, av. I. R., ka paraqitur dy memorandumet me nr. “\*\*\*\*” dhe nr. “\*\*\*”, datë 9.10.2018<sup>97</sup>, duke parashtruar disa kërkesa. Organi i prokurorisë, me kthim përgjigjen datë 11.10.2018, “Mbi memorandumit e datës 9.10.2018, të av. I.R.”, u ka kthyer përgjigje me shkrim kërkesave si më sipër, duke mos i pranuar dhe rrëzuar ato. Me ankesën protokolluar me nr. “\*\*\*\*” prot., datë 6.12.2018, drejtuar ish-drejtuesit të Prokurorisë së asaj kohe, duke kërkuar marrjen e masave ndaj meje si prokurore. Në lidhje me këtë ankesë, më është kërkuar nga drejtuesi informacion me shkrim, të cilin ia kam vënë në dispozicion në datën 18.1.2019, duke i bashkëlidhur edhe akte të çështjes penale. Pas njohjes me këtë informacion, drejtuesi i prokurorisë ka vendosur vazhdimin e hetimeve nga ana ime, pasi nuk janë konstatuar shkelje ligjore dhe procedurale, si dhe ka informuar denoncuesin”.*

*Lidhur me vijimësinë e kësaj çështjeje, subjekti ka shpjeguar se, pas përfundimit të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. “\*\*\*\*”, datë 19.6.2020, ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit E.M., për kryerjen e veprës penale “vrasje e kryer në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 83-22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht me 2 vjet burgim. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur, për një periudhë kohe prej 3 vjetësh, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të mos kryejë veprë tjetër penale [...]”. Gjykata në vendimin e saj ka deklaruar dhe dënuar të pandehurin E.M., për të njëjtën veprë penale dhe të njëjtën masë dënimi, si kërkimet e mia në konkluzionet përfundimtare. Vendimi është ankimuar nga i pandehuri E. M., dhe aktualisht çështja penale në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është në pritje për planifikim për gjykim nga gjyqtarja L.C. Nga praktika e administruar nga Zyra e Ekzekutimeve rezulton se ekzekutimi i dënimit ka filluar në bazë të urdhrit të ekzekutimit lëshuar nga ana ime me datë 22.6.2020 dhe nga Zyra Vendore e Shërbimit të Provës është konstatuar përfundimi i periudhës së provës<sup>98</sup>”.*

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

221. Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se lidhur me mosballafaqimin e shtetasve referuar dy memorandumëve të paraqitura nga avokati i të pandehurit (pasi i është njoftuar akuza), prokurori, bazuar në nenet

<sup>97</sup> Memorandumet në fjalë dhe përgjigja me shkrim kundrejt tyre gjenden të listuara në volumnin e dytë të fashikullit të procedimit penal nr. “\*\*\*\*”, viti 2018, në fletën e inventarit në numrin rendor 10 dhe në faqet 287-299 të këtij fashikulli dhe ju vihen në dispozicion.

<sup>98</sup> Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Tiranë, me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 29.10.2021, ka njoftuar konstatimin e përfundimit të kohës së provës për shtetasin E.M, pasi ka ndërruar jetë.

110/2 dhe 327/5 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur rrëzimin e kërkesës për ballafaqimin e personave. Rrëzimi i kërkesës për ballafaqimin është argumentuar me të drejtë nga subjekti i rivlerësimit, bazuar mbi procesverbalin e datës 10 dhe 11.7.2018, ku shtetasi D.L., ka refuzuar ballafaqimin me shtetasit e përfshirë në këtë ngjarje. Lidhur me ripërsëritjen e aktit të ekspertimit po të kërkuar nga pala në memorandumet, subjekti i rivlerësimit ka rrëzuar kërkesën e avokatit, duke argumentuar se nga ana e të pandehurit nuk janë ngritur shkaqe njëanshmërie apo shkaqe për të përjashtuar ekspertin, për sa kohë akti i ekspertimit nr. “\*\*\*\*” është kryer nga eksperti mjekoligjor i kualifikuar, si dhe eksperti mjekoligjor është pyetur nga subjekti në cilësinë e deklaruës, provuar kjo me aktin e realizuar sipas procesverbalit të datës 4.7.2018, ku eksperti ka shpjeguar qartë kualifikimin si plagosje e rëndë. Pra, pretendimi mbi rikryerjen e një akti tjetër ekspertimi mjekoligjor është kryer mbi bazën e kartelës mjekësore dhe jo vizitës së drejtpërdrejtë, pasi kishte kaluar kohë e gjatë e, për pasojë, sërish rikryerja e aktit të ekspertimit mjekoligjor do të bazohej mbi dokumentacion, gjë e cila ishte ezauruar me dy aktet e tjera.

222. Nga sa më sipër, shpjegimet e saj janë bindëse dhe duhet të pranohen, kjo nisur nga fakti se referuar ecurisë së kësaj çështjeje nuk evidentohen shkelje të ligjit material procedural penal, si dhe shkelje të të drejtave të palëve gjatë hetimit. Komisioni, nisur nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, çmon se ato janë bindëse dhe vlerësohen të mjaftueshme në vetvete për të përjashtuar ekzistencën e ndonjë mangësie profesionale nga ana e saj.

**Denoncim nr. “\*\*\*\*” prot., datë 24.11.2017, i shtetases D.M.**

223. Denoncuesja ankohet për pushimin e çështjes penale, por pa përcaktuar shkelje procedurale apo ligjore. Ajo pretendon se prokurorja ka marrë vendim për dënimin e bashkëshortit të saj. Në kushtet kur nuk ishte depozituar dokumentacion nga denoncuesja, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 17.11.2022, për të vënë në dispozicion praktikën përkatëse. Kjo e fundit, me shkresën nr. “\*\*\*\*” prot., datë 30.11.2022, vuri në dispozicion vendimin për pushimin e procedimit penal nr. “\*\*\*\*”. Nga shqyrtimi i vendimit të pushimit të procedimit penal ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se për sa i takon konfliktit të palëve lidhur me regjistrimin e kontratave në ZRPP nëpërmjet mashtrimit është një konflikt që zgjidhet civilisht në gjykatë, pasi mosmarrëveshjet rezultojnë të jenë të natyrës juridiko-civile, për të cilat shprehet vetëm gjykata kompetente. Me vendimin e pushimit është njohur edhe denoncuesja, sipas shënimit të bërë në kopjen e dërguar. Komisioni nuk sheh *indicie* për thellimin e hetimit mbi këtë denoncim, nisur edhe nga fakti se në denoncim nuk përshkruhen shkelje ligjore apo procedurale të subjektit të rivlerësimit.

**Denoncim anonim nr. “\*\*\*\*” prot., datë 16.6.2023 (sipas zarfit S.A.), administruar nga Komisioni pas dhënies së vendimit**

224. Kjo ankesë ka mbërritur në Komision nëpërmjet shkresës nr. “\*\*\*\*” prot., datë 19.6.2023, nga Komisioneri Publik. Në këtë ankesë pretendohet se që prej fillimit të procesit të shortimit dosja i kaloi komisioneres (sqaruar edhe më sipër në denoncimin nr. “\*\*\*\*” prot., datë 2.6.2022, të shtetasit E.S.), e cila sipas denoncuesit ka fshehur një mori provash, pronash dhe pasurish që ka subjekti i rivlerësimit, të cilat i janë dërguar të detajuara, por që nuk janë parë në seancë të ishin publikuar. Konkretisht, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë një lokal në rrugën “\*\*\*\*”, në afërsi të Hipotekës së Tiranës, lokal që nuk u përmend në seancë. Të gjitha pasuritë dhe vlerësimi i tyre duhet bërë të jenë 10-fishi i atyre që u deklaruan në seancë.

Gjithashtu, denoncuesi ka kërkuar hetimin e shkaqeve të dorëheqjes së komisioneres nga dosja, si dhe ka pretenduar se edhe pas dorëheqjes ajo ka pasur rol aktiv me trupin gjykues, me qëllim konfirmimin në detyrë të saj. Nga të dhënat, vijon denoncuesi, dhe takimet ngrihen dyshime se subjekti u ka paguar vlera të konsiderueshme monetare anëtarëve të trupës dhe se komisionerja F. Sh., ka dalë garant për dhënien e kësaj shume. Po ashtu, ai disponon foto nga takimet ndërmjet familjarëve të subjektit dhe komisioneres F. Sh., të cilat do të vihen në dispozicion në një moment tjetër. Nisur nga fakti se ky denoncim/ankesë ka ardhur pas datës 15.6.2023, datë kur është njoftuar vendimi i Komisionit, kjo ankesë nuk u mori në shqyrtim.

### **LIDHUR ME DISA FAKTE TË BËRA PUBLIKE NGA MEDIA**

225. Komisioni është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me disa artikuj të publikuar në median *online*. Në kuadër të kryerjes së një hetimi gjithëpërfshirës janë administruar dhe analizuar të dhënat dhe dokumentacioni përkatës i kërkuar mbi artikujt e publikuar në median *online* dhe/ose në portalet mediatike, si vijon:

226. <https://stop.tvklan.al/stop-zbulon-falsifikimin-e-dokumenteve-toka-bujqësore-kthehet-ne-truall/>.

Në këtë artikull përshkruhet një denoncim nga fshati Mazrek, ku dyshohet se është falsifikuar një vendim i AKKP-së në vitin 2002 dhe pjesa më e madhe e tokave bujqësore të këtij fshati janë njohur si toka truall dhe i janë kthyer trashëgimtarëve të shtetasit A.L. Shtetasi I.M., përfaqësues i fshatarëve, tregon se si i kanë marrë këto prona në vitin 1991 me ligjin nr. 7501 dhe shprehet i habitur se si trashëgimtarët L., janë bërë pronarë të tokave në këtë fshat. Emisioni investigativ STOP ka siguruar vendimin e AKKP-së të vitit 2002, ku tokat bujqësore në kundërshtim me ligjin janë kthyer në truall. Në vendim mungojnë firmat e anëtarëve të komisionit, që e nxjerr të pasaktë dhe të falsifikuar këtë vendim. Shtetasi B. L., një prej trashëgimtarëve, hap një proces gjyqësor, ku kërkon anulimin e të gjitha vendimeve. Këtë proces e ka gjykuar R.S., që tani është në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky proces është zhvilluar pa njoftuar palët e paditura, fisin M., në fshatin “\*\*\*\*” dhe institucionet shtetërore, që kanë qenë palë e tretë. Më pas, prokurorja e Tiranës Mirela Zavalani konstatoi shpërdorimin e detyrës dhe falsifikimin e vendimit, por doli në konkluzionin e mosfillimit, sepse vepra penale ishte parashkruar, duke lënë konfliktin hapur, pa ndjekur pistën tjetër të veprës penale të pastrimit të produkteve. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit, e cila, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, vuri në dispozicion vendimin për pushimin e procedimit penal nr. “\*\*\*”, viti 2015, që i përket kallëzimit të shtetasve B.M., I.M., etj., me argumentimin se nuk gjendemi përpara veprës penale “falsifikim dokumentesh”, për të cilën ishte paraqitur kallëzimi. Me këtë vendim janë njohur edhe palët. Nuk shihen shkelje ligjore apo procedurale nga shqyrtimi i vendimit të pushimit lidhur me këtë praktikë.

227. <https://www.dailymotion.com/video/x3rp765>., ku citohet: “*Report TV – falsifikonin viza e pasaporta daneze, përgjimet që zbuluan grupin kriminal, Tiranë – gati 1 vit më parë, një grup prej 7 anëtarësh u arrit të lokalizohet dhe arrestohet nga policia si përgjegjës për falsifikimin e dokumenteve dhe pasaportave daneze. Kur janë mbushur një vit nga arrestimi i tyre, Gjykata e Tiranës ka shfryrë bujën e këtij operacioni, duke dënuar pak ditë më parë me disa muaj burg autorët, ndërsa për organizatorin e këtij grupi, K.B., Gjykata e Tiranës ka dhënë një dënim prej 2 vitesh burg, nga 5 vjet që ka kërkuar prokurorja Mirela Zavalani*”. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime, e cila, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, vuri në dispozicion kopje të ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të

datës 1.2.2016, për sa i përket masës së dënimit për të pandehurit F.B., K.B., F.B., dhe I. B. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. “\*\*\*”, datë 1.2.2016, ka vendosur deklarin fajtore të shtetasve. Kundër vendimit është bërë ankim. Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke urdhëruar lirim të menjëhershëm të shtetasit F.B. Kundër vendimit është bërë ankim në Gjykatën e Lartë, e cila nuk ka pranuar rekursin. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka ankimuar vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me masën e dënimit për të pandehurit. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 422 të Kodit të Procedurës Penale, ka ankimuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sa i përket masës së dënimit sipas procedurave ligjore në fuqi. Komisioni nuk konstaton shkelje ligjore apo procedurale nga subjekti i rivlerësimit.

228. <http://www.arkivalajmeve.com/Hetime-prej-një-viti-pranga-tre-personave-në-Tiranë-për-falsifikim-dokumentesh.1047790317/>, ku citohet: “Gati 1 vit më parë, një grup prej 7 anëtarësh u arrit të lokalizohet dhe arrestohet nga policia si përgjegjës për falsifikimin e dokumenteve dhe pasaportave daneze. Kur janë mbushur një vit nga arrestimi i tyre, Gjykata e Tiranës ka shfryrë bujën e këtij operacioni duke dënuar pak ditë më parë me disa muaj burg autorët, ndërsa për organizatorin e këtij grupi K. B., Gjykata e Tiranës ka dhënë një dënim prej 2 vitesh burg, nga 5 vjet që ka kërkuar prokurorja Mirela Zavalani”. Nga dokumentacioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka dërguar për gjykim çështjen e bashkuar nr. “\*\*\*”, viti 2014, me të pandehur shtetasit K.B., F.B., J.B., I.B., H.T., dhe F.D., të akuzuar për veprat penale “falsifikim dokumentesh shkollorë” dhe “falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave ose i vizave”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. “\*\*\*”, datë 3.3.2016, ka deklaruar fajtor shtetasin P.B., në bashkim të dënimeve është dënuar me 18 muaj burgim, për shtetasin J.B., dënuar në bashkim të dënimeve me 16 muaj dhe për shtetasin H.T., dënuar përfundimisht me 10 muaj burgim. Subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar deklarin fajtore dhe dënimin e tyre: për shtetasin P.B., 4 vjet; për shtetasin J.B., 3 vjet e 6 muaj; për shtetasin H.T., 10 muaj e 5 ditë burgim. Nisur nga masa e dënimit të sipërcituar, prokurorja ka ushtruar ankimin ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të datës 3.3.2016, për sa i takon masës së dënimit/ve të dhëna nga gjykata. Referuar shënimit, vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. “\*\*\*”, datë 11.4.2018, ka vendosur mospranimin e ankimeve kundër vendimit penal nr. “\*\*\*”, datë 3.3.2016.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka ankimuar vendimin e gjykatës bazuar në nenin 422 të Kodit të Procedurës Penale, duke argumentuar lidhur me mosaplikimin e drejtë të dispozitave të Kodit Penal nga gjykata në lidhje me masën e caktimit të dënimit/ve për të pandehurit. Nuk konstatohen shkelje procedurale apo ligjore nga subjekti i rivlerësimit.

229. <https://stop.tvklan.al/i-merr-para-borxh-per-dasmën-nuk-i-kthen-borxhin-ppr-e-rreh/>, ku përshkruhet: “Q.R., tregon se ka një problem me qytetaren B.K., të cilën e ka njohur në marrëdhënie pune. B., i kërkoj 6 milionë lekë të vjetra për të bërë dasmën dhe kjo marrëdhënie u legalizua me deklaratë noteriale. Paratë duhet të ktheheshin brenda vitit, por kjo nuk ndodhi, ndaj R., bëri padi në gjykatë. Veç moskthimit të borxhit, Q. R., tregon edhe se është dhunuar fizikisht nga B.K. Pasi fitoi të drejtën e kthimit të parave, znj. R., iu drejtua



*përmbarduesit L. C. Ky i fundit tha se në llogarinë e B., nuk kishte para e në emër të saj nuk kishte prona. Madje ajo nuk kishte bërë celebrim as me të shoqin A. D. "STOP" mësoi se B.K., banon në një ndërtesë 3-katëshe të prindërve të saj, së bashku me partnerin. Kërkesës së gazetares i ati i B., i përgjigjet me arrogancë dhe kërcënime. Nga ana tjetër, përmbarduesi këshillon që R., të marrë një avokat për të zgjidhur këtë çështje". Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti vuri në dispozicion vendimin për mosfillimin e procedimit penal, që i përket materialit kallëzues nr. "\*\*\*\*", viti 2019, të shtetases Q.R.<sup>99</sup>, për veprën penale "dëmtime të tjera me dashje", duke argumentuar se kjo vepër penale hyn në kategorinë e veprave që gjykohet drejtpërdrejt nga gjykata, kur gjykata vihet në lëvizje nga ankesa e shtetases së dëmtuar, duke e orientuar palën për mënyrën e zgjidhjes së konfliktit. Vendimi i është njoftuar kallëzueses në datën 1.10.2019. Nuk shihen shkaqe, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për thellimin e hetimit apo shkelje të subjektit të rivlerësimit.*

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

230. Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të rënda procedurale, gabime thelbësore dhe serioze në lidhje me drejtimin e hetimeve apo vendimmarrjen nga ana e saj, shkaqe këto që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
231. Trupi gjykues vlerëson se bazuar në sa më lart, subjekti i rivlerësimit Mirela Zavalani ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës "c" të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues, sipas parashikimit të shkronjës "a" të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Mirela Zavalani:

- a. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në bazë të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

---

<sup>99</sup> Më parë, nga një tjetër prokuror është marrë vendimi i datës 18.2.2019, lidhur me materialin kallëzues nr. "\*\*\*\*", të paraqitur nga shtetasja Q.R., për kryerjen e veprës penale "mashtim" dhe në përfundim të hetimeve ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin e kësaj shtetaseje.

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Mirela Zavalani, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 15.6.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
Kryesues

**Lulzim HAMITAJ**  
Relator

**Xhensila PINE**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Gledis Hajdini*